Скупштина општине и извршни органи Општине дужни су да предлоге свих одлука који се тичу националне равноправности претходно доставе на мишљење Савету.

Надлежни орган општине дужан је да обезбеди да ставови и мишљења Савета буду доступни јавности, најкасније 30 дана од дана заузимања става или давања мишљења од стране Савета.

Пословником Скупштине општине ближе се уређује положај Савета у поступку доношења општинских одлука и других правних аката.

Подношење извештаја Скупштини општине Члан 151.

Савет подноси Скупштини општине шестомесчни извештај о свом раду.

Савет подноси Скупштини општине годишњи извештај о стању у области националне равноправности, међунационалних односа и остваривању мањинских права на територији Општине. Саставни део извештаја су и предлози мера и одлука за остваривање и унапређење националне равноправности.

Савет може да поднесе и посебан извештај Скупштини општине ако оцени да

то захтевају нарочито важни разлози или ако Скупштина општине тражи такав извештај од њега.

**Заштита права припадника
српског народа и националних мањина
Члан 152.**

Савет има право да пред Уставним судом покрене поступак за оцену уставности и законитости одлуке или другог општег акта Скупштине општине ако сматра да су њиме непосредно повређена права припадника српског народа и националних мањина представљених у Савету и право да под истим условима пред Управним судом покрене поступак за оцену сагласности одлуке или другог општег акта Скупштине општине са Статутом.

**Пословник о раду Савета
Члан 153.**

Савет доноси пословник о раду.

Стручне и административно-техничке послове за потребе Савета врши Општинска управа.

**Средства за рад Савета
Члан 154.**

Средства за рад Савета обезбеђују се у буџету Општине, а могу се обезбеђивати и из других извора, у складу са законом.

**X. АКТИ ОПШТИНЕ
Акти Општине
Члан 155.**

У вршењу послова из своје надлежности Општина доноси одлуке, правилнике, наредбе, упутства, решења, закључке, препоруке и друге потребне акте.

Одлуке доноси само Скупштина општине, осим када је законом предвиђено да одлуку доноси други орган Општине.

**Хијерархија аката Општине
Члан 156.**

Одлуке и општи акти Скупштине општине морају бити сагласни са законом и овим статутом.

Акти председника Општине и Општинског већа морају бити сагласни са законом, овим статутом, одлукама и општим актима Скупштине општине.

Акти Општинске управе морају бити сагласни са законом, овим статутом, одлукама и општим актима органа Општине.

**Предлагање прописа и других општих
аката Скупштине општине
Члан 157.**

Право предлагања прописа и других општих аката из надлежности Скупштине општине имају: сваки одборник Скупштине општине, радно тело Скупштине општине, Општинско веће и грађани путем грађанске иницијативе.

**Објављивање и ступање на снагу
општих аката
Члан 158.**

Општи акти органа Општине објављују се у „Службеном гласнику општине Бујановац“.

Акти из става 1. овог члана ступају на снагу осмог дана од дана објављивања, осим ако доносилац у поступку доношења не утврди да постоје нарочито оправдани разлози да исти ступи на снагу и раније.

Остали акти Општине објављују се у „Службеном гласнику општине Бујановац“ када је то тим актима предвиђено.

Акти из ст. 1. и 3. овог члана равноправно се објављују на српском језику и ћириличном писму и албанском језику и његовом писму.

**XI. ТУМАЧЕЊЕ, ДОНОШЕЊЕ И ПРО-
МЕНА СТАТУТА**

**Аутентично тумачење Статута
Члан 159.**

Аутентично тумачење Статута доноси Скупштина општине на предлог надлежног радног тела Скупштине општине.

**Поступак за промену или доношење
Статута
Члан 160.**

Предлог за доношење или промену Статута општине може поднети најмање 5% грађана са бирачким правом на територији Општине, трећина одборника, председник Општине и надлежно радно тело Скупштине општине.

Предлог се подноси у писаном облику са образложењем.

О предлогу из става 1. овог члана Скупштина одлучује већином гласова од укупног броја одборника.

Ако Скупштина општине одлучи да се приступи доношењу или промени Статута општине, истим актом одређује Комисију за израду нацрта статута, односно одлуке о промени Статута општине, одређује њене задатке и рок за израду нацрта.

Нацрт статута, односно одлуке о промени статута утврђује Општинско веће већином гласова од укупног броја чланова Општинског већа.

О нацрту статута, односно одлуке о промени статута спроводи се јавна расправа на начин и у року који одреди Општинско веће.

Општинско веће, након спроведене јавне расправе, утврђује предлог статута, односно одлуке о промени статута, већином гласова од укупног броја чланова Општинског већа. Приликом утврђивања предлога статута, односно одлуке о промени статута, Општинско веће водиће рачуна о предлозима и сугестијама датим у јавној расправи.

Скупштина општине усваја статут, односно одлуку о промени Статута већином гласова од укупног броја одборника.

ХП. ПРЕЛАЗНЕ И ЗАВРШНЕ ОДРЕДБЕ

**Усклађивање прописа Општине са овим
статутом
Члан 161.**

Прописи Општине остају на снази до њиховог усклађивања са овим статутом.

**Образовање Изборне комисије и
Другостепене изборне комисије
Члан 162.**

Скупштина општине именуваће председника, чланове и секретара Изборне комисије и њихове заменике, у року од 90 дана од дана ступања на снагу овог статута.

Истовремено са именовањем из става 1. овог члана, Скупштина општине именуваће председника, чланове и секретара Другостепене изборне комисије.

**Локални омбудсман
Члан 163.**

Заштитник грађана наставља са радом као локални омбудсман до истека мандата на који је изабран.

**Доношење планских докумената у
складу са овим статутом
Члан 164.**

Скупштина општине донеће План развоја Општине најкасније до 01.01.2021. године.

Скупштина општине донеће Средњорочни план у складу са законом који уређује плански систем РС, почев од средњорочног плана за 2021. годину.

Важећи документи јавних политика ускладиће се са законом из става 2. овог члана, приликом првих измена и допуна тих докумената.

**Престанак важења Статута
Члан 165.**

Даном ступања на снагу овог статута, престаје да важи Статут општине Прешево („Службени гласник Пчињског округа“, број 26/08), Одлуке о измену и допуну Статута општине Прешево („Службени гласник општине Бујановац“, број 07/13), и Одлуке о измену и допуну Статута општине Прешево („Службени гласник Града Враћа“, број 26/13).

**Ступање на снагу
Члан 166.**

Овај статут ступа на снагу осмог дана од дана објављивања у „Службеном гласнику општине Бујановац“.

СКУПШТИНА ОПШТИНЕ ПРЕШЕВО

I. Број: 110-19

Дана: 31.05.2021

Прешево

Председник
Сами Салиху

Нë мбëштетје тë нени 11 дхе нени 32 пика 1 Лигјит мби ветадминистримин локал („Фл.зиртаре е Републикëс сë Сербисë“, нр. 129/07, 83/14 – лигји тјетër, 101/16 – лигји тјетër дхе 47/2018) дхе нени 35 ал. 1 пика 1 дхе нени 112 ал. 1 Стаутит тë комунëс Прешевë („Фл.зиртаре е Ррëхит тë Пчинјës“, нр. 26/08) дхе нени 4 Вëдмит мби ндрйшимин дхе плотëсимин е Стаутит тë комунëс Прешевë („Фл.зиртаре е Комунëс сë Бујаночит“, нр. 07/2013) Кувëди и комунëс Прешевë, нë мблëдхјен е мбajтур мë 28.05.2021, пас маррјес сë мëдмит тë Министрисë пëр администратë сштетëрорë дхе ветадминистримин локал нр. 110-00-00199/2019-24 тë датës 23.09.2020, сжлë кëtë:

STATUT TË KOMUNËS PRESHEVË I. DISPOZITAT BAZË Lënda e Rregullimit Neni 1.

Мë кëtë Стаут нë пajтим мë Лигјин ррегulloхен крýсисшт: тë дрëжат дхе дëтырат е комунëс сë Прешевës (нë текстин вјуес: Комуна) дхе мëнйра е рëализимит тë tyre, нумри и кëшилларëвë тë Кувëдит тë комунëс Прешевë (нë текстин вјуес: Кувëди и комунëс), организими дхе пуна е органевë дхе шëрбимевë, пëрдорими зыртар и гжухës дхе шжкримит тë пакичавë комбëтарë, мëнйра е мëнаххимит тë қytетарëвë мë пунët нга компетенца е комунëс, куштет пëр рëализимин е формës сë дрëжт пëр дрëжтë тë ветадминистримит, збатими и пëрцëдурës сë дискутимит публик мë растин е пëргадитјес сë актевë тë пëргжйтшмë тë пëрцактуара мë кëtë Стаут, тëмëлимин, мëнйрën е згжëдхјес сë органевë дхе пунës сë Башкëсивë локалë дхе формавë тјера тë ветадминистримит локал, куштет дхе формат е рëализимит тë башкëпунимит дхе шоқëроризимит тë комунавë, мбрöjtја е ветадминистримит локал дхе çështјет тјера мë рëндëси пëр комунën.

Тë гжйта термет нë кëtë Стаут тë пëрдорурë нë гжининë машкуллорë нëнкуптојнë гжининë натйрорë машкуллорë дхе фëмëрорë.

Pozita e Komunës Neni 2.

Комуна ëштë нјëси тëрриториалë нë тë цилën қytетарët рëализöјнë тë дрëжтën нë ветадминистримин локал, нë пajтим мë Куштетутën, лигјин дхе кëtë Стаут.

Қytетарët тë цилët канë тë дрëжтë votimi дхе вëдбаним нë тëрриторин е комунëс, удхëхëқин мë пунët е комунëс нë пajтим мë Лигјин дхе кëtë Стаут.

Қytетарët маррин пјесë нë рëализимин е ветадминистримит локал мë анë тë инициативës қytетарë, тубимит тë қytетарëвë, рëфëрëндумит, формавë тјера тë пјësëmarrјес сë қytетарëвë нë крýрјен е пунëвë тë комунëс дхе нëпëрмëс тë кëшилларëвë тë вëtë нë Кувëдин е комунëс нë пajтим мë Куштетутën, Лигјин дхе кëtë Стаут.

Territori Neni 3.

Тëрриторин е Комунëс сë Прешевës, тë пëрцактуар мë Лигј, е пëрбëјнë вëдбанимет, гжëгжëсисшт тëрриторет дхе комунат кадастралë, тë цилët хйјнë нë пëрбëрјен е сaj дхе атë:

Numri rendor	Vendbanimi	Komuna kadastrale
1.	Geraј	Geraј
2.	Bërçec	Bërçec
3.	Buhiç	Buhiç
4.	Bukuroc	Bukuroc I
		Bukuroc II
5.	Bukoc	Bukuc
6.	Bushtan	Bushtan
7.	Gare	Gare
8.	Golemi Doll	Golemi Doll
9.	Shoshaj e Epërme	Shoshaj e Epërme
10.	Gosponic	Gosponic
11.	Depcë	Depcë
12.	Shoshaj e Poshtme	Shoshaj e Poshtme
13.	Zhunicë	Zhunicë I
		Zhunicë II
14.	Ilinca	Ilinca
15.	Kurbali	Kurbali
16.	Lanik	Lanik
17.	Maxhere	Maxhere
18.	Miratoc	Miratoc
19.	Norçë	Norçë
20.	Rahovicë	Rahovicë
21.	Peçen	Peçenë
22.	Preshevë	Preshevë
23.	Raincë	Raincë

24.	Ranatoc	Ranatoc
25.	Leran	Leran
26.	Svinjisht	Svinjishtë
27.	Sefer	Sefer
28.	Sllavujevc	Sllavujevc
29.	Stanec	Stanec
30.	Strezoc	Strezoc
31.	Tërnavë	Tërnavë I
32.	Cakanoc	Cakanoc
33.	Caravajkë	Caravajkë
34.	Corroticë	Corroticë
35.	Çukarkë	Çukarkë

Cilësia e personit juridik

Neni 4.

Komuna e Preshevës ka cilësinë e personit juridik.

Selia e komunës është në vendbanimin e Preshevës rruga M.Tito, nr. 36, 17523 Preshevë.

Komuna ka prezentimin e saj zyrtar në internet në adresën www.presevo.rs

Vula

Neni 5.

Organet e Komunës kanë vulën.

Vula ka formë të rrumbullakët me diametër 50 mm, me tekstin e shkruar: Republika e Serbisë, Komuna e Preshevës, emërtimi dhe selia e organit e shkruar në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik dhe gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj dhe stemën e Republikës së Serbisë në mes.

Gjuha dhe shkrimi

Neni 6.

Në territorin e komunës në përdorim zyrtar është gjuha serbe dhe shkrimi qirilik dhe gjuha shqipe me shkrimin e saj, në mënyrë të përcaktuar me Kushtetut, me Ligj dhe me Statut të komunës.

Simbolet e Komunës

Neni 7.

Komuna ka stemën dhe flamurin.

Përdorimi i flamurit dhe stemës më për së afërmi rregullohet me Vendimin e Kuvendit të komunës dhe mund të vëhet krahas me simbolet shtetërore.

Në lokalet zyrtare të organit të komunës vendosen simbolet shtetërore dhe stema dhe flamuri i komunës së Preshevës.

Flamuri është në formë këndrejt me dimensione 1:1,75 në vertikale dhe horizontale, ngjyra e flamurit në bazë është e kuqe në mes është e vendosur stema e komunës.

Stema përbëhet prej medalionit të formës gjysëmharkore nga ana e sipërme, në të është e vendosur ndërtesa e Kuvendit të komunës Preshevë, nën lidhet forma e trekëndshit në të cilën në qark në mes gjindet zbukurimi gjysëmharkor me ngjyrë të kaltërt me pesë yje në te (simboli universal i jetës së përbashkët dhe kaltërsia e qytetarëve, nën te është e shkruar në dy gjuhë me fontin “Times New Roman” emri i qytetit të Preshevës.

Gjithashtu mbrenda trekëndshit janë të vendosur dy trekëndsha, njëri me ngjyrë të kuqe me lara të zeza në te që janë të vendosura nën vijën e lartë të trekëndshit të madh dhe të tjerat me ngjyrë të gjelbërt që gjinden në anën e poshtme të trekëndshit.

Përdorimi i simboleve të Komunës

Neni 8.

Flamuri dhe stema e Komunës mund të vendosen vetëm së bashku me simbolet shtetërore.

Në hapsirat zyrtare të organit të Komunës vendosen vetëm simbolet shtetërore dhe stema dhe flamuri i Komunës.

Festa e Komunës

Neni 9.

Komuna ka festën.

Festa e komunës përcaktohet me Vendim të posaçëm të cilën e miraton Kuvendi i komunës me pëlqimin e mëparshëm të Ministrisë kompetente për punët e vetadministrimit lokal.

Çmimet dhe mirënjohjet publike

Neni 10.

Komuna cakton shpërblimet dhe mirënjohjet publike organizatave dhe qytetarëve për krijimtari të rëndësishme në ekonomi, shkencë, art, sport dhe lëmit tjera shoqërore.

Komuna ndan titullin (qytetarë nderi) personit puna dhe të arriturat e të cilit janë me rëndësi të veçantë për komunën.

Kuvendi i komunës vendosë për ndarjen e titullit “qytetarë nderi” me pëlqimin e mëparshëm të ministrisë kompetente për punët e vetadministrimit lokal.

Shpërblimet dhe mrënjohjet tjera publike dhe titulli “qytetarë nderi” ndahen me rastin e festës së komunës.

Llojet e shpërblimeve dhe mirënjohjet tjera publike, procedura kushtet dhe kriteret për ndarjen e mirënjohjeve publike dhe titullit “qytetarë nderi” rregullohen me Vendim të posaçëm.

Përcaktimi i emërimit të pjesëve të vendbanimeve

Neni 11.

Komuna përcakton emërtimin e rrugëve, shesheve, shesheve të qytetit, rrugëve në fshatra dhe pjesëve tjera të vendbanimeve në territorin e vetë me Vendim të veçantë, me pëlqimin e mëparshëm të Ministrisë kompetente për punët e vetadministrimit lokal.

Në procedurën e ndryshimit të emërimit të rrugëve, shesheve, shesheve të qytetit, rrugëve në fshatra dhe pjesëve tjera të vendbanimeve merret mendimi i Këshillit nacional të shqiptarëve të pakicave nacionale dhe Pleqësisë për marrdhënie ndërnacionale.

Puna publike

Neni 12.

Puna e organit të komunës është publike.

Puna publike sipas rregullave sigurohet me:

5. me anë të nxjerrjes së revistave, informatorëve, nëpërmes të mjeteve të informimit publik, me prezentimin e vendimeve dhe bashkëpunimi me mediat, prezentimin e Vendimeve dhe akteve tjera, opinionit dhe prezentimin me internet;
6. me organizimin e diskutimeve publike në pajtim me Ligjin, me këtë Statut dhe Vendimet e organeve të komunës;
7. me organizimin e dëgjimit publik në pajtim me këtë Statut dhe me Rregulloren e Kuvendit të komunës dhe
8. në raste tjera të përcaktuara me këtë Statut dhe me akte tjera të organit të komunës.

Komuna informatat dhe njoftimet e veta i shpall edhe në gjuhën shqipe dhe shkrimin shqip.

Prona e Komunës

Neni 13.

Komuna ka pronën e vetë.

Me pronën e komunës në mënyrë të pavarur udhëheqin dhe disponojnë organet e komunës në pajtim me Ligjin, me këtë Statut dhe me akte tjera të komunës.

Në pronë publike të komunës në pajtim me Ligjin janë:

- të mirat në përdorim të përgjithshëm në territorin e Komunës (rrugët komunale, rrugët e pakategorizuara, rrugët që nuk janë pjesë e autostradës ose rrugës shtetërore të rendit të I dhe II, sheshet dhe parqet publike etj.);

- rrjeti komunal në territorin e komunës;

- gjërat e patundshme dhe të tundshme dhe të drejtat tjera pronësore të cilat i shfrytëzojnë organet dhe organizatat e Komunës;

- gjërat në pronën publike në të cilat të drejtë shfrytëzimi kanë Bashkësit lokale në territorin e komunës, institucionet, agjencit publike dhe organizatat tjera themelues i të cilëve është Komuna;

- gjërat tjera të së patundshme dhe të tundshme dhe të drejtat pronësore në pajtim me Ligjin me të cilin rregullohet prona publike.

II. KOMPETENCAT E KOMUNËS

Kompetencat e Komunës

Neni 14.

Komuna kryen punët nga kompetenca e vetë të përcaktuara me Kushtetën, Ligjin, si dhe punët në kuadër të drejtave dhe detyrave të Republikës të cilat me Ligj i janë besuar.

Kompetencat e përcaktuara me Kushtetut dhe me Ligj

Neni 15.

Komuna nëpërmes organeve të veta, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin:

1) Nxjerr Statutin, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare, planin hapësinor dhe urbanistik dhe planin e zhvillimit të komunës, si dhe planin dhe programin strategjik të zhvillimit ekonomik lokal;

2) rregullon dhe siguron kryerjen dhe zhvillimin e veprimtarive komunale, transportin lokal, shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe hapësirës afariste,

3) kujdeset për ndërtimin, rekonstruimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e rrugëve të pakategorizuara dhe komunale si

dhe rrugët dhe objektet tjera publike me rëndësi komunale;

4) kujdeset për plotësimin e nevojave të qytetarëve në lëmin e arsimit (edukimit dhe arsimimit parashkollor dhe arsimimit dhe edukimit të arsimit fillor dhe të mesëm), veprimtarit shkencor hulumtues dhe inovacionet, kulturë, shëndetsi dhe mbrojtje sociale, mbrojtjen e fëmijëve, sport dhe kulturë fizike;

5) siguron realizimin e nevojave të posaçme për personat me invaliditet dhe mbrojtjen e të drejtave grupeve të ndjeshme;

6) kujdeset për zhvillimin dhe avansimin e turizmit, zejtarisë, hotelierisë dhe tregtisë;

7) nxjerr dhe realizon programe për arritjen e zhvillimit ekonomik lokal, ndërmerr aktivitete për mirëmbajtjen e investimeve ekzistuese dhe tërheqjen e investimeve të reja dhe avansimin e kushteve të përgjithshme të afarizmit,

8) kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor, mbrojtjen nga fatkeqësit elementare dhe fatkeqësit tjera, mbrojtjen e të mirave kulturore me rëndësi për komunën;

9) sjell vendim mbi organizimin dhe punën e organeve të komunës së Preshevës në gjendjen e luftës dhe ate të jashtëzakonshme;

10) sjell aktin-vendimin mbi organizimin dhe funksionimin e sigurisë civile në teritorin e komunës së Preshevës, me propozim të shtabit komunal për emergjenca dhe siguron aplikim e tij;

11) përpilon dhe aprovon vlerësimin e rrezikut, planin e zvoglimit të rrezikut nga katastrofat, planin e sigurisë dhe shpëtimit;

12) formon shtabin komunal për emergjenca;

13) përcakton subjektet me rëndësi të veçantë për siguri dhe shpëtim të komunës së Preshevës me propozim të shtabit komunal për emergjenca dhe siguron aplikim e tij;

14) planifikon dhe siguron mjete buxhetore të destinuar për zvoglim të rrezikut nga katastrofat dhe udhëheqjen e situatave emergjente;

15) formon njësinë e sigurisë civile për destinim të përgjithshëm;

16) formon qendrën e situatave në pajtim me aktin e organizimit të sigurisë civile, mvarësisht nga mundësitë teknike dhe material;

17) përpilon studimin e mbulimit të sistemit për alarmin publik për teritorin e vetë

(studimin akustik) dhe përkujdeset për mirëmbajtjen, furnizimin dhe vendosjen e burimeve akustike (sirenave) dhe pajisjeve tjera në kuadër të sistemit unik republikan për alarmim publik;

18) bashkëpunon me komunat fqinje në aplikimin e masave dhe aktiviteteve me rëndësi për zvoglimin e rreziqeve nga katastrofat dhe udhëheqjen e situatave emergjente;

19) ndërmerr masa urgjente preventive me qëllim të zvoglimit të rrezikut nga katastrofat;

20) aprovon planin vjetor të punës dhe raportin për punën e shtabit komunal për emergjenca;

21) kujdeset për mbrojtjen, rregullimin dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe zbaton politikën e zhvillimit rural;

22) kujdeset për realizimin, mbrojtjen dhe avansimin e të drejtave njerëzore dhe pakicave, barazinë gjinore si dhe për informimin publik në komunë;

23) formon dhe rregullon organizimin dhe punën e organit, organizatave dhe shërbimeve për nevojat e komunës, organizon shërbimin e ndihmës juridike qytetarëve dhe rregullon organizimin dhe punën e këshillave të pajtimit;

24) cakton simbolet e komunës dhe përdorimin e tyre;

25) menaxhon me pasurin e komunës dhe përcakton shkallën e të hyrave burimore si dhe lartësin e taksës lokale;

26) parasheh kundërvajtjet për shkeljet e dispozitave komunale,

27) kryen edhe punë tjera me rëndësi lokale të përcaktuara me Ligj, si dhe punët nga interesi i drejt për drejtë për qytetarët, në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe me këtë Statut.

Punët nga kompetenca e komunës të përcaktuara me Kushtetut dhe me Ligj, më për së afërmi janë të përcaktuara me regjistrimin e përbashkët të punëve të njërive të vetadministrimit lokal të cilën e siguron Ministria kompetente për vetadministrimin lokal në pajtim me Ligjin.

Shërbimet publike të komunës

Neni 16.

Për realizimin e të drejtave dhe detyrave të veta dhe për plotësimin e nevojave të banorëve lokal, komuna mundet të themelon: ndërmarrje, institucione dhe

organizata të tjera që kryejn shërbime publike, në pajtim me Ligjin dhe me këtë Statut.

Kuvendi i komunës me vendim të posaçëm themelon ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera të cilat kryejnë shërbime publike dhe realizon të drejta themeluese, nëse me Ligj ose me Statut për kryerjen e disa të drejtave të themeluesit nuk është përcaktuar kompetenca e organit tjetër të komunës .

Të besuarit punëve personit juridik ose fizik

Neni 17.

Komuna mundet me Kontratë në parimet e konkurrencës, opinionit, ekonomizimit, efikasitetit dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor t’ia beson personit juridik ose fizik kryerjen e disa punëve nga kompetenca e vetë.

Të besuarit e punëve nga al.1 i këtij neni rregullohet me Vendim të Kuvendit të komunës.

III. FINANSIMI I PUNËVE TË KOMUNËS

Mjetet për kryerjen e punëve dhe burimet e mjeteve

Neni 18.

Për kryerjen e punëve të komunës të përcaktuara me Kushtetut dhe me Ligj, si dhe kryerjen me Ligj të punëve të besuara nga kornizat e të drejtave dhe detyrave të Republikës, komunës i takojnë të hyrat dhe të marrurat të përcaktuara me Ligj.

Punët e Komunës finansohen nga të hyrat burimore dhe të ardhurat e ndara, transfer, të marrurat në bazë të huas (borxhit) dhe të hyrave dhe të marrurave tjera të përcaktuara me Ligj.

Karakterit i qëllimit të mjeteve

Neni 19.

Të gjitha të hyrat e komunës janë të gjitha të hyrat e përgjithshme të buxhetit dhe mund të shfrytëzohen për çdo dedikim, përveç atyre të hyrave karakteri i dedikimit të të cilave është i përcaktuar me Ligj.

Buxheti dhe llogaria përfundimtare

Neni 20.

Kuvendi miraton buxhetin e Komunës për çdo vit kalendarik, ku paraqiten të gjitha të hyrat dhe të marrurat, borxhet dhe transakcionet tjera finansiare, të dalat dhe të

dhënat tjera në pajtim me Ligjin që rregullon sistemin buxhetor.

Pas skadimit të vitit për të cilën është miratuar buxheti përpilohet llogaria përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit të komunës.

Përgjegjësit për ekzekutimin e buxhetit dhe raportimi

Neni 21.

Për ekzekutimin e buxhetit të komunës, kryetari i Komunës i përgjigjet Kuvendit të komunës.

Administrata komunale është e obliguar që me rregull të përcjell ekzekutimin e buxhetit e sipas nevojës. Më së paku 2 herë në vit ta njohton kryetarin e komunës e në mënyrë të obligueshme në afat prej 15 ditësh pas skadimit të gjashtë mujorshit, gjegjësisht periudhës nëntë mujore.

Kryetari i komunës, në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgesë së raportit nga al.2 i këtij neni, miraton dhe i dërgon raport Kuvendit të komunës.

Vetëkontributi

Neni 22.

Për plotësimin e nevojave të qytetarëve në komunë ose në pjesën e saj mjetet mund të grumbullohen me vetëkontribut. .

Vendimin mbi caktimin e vetkontributit e bien qytetarët me referendum, në pajtim me Ligjin, me të cilin rregullohet me deklarimin e drejt për drejtë të qytetarëve dhe më këtë Statut.

Përcaktimi i propozim vendimit

Neni 23.

Propozim vendimi mbi shpalljen e vetkontributit e përcakton Kuvendi i Komunës.

Iniciativën për nxjerrjen e Vendimit nga al.1 i këtij neni mund ta paraqet më së paku një e treta e këshilltarëve të Kuvendit të komunës dhe qytetarët me anë të iniciativës qytetare.

Me iniciativë paraqitet edhe programi me të cilën përcaktohen burimet, dedikimi dhe mënyra e sigurimit të mjeteve të tërësishme finansiare për realizimin e projektit që është lëndë e vendimit.

Sipas pranimi të iniciativës së rregullt Kuvendi i komunës vendos mbi fillimin e procedurës për shpalljen e vetëkontributit me

shumicë votash nga numri i tërsishëm i këshilltarëve.

Nëse Kuvendi i komunës pranon iniciativën për shpalljen e vetkontributit, nxjerr konkluzionin me të cilin njëkohësisht cakton afatin për përgaditjen e projekt vendimit mbi shpalljen e vetëkontributit dhe afatin dhe mënyrën e organizimit të diskutimit publik.

Propozim vendimin mbi shpalljen e vetkontributit Kuvendi i komunës e përcakton me shumicë votash nga numri i tërsishëm i këshilltarëve.

Nxjerrja e vendimit mbi shpalljen e vetëkontributit

Neni 24.

Vendimin mbi shpalljen e vetëkontributit e bien qytetarët të cilët kanë të drejtë vote dhe vendqëndrim në territorin në të cilën mjetet grumbullohen.

Vendimin nga al.1 të këtij neni e bien qytetarët të cilët nuk kanë të drejtë vote dhe vendqëndrim në territorin në të cilën mjetet grumbullohen, nëse në atë territor kanë pasuri të patundshme, ndërsa me mjetet e vetëkontributit përmirësohen kushtet e shfrytëzimit të pasurisë.

Vendimi nënkuptohet i miratuar kur për ate deklarohet shumica nga numri i tërsishëm i qytetarëve nga al.1 dhe 2 të këtij neni.

Shpallja e vendimit mbi shpalljen e vetëkontributit

Neni 25.

Vendimi mbi shpalljen e vetëkontributit shpallet në atë mënyrë në të cilën shpallen aktet e Komunës.

Karakterit i dedikimit të mjeteve të vetëkontributit

Neni 26.

Mjetet në të holla të cilat grumbullohen në bazë të vendimit mbi vetëkontributin janë të hyra të buxhetit dhe në mënyrë strikte janë me dedikim.

IV. ORGANET E KOMUNËS

Organet e Komunës

Neni 27.

Organet e komunës janë Kuvendi i komunës, Kryetari i komunës, Këshilli komunal dhe Administrata komunale.

Në pajtim me Ligjin me të cilin rregullohet avokatura, organ i komunës është edhe Avokatura komunale.

Prezumimi i kompetencave

Neni 28.

Punët e Komunës i kryejnë organet e komunës në kuadër të kompetencave të veta të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut.

Kuvendi i komunës bjen aktet me karakter të përgjithshëm.

Nëse me Ligj ose me dispozita tjera nuk është përcaktuar cili organ është kompetent për kryerjen e punëve nga kompetenca e komunës, të gjitha punët që mbështeten në rregullimin e raporteve nga kompetenca e komunës i kryen Kuvendi i komunës, ndërsa punët të cilat sipas natyrës së vetë janë ekzekutive i kryen kryetari i komunës.

Nëse sipas natyrës së punëve nuk mund të përcaktohet kompetenca në pajtim me al.2 të këtij neni, kompetent është Kuvendi i komunës.

3. Kuvendi i komunës

Pozita e Kuvendit të komunës

Neni 29.

Kuvendi i komunës është organ më i lartë i komunës, i cili kryen funksionet bazë të vetëqeverisjes lokale, të përcaktuara me Kushtetut, me Ligj dhe me këtë Statut.

Përbërja e Kuvendit të komunës

Neni 30.

Kuvendin e komunës e përbëjnë këshilltarët të cilët i zgjedhin qytetarët në zgjedhjet e drejt për drejta, me vota të mshefta, në pajtim me Ligjin dhe me këtë Statut.

Konvokimi i seancës konstitutive

Neni 31.

Seancën e përbërjes së re të Kuvendit të komunës e konvokon kryetari i Kuvendit të komunës të përbërjes së mëparshme, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve.

Nëse Kryetari i kuvendit të komunës nga përbërja e mëparshme nuk e konvokon seancën e përbërjes së re në at afat nga al.1 i këtij neni, seancën e përbërjes së re do ta konvokon kandidati më i vjetër për këshilltar i përbërjes së re në afat prej 15 ditësh nga dita e skadimit të afatit nga al.1 i këtij neni.

Seancën e udhëheq këshilltari më i vjetër deri në zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit të komunës.

Konstituimi i Kuvendit

Neni 32.

Kuvendi i komunës nënkuptohet i konstituuar më zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit të komunës dhe emërimin e sekretarit të Kuvendit të komunës.

Numri i këshilltarëve

Neni 33.

Kuvendi i komunës ka 38 këshilltarë.

Mandati

Neni 34.

Këshilltarët zgjedhen për 4 vite.

Këshilltarit i fillon dhe i pushon mandati i këshilltarit me kushtet dhe mënyrën e përcaktuar me Ligj.

Betimi

Neni 35.

Këshilltarët e zgjedhur japin betimin e cila ka këtë përmbajtje: “Betohe se në punën e Kuvendit të komunës Preshevë do ti përmbahem Kushtetutës, Ligjit dhe Statutit të Komunës Preshevë dhe me nder dhe në mënyrë të paanshme do të kryej detyrën e këshilltarit duke udhëhequr me interesat e qytetarëve”.

Papajtshmëria e funksioneve

Neni 36.

Këshilltari nuk mund të jetë i punësuar në administratën komunale dhe personi të cilin e emëron, gjegjësisht e zgjedh Kuvendi i komunës.

Nëse i punësuar në Administratën komunale të jetë zgjedhur për këshilltarë, të drejtat dhe obligimet në bazë të punës i pushojnë deri në zgjatjen e mandatit të tij të këshilltarit.

Me ditën e verifikimit të mandatit të këshilltarit personave të cilët i ka emëruar gjegjësisht zgjedhur Kuvendi i komunës i pushon funksioni në të cilën janë emëruar gjegjësisht zgjedhur.

Imuniteti i këshilltarit

Neni 37.

Këshilltari nuk mund të jetë i thirrur në përgjegjësi penale, i burgosur ose i dënur për arsye të paraqitjes së mendimit ose dhënjes

së votës në seancën e Kuvendit të komunës dhe trupave punuese.

Të drejtat dhe detyrat e këshilltarëve

Neni 38.

E drejta dhe detyra e këshilltarit është të merr pjesë në punën e Kuvendit të komunës dhe trupave të tij punues, ti propozon Kuvendit të komunës diskutime mbi çështjet e caktuara, ti propozon trupit punues të Kuvendit të komunës, të organizon dëgjim publik për propozimet e dispozitave dhe vendimeve për të cilat vendos Kuvendi i komunës, paraqet propozim vendime dhe akte tjera nga kompetenca e Kuvendit të komunës dhe jep amandamente në propozimet e dispozitave, parashtron pyetje lidhur me punën e organeve të komunës dhe merr pjesë në aktivitetet tjera të Kuvendit të komunës.

E drejta e këshilltarit është që me rregull të jetë i njoftuar për çështjet me ndikim në kryerjen e detyrës së këshilltarit që në kërkesë personale të merr nga organet dhe shërbimet e komunës shënimet që i janë të duhura për punë si dhe ndihmën profesionale mbi përgaditjen e propozimeve për Kuvendin e komunës.

Për dërgesën me kohë të njoftimit, shënimeve të kërkuara lëndëve dhe udhëzimeve është përgjegjës sekretari i Kuvendit të komunës, ndërsa kryeshefi i Administratës komunale kur njoftimet, shënimet e kërkuara, lëndët dhe udhëzimet që mbështeten në fushëveprimin e punës së Administratës komunale.

Këshilltari ka të drejtë që ti drejtohet Kuvendit të komunës në njërin nga gjuhët që është në përdorim zyrtar në territorin e komunës.

Këshilltari ka të drejtë në mbrojtjen e mandatit, duke kyçur edhe mbrojtjen e Gjykatës, e cila realizohet në përshtatshmëri me zbatimin e Ligjit me të cilën rregullohet mbrojtja e të drejtave zgjedhore në procedurën zgjedhore.

Të drejtat dhe detyrat e këshilltarëve më për së afërmi caktohen me Rregulloren e Kuvendit të komunës.

Kompenzimet dhe të marrurat tjera të këshilltarëve

Neni 39.

E drejta e këshilltarëve në humbjen e rrogës, shpenzimet e rrugës për ardhje dhe shkuarje në seancat e Kuvendit të komunës dhe trupave të tij punues, mëditjet dhe në kompenzimin e shpenzimeve tjera lidhur me kryerjen e funksionit të këshilltarëve rregullohet me Vendim të posaçëm të Kuvendit të komunës.

Kompetencat e Kuvendit të komunës

Neni 40.

Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligjin;

- 72) Bjen Statutin e komunës dhe Rregulloren e Kuvendit të komunës;
- 73) Bjen buxhetin dhe miraton llogarin përfundimtare të buxhetit;
- 74) Përcakton shkallën e të hyrave të komunës, si dhe mënyrën dhe masat për përcaktimin e lartësisë së taksave lokale dhe kompenzimet;
- 75) Bjen planin e zhvillimit të komunës, dokumentacionet planore të politikave publike, planet afat mesme dhe dokumentet tjera planore në pajtim me Ligjin;
- 76) Bjen planin hapësinor dhe urbanistik të komunës;
- 77) Bjen dispozita dhe akte tjera të përgjithshme nga kompetenca e komunës;
- 78) Zgjedh dhe shkarkon mbrojtësin lokal (ombudsman);
- 79) Shpall referendumin komunal dhe referendum në pjesën e territorit të komunës, deklarohet për propozimet e përmbajtura në iniciativën qytetare dhe përcakton propozim- vendimin mbi vetëkontributin;
- 80) Formon dhe rregullon organizimin dhe punën e organizimit në shërbim për nevojat e komunës;
- 81) Themelon ndërmarrjet publike dhe shoqërit kapitale për kryerjen e veprimtarive nga interesi i përgjithshëm në pajtim me Ligjin dhe me këtë Statut, jep pëlqimin në aktet e caktuara të përgjithshme me Ligj dhe aktet tjera juridike dhe punën e ndërmarrjeve publike, gjegjësisht shoqërit kapitale, për arsye të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm ;
- 82) Themelon institucione dhe organizata në lëmin e arsimit dhe edukimit parashkollor, arsimit fillor dhe

kulturës me rëndësi për komunën dhe për pjestarët e të gjitha bashkësive nacionale, mbrojtjen sociale, mbrojtjen primare shëndetësore, kulturës fizike, sport, rinis, mbrojtjen e fëmijëve dhe turizmit përcjell dhe siguron funksionimin e tyre;

- 83) Emëron dhe shkarkon Këshillin mbikqyrës dhe drejtorin e Ndërmarrjes publike themelues i të cilit është, jep pëlqim në Statutin e Ndërmarrjes publike dhe kryen të drejtat tjera të themeluesit në pajtim me Ligjin dhe aktin themelues;
- 84) Emëron dhe shkarkon Këshillin drejtues, këshillin mbikqyrës dhe drejtorin e Institucionit, organizatës dhe shërbimit themelues i të cilit është dhe jep pëlqim në statutet e tyre në pajtim me Ligjin;
- 85) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Kuvendit dhe zëvendës kryetarin e Kuvendit;
- 86) Emëron dhe shkarkon sekretarin dhe zëvendës sekretarin e Kuvendit,
- 87) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Komunës dhe në propozim të kryetrit të Komunës, zgjedh zëvendës kryetarin e Komunës dhe anëtarët e Këshillit komunal;
- 88) Emëron Komisionin zgjedhor për zbatimin e zgjedhjeve për këshilltarë të Kuvendit të komunës në pajtim me Ligjin;
- 89) Emëron dhe shkarkon urbanistin kryesor;
- 90) Miraton Planin kadrovik;
- 91) Rregullon kushtet dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë komunale, të drejtat dhe obligimet e shfrytëzuesve të shërbimeve komunale, vëllimin dhe kualitetin e shërbimeve komunale dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes ndaj kryerjes së veprimtarive komunale, themelon ndërmarrje publike për kryerjen e veprimtarive komunale, gjegjësisht beson kryerjen e atyre veprimtarive shoqërore kapitale ose ndërmarrësit, parasheh kushtet e përgjithshme të mirëmbajtjes së rendit dhe masave komunale për zbatimin e tyre;
- 92) Nxjerr programin vjetor dhe afatmesëm të rregullimit të tokës ndërtimore, vendos për tjetërsimin e

- tokës ndërtimore në pajtim me Ligjin dhe dispozitat e Komunës;
- 93) Nxjerr Strategjinë lokale banesore në pajtim me Strategjinë nacionale banesore, Planin akcional për zbatimin e saj dhe programet e përkrahjes banesore, mund të themelon agjencionin publik banesor në pajtim me Ligjin, si dhe personin juridik për kryerjen e punëve nga interesi i publik në lëmin e banimit;
- 94) Rregullon shfrytëzimin e hapsirës afariste që është në pronë publike të komunës, rregullon lartësin e qiramarrjes të hapsirës afariste dhe kryen punë tjera lidhur më shfrytëzimin e hapsirës afaristë, në pajtim me Ligjin dhe aktet tjera të komunës ;
- 95) Rregullon kriteret dhe procedurën e dhënjes së banesave me qera dhe blerjen e tyre;
- 96) Parashih lartësin e qiramarrjes për shfrytëzimin e ndërtesave banesore, banesave dhe garazheve në pronë publike të komunës ;
- 97) Më për së afërmi rregullon shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e gjërave në pronë publike të komunës ;
- 98) Rregullon mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve transportuese në pronë publike të komunës;
- 99) Rregullon më për së afërmi kushtet për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve;
- 100) Nxjerr programe të shfrytëzimit dhe mbrojtjes së vlerave natyrore dhe programet e mbrojtjes së mjedisit jetësor gjegjësisht akcionet lokale dhe planet e sanitimit, në pajtim me dokumentet strategjike dhe interesat dhe specifikatat e komunës dhe përcakton kompenzimin e veçantë për mbrojtjen dhe avansimin e mjedisit jetësor;
- 101) Nxjerr programin vjetor të mbrojtjes, rregullimit dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore, përcakton masat kundër erozionit dhe zbatimin e tyre, vendos për shëndrrimin e kullosave në kultura tjera;
- 102) Nxjerr programin e zhvillimit të turizmit në pajtim me strategjinë, përcakton lartësin e taksës së qëndrimit në territorin e komunës;
- 103) Nxjerr Planin akcional në luftën kundër korrupsionit në nivelin e komunës dhe formon trupin e përhershëm punues për përcjelljen dhe zbatimin e Planit lokal akcional;
- 104) Nxjerr programin e kontrollimit dhe zvoglimit të popullacionit të qenve dhe macave endacak, rregullon mbajtjen dhe mbrojtjen e kafshëve shtëpiake, në pajtim me Ligjin;
- 105) Nxjerr planin operativ për ujrat e rendit II, cakton vendin dhe mënyrën e shfrytëzimit të ujit për rekreacion, duke kyçur edhe notin ;
- 106) Nxjerr planin akcional për zbatimin e Strategjisë nacionale për të rinjë në territorin e komunës, mund të themelon zyren për të rinjë;
- 107) Nxjerr programin dhe planin e efikasitetit të energjetikës;
- 108) Vendos për marrjen dhe tjetërsimin e të së patundshmes në pronë publike të komunës, themelimin e hipotekës në të patundshme në pronë publike të komunës si dhe bartjen e të drejtave të pronës nëbartësin tjetër të të drejtave të pronës publike;
- 109) Vendos mbi investimin e gjërave në pronë publike të komunës dhe të drejtat në kapitalin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive kapitale themelues i të cilëve është në pajtim me Ligjin;
- 110) Vendos për bartjen e të drejtave të shfrytëzimit në gjërat në pronë të komunës, institucioneve, agjencit publike dhe organizatat tjera themelues i të cilëve është komuna;
- 111) Vendos mbi dhënjen e koncesionit kur janë organe publike dhe objekt i koncesionit në kompetenc të komunës, jep pëlqim në aktin e koncesionit;
- 112) Jep pëlqimin dhe miraton propozim projektin e partneritetit publiko-privat, jep pëlqim në projekt kontratën publike në projektin e partneritetit publiko-privat dhe jep autorizimin kryetarit të komunës të nënshkruan kontratën publike në emër të komunës;

- 113) Formon shtabin për situata të jashtëzakonshme, nxjerr planin dhe programin e zhvillimit të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit;
- 114) Formon rezervat e mallit dhe përcakton vëllimin dhe strukturën e tyre;
- 115) Përcakton taksat komunale dhe të hyrat tjera lokale, të cilat i takojnë komunës sipas Ligjit;
- 116) Përcakton lartësin e kontributit për rregullimin e tokës ndërtimore;
- 117) Përcakton kompenzimin për shërbimet komunale dhe jep pëlqim në vendimin mbi ndryshimin e çmimit të shërbimeve komunale në pajtim me Ligjin;
- 118) Përcakton kriteret dhe procedurën për regresimin e shpenzimeve të qëndrimit në entet parashkollore për fëmijët nga familjet e rrezikuara materiale;
- 119) Nxjerr aktet mbi borxhin publik të komunës, në pajtim me Ligjin me të cilin rregullohet borxhi publik;
- 120) Parashih orarin e punës në objektet e hotelieris, tregtisë dhe zejtarisë;
- 121) jep mendimin mbi Planin hapësinor Republikan, krahinor dhe regional ;
- 122) themelon trupat e përhershëm dhe të përkohshëm punues për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vetë ;
- 123) paraqet iniciativën për fillimin e procedurës së themelimit, shkëputjes ose ndryshimit të territorit të komunës;
- 124) i propozon Qeverisë së Republikës së Serbisë për caktimin e interesit publik për eksproprijim në dobi të komunës;
- 125) jep mendimin mbi Ligjet me të cilat rregullohen çështjet nga interesi për vetadministrimin lokal;
- 126) shqyrton raportin mbi punën dhe jep pëlqimin në programin e punës shfrytëzuesve të buxhetit ;
- 127) vendos mbi bashkëpunimin dhe shoqërorizimin me qytetet dhe komunat, bashkimin, organizatat humanitare dhe të tjera;

- 128) informon opinionin për punën e vetë;
- 129) fillon procedurën për vlerësimin e kushtetushmërisë dhe ligjshmërisë të ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm të Republikës së Serbisë me të cilën shkelen të drejtat në vetadministrimin lokal;
- 130) organizon shërbimin e ndihmës juridike qytetarëve;
- 131) rregullon organizimin dhe punën e këshillave të pajtimit;
- 132) cakton festën e Komunës;
- 133) jep pëlqimin në përdorimin e emrit, stemës dhe shënimeve tjera të komunës;
- 134) rregullon procedurën, kushtet dhe kriteret për ndarjen e mirënjohjeve publike dhe titullit të nderit të cilat i ndanë Komuna dhe vendosë për ndarjen e mirënjohjeve publike dhe titullit të nderit;
- 135) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve pjesëve të shesheve, pjesëve të fshatrave dhe pjesëve tjera të vendbanimeve ;
- 136) shqyrton dhe miraton raportet vjetore mbi punën e Ndërmarrjeve publike, institucioneve dhe shërbimeve tjera publike, themelues ose pronar i shumicës është komuna ;
- 137) shqyrton raportet e këshillave për marrëdhënie ndërnacionale;
- 138) shqyrton raportin mbi punën e mbrojtësit lokal (ombudsmanit);
- 139) shqyrton raportin vjetor të urbanistit kryesor mbi gjendjen në hapsirë;
- 140) miraton kodin etik të sjelljes së funksionerëve (në tekstin vijues: Kodi etik);
- 141) nxjerr masat dhe miraton sygjerimet për avansimin e të drejtave njerëzore dhe pakicave;
- 142) kryen edhe punë tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut.

Kuorumi për punë dhe vendosje

Neni 41.

Kuvendi i komunës vendos nëse në seancë marrin pjesë shumica nga numri i tërësishëm i këshilltarëve.

Kuvendi i komunës vendos me shumicë votash të këshilltarëve prezent, nëse

me Ligj ose me këtë Statut nuk është e caktuar ndryshe.

Kuvendi i komunës me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve:

- 1) nxjerr Statutin,
- 2) nxjerr buxhetin dhe miraton llogarin përfundimtare të buxhetit;
- 3) nxjerr planin e zhvillimit të komunës dhe strategjitë me të cilat përcaktohen drejtimet e veprimit të komunës në lëmin e caktuar;
- 4) nxjerr Planin hapësinor;
- 5) nxjerr Planin urbanistik;
- 6) vendos mbi huazimin publik të Komunës;
- 7) vendos mbi bashkëpunimin dhe shoqërorizimin me njësit tjera të vetadministrimit lokal si dhe për bashkëpunimin me njësit e vetadministrimit lokal në shtetet tjera;
- 8) vendos mbi arsimimin, territorin për të cilën arsimohet, ndryshimin e territorit dhe shkëputjen e Bashkësisë lokale dhe formave tjera të Bashkësive lokale;
- 9) vendos mbi emërtimin e rrugëve, shesheve pjesëve të qytetit, pjesëve të fshatit dhe pjesëve tjera të vendbanimit;
- 10) cakton festën e Komunës;
- 11) vendos mbi ndarjen e titullit “Qytetarë i nderit” të Komunës;
- 12) nxjerr Vendimin mbi fushëveprimin, përbërjen, zgjedhjen e anëtarve dhe mënyrën e punës së Këshillit për marrëdhënie ndërnacionale;
- 13) miraton Kodin etik; dhe
- 14) vendos edhe për raste tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut.

Konvokimi

Neni 42.

Seancën e Kuvendit të komunës e konvokon kryetari i Kuvendit të komunës sipas nevojës, më së paku një herë në tre muaj.

Kryetari i Kuvendit të komunës është i obliguar që seancën ta konvokon me kërkesë të kryetarit të Komunës, Këshillit komunal ose një të tretës së këshilltarëve, në afat prej 7 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ashtu që dita e mbajtjes së seancës të jetë më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Në situatat që arsyetojnë urgjencën në konvokimin e seancës, kryetari i Kuvendit të komunës mund ta konvokon seancën në afatin që është më i shkurtër se 24 orë nga pranimi i kërkesës.

Kërkesa për konvokimin e seancës nga al.3 i këtij neni duhet të përmbajë arsyet që arsyetojnë azhurimin e konvokimit, si dhe arsyetimin e pasojave që do të bëhen me moskonvokimin e saj.

Afati minimal për konvokimin e seancës së Kuvendit të komunës nga al.3 i këtij neni, nuk mbështetet në konvokimin e seancës së Kuvendit në kushtet e shpalljes së situatës së jashtëzakonshme.

Nëse kryetari i Kuvendit të komunës nuk e konvokon seancën në afat nga al.2 i këtij neni, seancën mund ta konvokon paraqitësi i kërkesës, ndërsa ta kryeson këshilltari të cilin e cakton paraqitësi i kërkesës. .

Kryetari i Kuvendit të komunës mund ta shtynë seancën të cilën e ka konvokuar vetëm në rast kur nuk ka kuorum të duhur për punë, e në raste tjera për shtyerjen e seancës vendosë Kuvendi i Komunës.

Puna publike

Neni 43.

Seancat e Kuvendit të komunës janë publike.

Për punën publike të Kuvendit të komunës është përgjegjës kryetari i Kuvendit të komunës.

Ftesat e materialit për seancë të Kuvendit të komunës i dërgohen mjeteve të informimit për arsye të njoftimit të opinionit.

Në seancat e Kuvendit të komunës mund të marrin pjesë përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik, përfaqësuesit e autorizuar të propozuesve, si dhe personat e interesuar, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të komunës.

Në rastin që nuk ekziston mundësia që të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në seancën e Kuvendit, kryetari i Kuvendit do të vendos kujt do t’ia mundëson prezencën në seancë duke u nisur nga rradhitja e të paraqiturve dhe interesat e të paraqiturve për pikat në rend dite.

Kuvendi i Komunës mund të vendos që seanca e Kuvendit të mos jetë publike për arsye të sigurisë dhe shkaqeve tjera të përcaktuara me Ligj.

Trupat punues të Kuvendit të komunës

Neni 44.

Kuvendi i komunës formon trupat e përhershëm dhe të përkohshëm punues për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vetë.

Trupat punues japin mendimin ne propozimet e dispozitave dhe vendimeve të cilat i miraton Kuvendi i komunës dhe kryejnë punë tjera të përcaktuara me këtë Statut dhe Rregulloren e Kuvendit të komunës.

Me Rregulloren e Kuvendit të komunës përcaktohet numri dhe detyra e trupave të përhershëm punues, zgjedhja, të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të trupave të përhershëm punues, si dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e trupave të përhershëm punues.

Me aktin mbi formimin e trupit të përkohshëm punues përcaktohen emërtimet e saja dhe lëmi për të cilën themelohet, detyrat e trupit punues, numri i anëtarëve të trupit punues, afati për kryerjen e detyrave, të drejtave dhe detyrave të Kryetarit dhe anëtarëve të trupave punues dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e trupit punues.

Neni 44 a.

Zgjedhja, të drejtat dhe detyrimet e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit komunal zgjedhor për realizimin e zgjedhjeve për këshilltar të kuvendit të komunës vendoset me rregulloren e punës të kuvendit të komunës.

Ndëgjimi publik

Neni 45.

Trupi punues mund të organizon ndëgjimin publik për propozim vendimet dhe dispozitat tjera për të cilat vendosë Kuvendi i Komunës.

Organizimi dhe zbatimi i ndëgjimit publik, si dhe njoftimi i kryetarit të Kuvendit të komunës dhe opinionit për mendimet dhe qëndrimet e paraqitura në ndëgjimin publik më për së afërmi rregullohen me Rregulloren e Kuvendit të komunës.

Trupat e veçanta punuese të Kuvendit të komunës

Neni 46.

Pranë trupave të përhershëm punues të parapara me Rregulloren e Kuvendit të komunës, Kuvendi i komunës themelon si trupa të përhershëm punues: Pleqësin për përcjelljen e zbatimit të Kodit etik, Pleqësin për të rinjë, Pleqësin shfrytëzuese të shërbimeve publike dhe Komisionin për barazi gjinore.

Kuvendi i komunës themelon, si trupa të përhershëm punues, organet për zbatimin e

zgjedhjeve për anëtar të Pleqësive të Bashkësive lokale: Komisioni zgjedhor për zbatimin e zgjedhjeve për anëtar të Pleqësive të Bashkësive lokale (në tekstin vijues: Komisioni zgjedhor) dhe Komisionin e shkallës së dytë zgjedhore.

Kushtet për punë të trupave të veçanta punuese nga al.1 dhe 2 të këtij neni si dhe kryerja e punëve profesionale dhe adminstrativo –teknike i siguron Administrata komunale.

Pleqësia për përcjelljen e zbatimit të Kodit etik

Neni 47.

Pleqësia për përcjelljen e zbatimit të Kodit etik:

- 7) përcjell se funksionerët a i përmbahen dispozitave të Kodit etik;
- 8) grumbullon informacione që mbështeten në sjelljen e funksionerëve lidhur me Kodin etik;
- 9) përcjell dhe analizon ngjarjet dhe dukurit me rëndësi për zbatimin e suksesshëm të Kodit etik;
- 10) promovon zbatimin e Kodit etik në Komunë dhe më gjërë;
- 11) propozon dhe në mënyrë të pamvarur kryen veprime që çon në avansimin e zbatimit të Kodit etik;
- 12) ofron këshilla dhe mendime funksionerëve, qytetarëve, mjeteve të informimit publik, orgneve dhe organizatave lidhur me zbatimin e Kodit etik;
- 8) realizon bashkëpunimin me Institucione që merren me veprimtarin gjinore;
- 9) kryen edhe punë të tjera të caktuara me këtë Statut dhe me dispozita tjera.

Anëtarët e Pleqësisë nuk mund të jenë persona të zgjedhur, të caktuar dhe të emëruar në Komunë.

Numri i anëtarëve, mënyra e punës dhe autorizimet e Pleqësisë rregullohen me aktin e Kuvendit të komunës.

Pleqësia për të rinjë

Neni 48.

Pleqësia për të rinjë:

- 10) inicon dhe merr pjesë në hartimin e politikës lokale të rinisë në lëmin e arsimit, sportit, shfrytëzimit të kohës së lirë, rritjen e punësimit, informimit,

pjesëmarrjes aktive sigurimin e shansave të barabarta, shëndetësisë, kulturës, barazisë gjinore, pengimin e dhunës dhe kriminalitetit, trajtimin e të drejtave, përmbajtjes së zhvillimit dhe mjedisit jetësor dhe lëmit tjera me rëndësi për të rinjtë;

- 11) merr pjesë na hartimin e planeve të veçanta lokale akcionale, programit dhe politikës në pëlqim me Strategjinë nacionale për të rinjë dhe përcjell realizimin e tyre;
- 12) jep mendim mbi çështjet me rëndësi për të rinjtë dhe për ate njohton orgnet e Komunës;
- 13) jep mendim në projekt dispozitat dhe vendimet të cilat i miraton Kuvendi i komunës në lëmit me rëndësi për të rinjë;
- 14) miraton raportin vjetor dhe periodik mbi realizimin e politikës lokale të rinisë dhe planet lokale akcionale dhe programet për të rinjtë dhe ia paraqet Kuvendit të komunës, kryetarit të Komunës dhe Këshillit komunal ;
- 15) inicon përgaditjen e projekteve ose pjesëmarrjen e Komunës në progrmet dhe projektet për të rinjtë me qëllim të avansimit të pozitës së të rinjëve dhe sigurimit të realizimit të të drejtave të tyre që janë në kompetencë të Komunës;
- 16) nxitë bashkëpunimin në mes të Komunës dhe organizatave të rinisë dhe shoqatave dhe jep përkrahjen në realizimin e aktiviteteve të tyre;
- 17) nxitë realizimin e bashkëpunimit ndërkomunal e cila mbështetet në rininë dhe për ate i njohton organet e Komunës ;
- 18) jep menimin mbi propozim projektet me rëndësi për të rinjë të cilat pjesërisht ose në tërësi finansohen nga buxheti i komunës, përcjell realizimin e tyre dhe jep mendimin e vetë organit kompetent të Komunës.

Përbërja dhe mandati i Pleqësisë për të rinjë

Neni 49.

Pleqësia për të rinjë ka 7 anëtarë.

Kryetari dhe anëtarët e Pleqësisë për të rinjë zgjedhen për periudhën prej 4 vitesh, por pas skadimit të mandatit munden përsëri të zgjedhen.

Zgjedhja e anëtarëve të Pleqësisë për të rinjë **Neni 50.**

Kryetarin dhe anëtarët e Pleqësisë për të rinjë i zgjedh Kuvendi i komunës në propozim të kryetarit të Komunës, kryetarit të Kuvendit të komunës, grupeve të këshilltarëve, Bashkësive lokale, Shoqatave të qytetarëve, Organizatave dhe shoqatave të rinisë, shkollave dhe shërbimeve tjera publike.

Kuvendi i komunës zgjedh anëtarët e Pleqësisë për të rinjë nga përbërja e qytetarëve, profesionistëve, përfaqësuesve të shoqatave, përfaqësuesve të shkollave dhe shërbimeve publike, duke patur kujdes për barazinë gjinore dhe prezencën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare në mjediset e përziera nacionale.

Më së paku gjysmën e antarëve të Pleqësisë për të rinjë e përbëjnë të rinjtë e moshës prej 15 deri 30 vite, të cilët me aktivitetet dhe veprimet e rëndësishme kanë afirmuar rolin pozitiv dhe rëndësin e të rinjëve në Bashkësinë lokale, gjegjësisht të cilët janë fituesit e shpërblimeve shkollore, të fakultetit, shkencore gjegjësisht shpërblimeve tjera me rëndësi për lëmi të ndryshme të interesimit të të rinjëve.

Antarët tjerë të Pleqësisë për të rinjë i zgjedh Kuvendi i komunës me kusht që të posedojnë përvojë shumëvjeçare në punën me problemet e të rinjëve, të paraqitur profesionalizmin gjegjësisht se në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në numrin më të madh të aktiviteteve me rëndësi për të rinjtë.

Pleqësia shfrytëzuese e shërbimeve publike **Neni 51.**

Kuvendi i komunës formon Pleqësin shfrytëzuese të shërbimeve publike si trup të përhershëm punues i përbërë nga 5 anëtarë.

Pleqësia shfrytëzuese e shërbimeve publike shqyrton Planet, Programet dhe Raportet e shërbimeve publike dhe për qëndrimin e vetë njohton Kuvendin e komunës dhe opinionin.

Pleqësia shfrytëzuese e shërbimit publik kryesisht shqyrton nivelin e realizuar të kualitetit dhe vëllimin e shërbimit të shërbimeve publike, si dhe çmimet e prodhimeve dhe shërbimeve komunale, gjegjësisht lartësin e kompenzimit për shërbimin e shërbimeve publike.

Antarët e Pleqësisë shfrytëzuese i zgjedh Kuvendi i komunës në propozim të trupit punues të Kuvendit të komunës , grupeve të këshilltarëve dhe shoqatave të qytetarëve.

Kryetari dhe më së paku gjysma e anëtarëve të Pleqësisë shfrytëzuese nuk mund të jenë nga përbërja e këshilltarëve, funksionerëve dhe të punësuarve në komunë, gjegjësisht në shërbimet komunale themelues i të cilëve është Komuna.

Me ndërprerjen e mandatit të Kuvendit të komunës i pushon mandati anëtarve të Pleqësisë shfrytëzuese.

Komisioni për barazi gjinore Neni 52.

Komisioni për barazi gjinore shqyrton propozim vendimet dhe aktet tjera të përgjithshme të cilat i miraton Kuvendi i Komunës, përcjell realizimin e barazisë gjinore, propozon aktivitete dhe ndërmerr masa, veçmas të atyre të cilave i realizohet politika e mundësive të barabarta në nivelin e Komunës.

Në punën e Komisionit për barazi gjinore mund, sipas ftesës, të marrin pjesë edhe personat tjerë pa të drejtë vendosjeje.

Me aktin e formimit të Komisionit caktohet numri dhe përbërja e antarëve të Komisionit, mandati, detyra, mënyra e punës së Komisionit dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Komisionit.

Komisioni zgjedhor Neni 53.

Komisionin zgjedhor e përbëjnë kryetari dhe 6 antarë të cilët i emëron Kuvendi i komunës.

Komisioni zgjedhor ka sekretarin të cilin e emëron Kuvendi i komunës dhe i cili merr pjesë në punën e Komisionit zgjedhor pa të drejtë vendosjeje.

Kryetari, antarët e Komisionit zgjedhor dhe sekretari emërohen për 4 vite, pas skadimit të mandatit mund të jenë përsëri të emëruar.

Kryetari, anëtarët e Komisionit zgjedhor dhe sekretari i tij kanë zëvendësit.

Për kryetar, zëvendës kryetar, sekretar dhe zëvendës sekretar të Komisionit zgjedhor emërohen personat që kanë arsimim superior nga lëmi shkencor, shkencat juridike në studimet bazë akademike në vëllim prej më së paku 240 ESPB pikë, master i studimeve

akademike, master i studimeve profesionale, specialist i studimeve akademike, specialist i studimeve profesionale, gjegjësisht në studimet bazë në kohë zgjatje prej më së paku katër vitesh ose studime specialistike në fakultet, me më së paku tri vite përvojë pune në profesion.

Komisioni zgjedhor zbaton zgjedhjet për anëtar të Pleqësive të Bashkësive lokale kryesisht në përbërje të përhershme.

Antarët e Komisionit zgjedhor dhe zëvendësit e tyre mund të jenë vetëm qytetarë që kanë të drejtë vote si dhe vendqëndrim në territorin e Komunës Preshevë.

Detyrat dhe autorizimet e Komisionit zgjedhor Neni 54.

Komisioni zgjedhor me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve për Pleqësit e Bashkësive lokale:

1) kujdeset për ligjshmërinë e zhvillimit të zgjedhjeve për antarët e Pleqësisë së Bashkësisë lokale;

2) cakton vendvotimet;

3) cakton këshilltat zgjedhore dhe emëron antarët e tyre;

4) jep udhëzime këshillave zgjedhore në vështrim të zbatimit të procedurës së zgjedhjes për antarët e Pleqësisë së Bashkësisë lokale ;

5) parasheh formularët dhe organizon përgaditjet teknike për mbajtjen e zgjedhjeve;

6) vërteton se listat zgjedhore a janë të përpiluara dhe të dorëzuara në pajtim me udhëzimin për zbatimin e zgjedhjeve për anëtar të Pleqësisë së Bashkësisë lokale ;

7) shpallë listën e kandidatëve;

8) cakton formën dhe pamjen e fletëvotimeve, numrin e fletëvotimeve për vendvotime dhe me procesverbal ia dorëzon Këshillit të votimit;

9) vendos për ankesat e paraqitura në procedurën e zgjedhjes për anëtarët e Pleqësisë së Bashkësisë lokale;

10) vërteton dhe shpall rezultatet e zgjedhjeve për antarë të Pleqësisë së Bashkësisë lokale;

11) i paraqet raport Kuvendit të komunës mbi mbajtjen e zgjedhjeve për antarë të Pleqësisë së Bashkësisë lokale.

Detyrat dhe autorizimet e Komisionit zgjedhor, si dhe mënyra e punës dhe vendosjes më për së afërmi përcaktohen me Vendimin e

Kuvendit të komunës me të cilën rregullohen Bashkësitë lokale.

Komisioni zgjedhor i shkallës së dytë Neni 55.

Komisioni zgjedhor i shkallës së dytë është organ për mbajtjen e zgjedhjeve i cili në shkallën e dytë vendos për ankesat në vendimet e Komisionit zgjedhor.

Komisionin zgjedhor të shkallës së dytë e përbëjnë kryetari dhe katër antarët.

Komisioni zgjedhor i shkallës së dytë ka sekretarin të cilin e emëron Kuvendi i Komunës i cili merr pjesë në punën e Komisionit zgjedhor pa të drejtë vendosjeje.

Komisioni zgjedhor i shkallës së dytë vendos me shumicë votash nga numri i tërësishëm i antarëve.

Kryetari, më së paku një anëtar dhe sekretari i Komisionit zgjedhor i shkallës së dytë duhet të kenë të kryer arsimimin superior nga lëmi i shkencës, shkencave juridike në studimet bazë akademike në vëllim prej më së paku 240 ESPB pikë, studimet akademike master, studimet master profesionale, studimet akademike specialistike, studimet profesionale specialistike gjegjësisht në studimet bazë në kohëzgjatje prej më së paku katër vite ose studime specialistike në fakultet, me më së paku pesë vite përvojë pune në profesion.

Kryetari, antarët e Komisionit zgjedhor të shkallës së dytë dhe sekretari, emërohen për katër vite dhe munden prapë të emërohen.

Detyrat dhe autorizimet e Komisionit zgjedhor të shkallës së dytë, si dhe mënyra e punës dhe vendosjes më për së afërmi caktohen me Vendimin e Kuvendit të komunës me të cilën rregullohen Bashkësitë lokale.

Kryetari i Kuvendit Neni 56.

Kuvendi i komunës ka kryetarin e Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit organizon punën e Kuvendit të komunës, konvokon dhe kryeson seancat e Kuvendit, realizon bashkëpunimin me kryetarin e komunës dhe Këshillit komunal, përkujdeset mbi realizimin e punës së Kuvendit të komunës, nënshkruan aktet të cilat Kuvendi i komunës i miraton dhe kryen

punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut.

Kryetari i Kuvendit mund të jetë në punë të përhershme në Komunë.

Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit Neni 57.

Kryetari i Kuvendit zgjedhet nga rradha e Këshilltarëve, në propozim të më së paku 1/3 së këshilltarëve, për kohë prej katër vitesh, me vota të mshefta, me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve të Kuvendit të komunës.

Këshilltari mund të merr pjesë në propozimin e vetëm një kandidati.

Nëse janë propozuar më shumë kandidat, ndërsa asnjë nga kandidatët e propozuar nuk fiton shumicën e votave të duhura përsëritet procedura e kandidimit dhe zgjedhjes.

Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit Neni 58.

Kryetari i Kuvendit mund të shkarkohet para skadimit të mandatit:

- 3) në kërkesë personale,
- 4) në propozim të më së paku 1/3 e këshilltarëve.

Propozimi paraqitet me shkrim dhe duhet të jetë i arsyetuar.

Shkarkimi bëhet në mënyrë dhe procedurë që është paraparë për zgjedhjen e tij.

Zëvendës kryetari i Kuvendit Neni 59.

Kryetari i Kuvendit ka zëvendësin i cili e zëvendëson në rast të mungesës dhe pengesës për të kryer detyrën e vetë.

Zëvendës kryetari i Kuvendit zgjedhet dhe shkarkohet në mënyrën e njejtë si kryetari i Kuvendit.

Nëse zëvendës kryetarit të Kuvendit i pushojnë të drejtat nga marrëdhënia e punës për arsye të zgjedhjeve në këtë funksion, zëvendës kryetari i Kuvendit mund të jetë në punë të përhershme në Komunë.

Sekretari i Kuvendit Neni 60.

Kuvendi i komunës ka sekretarin i cili përkujdeset për kryerjen e punëve profesionale lidhur me konvokimin dhe mbajtjen e seancave të Kuvendit dhe trupave të tij punues

dhe udhëheq punët adminisitrative lidhur me punën e tyre.

Sekretari i Kuvendit emërohet për katër vite në propozim të kryetarit të Kuvendit dhe mund të emërohet përsëri.

Për sekretar të Kuvendit të komunës mund të emërohet personi i cili ka të kryer arsimin superior nga lëmi shkencor i shkencave juridike në studimet bazë akademike në vëllimin prej më së paku 240 ESPB pikë, studimet akademike master, studimet akademike specialistike, studimet profesionale specialistike, gjegjësisht në studimet bazë në kohëzgjatje prej më së paku katër vite ose studimet specialistike në fakultet, me provimin e dhënë profesioanl për punë në organet e Administratës dhe përvojë pune më së paku tri vite.

Kuvendi i komunës mund në propozim të arsyetuar të kryetarit të Kuvendit shkarkon sekretarin edhe para skadimit të mandatit.

Sekretari ka zëvendësin i cili e zëvendëson në rast të mungesës së tij.

Zëvendës sekretari i Kuvendit të komunës emërohet dhe shkarkohet në mënyrë të njëjtë dhe nën kushtet e njëjta si sekretari.

Sekretari i Kuvendit është përgjegjës për dërgimin e shënimeve me kohë, të lëndëve dhe dokumenteve, kur ate e kërkon organi kompetent republikan i cili kryen mbikqyrjen ndaj punës dhe akteve të Kuvendit të komunës.

Rregullorja e Kuvendit

Neni 61.

Mënyra e përgaditjes, udhëheqja dhe puna e seancës së Kuvendit të komunës dhe trupave të tij punues dhe çështjet tjera lidhur me punën e tij rregullohen me Rregulloren e Kuvendit.

Rregulloren e miraton Kuvendi i komunës me shumicën nga numri i tërsishëm i këshilltarëve.

4. Organet ekzekutive të Komunës

Organet ekzekutive

Neni 62.

Organet ekzekutive të Komunës janë kryetari i Komunës dhe Këshilli komunal.

a) Kryetari i Komunës

Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendës kryetarit të komunës

Neni 63.

Kryetarin e komunës e zgjedh Kuvendi i komunës, nga rradha e këshilltarëve, në kohë prej katër vitesh, me vota të mshefta, me shumicë votash nga numri i tërsishëm i këshilltarëve të Kuvendit të komunës.

Kryetari i komunës ka zëvendësin i cili e zëvendëson në rast të mungesës dhe pengesës së tij që të kryej detyrën e vetë.

Kryetari i Kuvendit të komunës propozon kandidatin për kryetar të Komunës.

Kandidati për kryetar të Komunës propozon kandidatin për zëvendës kryetar të Komunës nga rradha e këshilltarëve të cilin e zgjedh Kuvendi i komunës në mënyrë të njëjtë si kryetarin e Komunës.

Papajtushmëria e funksioneve

Neni 64.

Kryetarit të komunës dhe zëvendës kryetarit të Komunës me zgjedhjen në këto funksione i pushon mandati i këshilltarit në Kuvendin e komunës.

Kryetari i komunës dhe zëvendës kryetari i Komunës janë me punë të përhershme në Komunë.

Kompetencat

Neni 65.

Kryetari i Komunës:

- 28) Paraqet dhe përfaqëson Komunën;
- 29) Propozon mësnyrën e zgjidhjes së çështjeve për të cilat vendos Kuvendi i komunës;
- 30) Është urdhërdhënës për kryerjen e buxhetit ;
- 31) Formon shërbimin komunal për inspektim të shfrytëzimit të mjeteve të buxhetit dhe shërbimin për revizionin intern të komunës;
- 32) Themelon fondin e buxhetit dhe përcakton programin e shfrytëzimit të mjeteve të fondit buxhetor në pajtim me Ligjin;
- 33) Jep pëlqimin në aktet e përgjithshme me të cilat rregullohet numri dhe struktura e të punësuarve në institucione të cilat finansohen nga buxheti i Komunës dhe në numrin dhe strukturën e të punësuarve dhe personave të tjerë të cilët angazhohen në realizimin e programeve ose pjesëve të programeve të

- shfrytëzuesve të buxhetit të komunës ;
- 34) Drejton dhe koordinon punën e Administratës komunale ;
- 35) Paraqet Këshillin komunal, thirr dhe udhëheq mbledhjet e tij;
- 36) Nxjerr aktet e veçanta për të cilat është i autorizuar me Ligj, me këtë Statut ose me Vendim të Kuvendit të komunës;
- 37) Nxjerr aktvendime mbi dhënjën në qera të tokës ndërtimore në pronë publike të komunës në pajtim me Ligjin, dispozitat dhe programet tjera të shfrytëzimit të tokës ndërtimore;
- 38) Vendos mbi dhënjën me qera, gjegjësisht në shfrytëzim të së patundshmes në pronë publike të komunës, në pajtim me Ligjin dhe dispozitat e Komunës;
- 39) Vendos mbi grumbullimin dhe disponimin me gjërat e tundshme në pronë publike të Komunës;
- 40) Jep pëlqimin e mëparshëm bartësve të të drejtave të shfrytëzimit në gjërat në pronë publike të Komunës (Bashkësive lokale, Institucioneve dhe Organizatave tjera për dhënjem me qera të atyre gjërave;
- 41) Bënë rradhitjen e ndërtesave zyrtare dhe hapsirave afariste në pronë publike të komunës;
- 42) Nënshkrun kontrata në emër të komunës në bazë të autorizimit nga Ligji, Statuti dhe Vendimi i Kuvendit të komunës;
- 43) Në emër të komunës nënshkruan kontratat kolektive për organe dhe për ndërmarrje, institucione dhe shërbime tjera publike, themelues i të cilëve është;
- 44) Vendos mbi organizimin dhe zbatimin e punëve publike;
- 45) Nënshkruan kontrata mbi donacione nga personat fizik ose juridik;
- 46) Është komandant i shtabit komunal për situata të jashtëzakonshme sipas pozitës, bjen Vendimin mbi shpalljen dhe ndërprerjen e situatës së jashtëzakonshme në propozim të shtabit komunal për situata të jashtëzakonshme;
- 47) Bjen Vendimi mbi shpalljen e ditë zie në Komunë ;

- 48) Miraton raporte mbi kryerjen e buxhetit të komunës dhe ia dërgon Kuvendit të komunës;
- 49) Informon opinionin për punën e vetë;
- 50) I paraqet ankesë Gjykatës kushtetuese të Republikës së Serbisë nëse me ndonjë akt të veçantë ose me punën e organit shtetëror ose organit të komunës i pamundësohet kryerja e kompetencës së komunës ;
- 51) Formon trupin punues profesional këshilldhënës për punë të veçanta nga kompetenca e vetë ;
- 52) Emëron dhe shkarkon ndihmësit e kryetarit të Komunës ;
- 53) Nxjerr akte nga kompetenca e Kuvendit të komunës në rast gjendje lufte ose fatkeqësive elementare, ashtu që është i obliguar që ti paraqet në vërtetimin Kuvendit atëherë që kur ajo ka mundësi që të mbajë mbledhje;
- 54) Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me këtë Statut dhe akte tjera të Komunës.

Kryetari i komunës është përgjegjës për dërgimin e shënimeve me kohë, të lëndëve dhe dokumenteve, kur ate e kërkon organi kompetent i Republikës i cili bënë mbikqyrjen ndaj punës dhe akteve të organeve ekzekutive të Komunës.

Ndihmësit e kryetarit të Komunës Neni 66.

Kryetari i komunës mund të ketë 2 ndihmës të cilët kryejnë punët nga lëmit e veçanta (zhvillimi ekonomik, urbanizëm, mbrojtja primare shëndetsore, mbrojtja e mjedisit jetësor, turizëm, bujqësi, veprimtari komunale, zhvillimin e Bashkësive lokale etj.).

Ndihmësit e kryetarit të komunës inicojnë iniciativa, propozojnë projekte dhe japin mendime lidhujr me çështjet që janë me rëndësi për zhvillimin e komunës në lëmit për të cilat janë të emëruar dhe kryejnë punë të tjera sipas urdhërit të kryetarit të Komunës.

Kryetari i komunës emëron dhe shkarkon ndihmësit, të cilët kryejnë punët jo më gjatë se sa zgjatë detyra e kryetarit të Komunës.

Ndihmësit e kryetarit të komunës emërohen në kabinetin e kryetarit të Komunës.

b) Këshilli komunal

Përbërja dhe zgjedhja

Neni 67.

Këshillin komunal e përbëjnë kryetari i Komunës, zëvendës kryetari i Komunës si dhe 7 anëtarët e Këshillit komunal.

Kryetari i komunës është kryetar i Këshillit komunal.

Zëvendës kryetari i komunës është anëtar i Këshillit komunal sipas funksionit.

Antarët e Këshillit komunal i zgjedh Kuvendi i komunës, në periudhë prej katër vitesh, me vota të mshefta, me shumicë nga numri i tërsishëm i këshilltarëve.

Kandidatët për anëtar të Këshillit komunal i propozon kandidati për kryetar të Komunës.

Kur vendos mbi zgjedhjen e kryetarit të Komunës, Kuvendi i komunës njëkohësisht dhe së bashku vendos mbi zgjedhjen e zëvendës kryetarit të Komunës dhe antarëve të Këshillit komunal.

Antarët e Këshillit komunal munden të jenë me punë të përhershme në Komunë.

Mospërputhja e funksioneve

Neni 68.

Anëtarët e Këshillit komunal nuk mund që të jenë edhe këshilltar, ndërsa mund të caktohen me detyra për një apo më shumë fusha të caktuara nga kompetenca e Komunës.

Këshilltari i cili zgjedhet për anëtar të Këshillit komunal i ndërpritet mandati i këshilltarit.

Kompetenca

Neni 69.

Këshilli komunal:

- 15) Propozon Statutin, buxhetin dhe vendimet tjera dhe aktet të cilat i nxjerr Kuvendi;
- 16) Drejt për drejtë ekzekuton dhe kujdeset për ekzekutimin e Vendimeve dhe akteve tjera të Kuvendit të komunës;
- 17) Nxjerr Vendimin mbi finansimin e përkohshëm në rastin kur Kuvendi i komunës nuk bjen buxhet para fillimit të vitit fiskal;
- 18) Themelon shërbimin komunal për inspektimin e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore dhe shërbimin për revizionin intern të komunës;
- 19) Bënë mbikqyrjen ndaj punës së Administratës komunale, anulon ose

ndërpren aktet e Administratës komunale të cilat nuk janë në pajtim me Ligjin, Statutin dhe me aktet tjera të përgjithshme ose me Vendimin të cilin e nxjerr Kuvendi i komunës;

- 20) Zgjidh në procedurën administrative dhe shkallën e dytë për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve Ndërmarrjeve dhe Institucioneve dhe Organizatave tjera në lëndët administrative nga kompetenca e Komunës;
- 21) Parasheh elemnentet e veçanta të vlerësimit të rrezikut dhe pjesëmarrjes së mbikqyrjes së inspektimit në bazë të vlerësimit të rrezikut nga kompetenca burimore e komunës si dhe elementet e veçanta të planit të mbikqyrjes së caktuar të inspekcionit nga kompetenca burimore e komunës;
- 22) Përcjell realizimin e programit të punës dhe kryen koordinimin e punës të ndërmarrjeve publike themelues i të cilëve është;
- 23) Paraqet raportin tremujor mbi punën e ndërmarrjeve publike të Kuvendit të komunës, për arsye të raportimit të mëtejme në pajtim me Ligjin me të cilin rregullohet pozita juridike e ndërmarrjeve publike ;
- 24) Propozon aktet të cilat i miraton Kuvendi i komunës për arsye të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm në ndërmarrjen publike dhe shoqërin kapitale themelues i të cilit është Komuna ;
- 25) Vendos me Aktvendim mbi përdorimin e mjeteve të rezervave vijuese dhe të përhershme buxhetore;
- 26) Kujdeset për kryerjen e kompetencave të besuara nga korniza e të drejtave dhe detyrave të Republikës ;
- 27) Emëron dhe shkarkon kryeshefin e Adminsitratës komunale;
- 28) Emëron Avokatin komunal;
- 15) nxjerr Planin e mbrojtjes të komunës që është pjesë përbërse e Planit të mbrojtjes së Republikës së Serbisë, harmonizon përgaditjet për mbrojtjen e personave juridik në veprimtarit nga kompetenca e komunës me Planin e mbrojtjes së Republikës së Serbisë, nxjerr vendimin mbi organizimin dhe funksionimin e mbrojtjes civile dhe njësit e dedikimit të përgjithshëm;

- 22) Nxjerr Vlerësimin e rrezikshmërisë dhe Planin e mbrojtjes së shpëtimit në situatat e jashtëzakonshme dhe Planin e mbrojtjes nga fatkeqësitë;
- 23) Formon Komisionin ankimues ;
- 24) Formon trupat punues profesional këshilldhënës për punë të veçanta nga kompetenca e vetë;
- 25) Informon opinionin për punën e vetë ;
- 26) Nxjerr Rregulloren mbi punën në propozim të Kryetarit të Komunës ;
- 27) Kryen edhe punë tjera në pajtim me Ligjin.

Vendimet nga pika 3 të këtij neni, Këshilli komunal i miraton me 2/3 e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit komunal.

Pozita e kryetarit të Komunës në Këshillin komunal

Neni 70.

Kryetari i Komunës paraqet Këshillin komunal thirrë dhe udhëheq mbledhjet e tij.

Kryetari i komunës është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Këshillit komunal.

Kryetari i Komunës është i obliguar të ndalon aplikimin e Vendimit të Këshillit komunal për të cilën mendon se nuk është në pajtim me Ligjin.

Kuorum për punë dhe vendosje

Neni 71.

Këshilli komunal mund të vendosë nëse në mbledhje merr pjesë shumica nga numri i tërësishëm i antarëve të vetë.

Këshilli komunal vendos me shumicë votash të antarëve prezent nëse me Ligj ose me Statut për çështje të veçanta nuk është paraparë shumica tjetër.

Rregullorja e Këshillit komunal

Neni 72.

Organizimi, mënyra e punës dhe vendosja e Këshillit komunal, në mënyrë më detale rregullohet me Rregulloren e vetë, në pajtim me Ligjin dhe këtë Statut.

Pleqësia e ekonomisë

Neni 73.

Këshilli komunal formon Pleqësin ekonomike.

Pleqësia ekonomike jep iniciativa, sygjërimë dhe mendime lidhur me zhvillimin ekonomik, shqyrton strategjitë, planet,

programet dhe vendimet me rëndësi për ekonomi dhe përcjell zbatimin e tyre.

Detyrat, mënyra e punës dhe vendosja e Pleqësisë ekonomike më për së afërmi rregullohet me Rregulloren e Këshillit komunal.

Përbërja e Pleqësisë ekonomike

Neni 74.

Kryetari dhe katër anëtarët e Pleqësisë ekonomike i emëron Këshilli komunal në kohëzgjatje të mandatit të Këshillit komunal.

Antarët e Pleqësisë ekonomike mund ti propozojnë shoqatat e qytetarëve, bashkësitë lokale, shoqatat ekonomike dhe ndërmarrësit.

Kryetari dhe më së paku gjysma e antarëve të Pleqësisë ekonomike emërohen nga përbërja e biznesmenëve dhe ndërmarrësve, gjegjësisht shoqatat e tyre.

Paraqitja e raportit Kuvendit të komunës

Neni 75.

Kryetari i Komunës dhe Këshilli komunal janë të obliguar që me kohë të raportojnë Kuvendin e komunës, sipas iniciativës së vetë ose në kërkesë të tyre, e më së paku një herë në vit, mbi kryerjen e vendimeve dhe akteve tjera të Kuvendit të komunës.

Këshilli komunal është i obliguar që Kuvendit të komunës t’ia paraqet raportin tre mujorë mbi punën.

Shkarkimi dhe dorëheqja e kryetarit të Komunës

Neni 76.

Kryetari i komunës mund të jetë i shkarkuar para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhë, në propozimin e arsyetuar të më së paku 1/3 së këshilltarëve, në të njëjtën mënyrë në të cilën është emëruar.

Mbi propozimin për shkarkimin e kryetarit të komunës duhet të diskutohet dhe vendoset në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgesës së propozimit kryetarit të Kuvendit të komunës, me zbatimin e afatit minimal për konvokimin e seancës nga neni 42 al.3 dhe 5 të këtij Statuti.

Nëse Kuvendi nuk e shkarkon kryetarin e Komunës këshilltarët të cilët kanë paraqitur propozim për shkarkim nuk munden përsëri të propozojnë shkarkimin e kryetarit të Komunës para skadimit të afatit prej gjashtë

muajsh nga refuzimi i propozimit të mëparshëm.

Kryetari i komunës mund të paraqet dorëheqje.

Mbi dorëheqjen e paraqitur të kryetari të Komunës, kryetari i Kuvendit të komunës njofton këshilltarët në fillim të seancës së parë të rradhës të Kuvendit.

Veprimi i shkarkimit dhe dorëheqja e kryetarit të Komunës

Neni 77.

Me shkarkimin, gjegjësisht dorëheqjen e kryetarit të Komunës i pushon mandati zëvendës kryetarit të komunës dhe Këshillit komunal.

Shkarkimi dhe dorëheqja e zëvendës kryetarit të Komunës gjegjësisht anëtarit të Këshillit komunal

Neni 78.

Zëvendës kryetari i Komunës, gjegjësisht anëtari i Këshillit komunal mund të jetë i shkarkuar para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur, në propozim të kryetarit të komunës ose më së paku 1/3 e këshilltarëve në mënyrë të njëjtë në të cilin është zgjedhë.

Kryetari i komunës është i obliguar që njëkohësisht me propozimin për shkarkimin e zëvendës kryetarit e komunës ose antarit të Këshillit komunal, Kuvendit të komunës ti dërogn propozimin për zgjedhjen e zëvendësit të ri të kryetarit të ri të komunës ose anëtarit të Këshillit komunal i cili njëkohësisht miraton vendimin mbi shkarkimin dhe mbi zgjedhjen.

Në rast që Kuvendi i komunës shkarkon zëvendës kryetarit e Komunës ose anëtarin e Këshillit komunal në propozim të 1/3 së këshilltarëve, kryetari i Komunës është i obliguar që në seancën e parë të rradhës të Kuvendit të komunës paraqet propozimin për zgjedhjen e zëvendësit të ri të kryetarit të Komunës gjegjësisht anëtarit të Këshillit komunal.

Mbi paraqitjen e dorëheqjes së zëvendës kryetarit të komunës ose anëtarit të Këshillit komunal, kryetari i Kuvendit të komunës njohton këshilltarët në fillim të seancës së parë të rradhës të Kuvendit të komunës.

Në rastin nga al.4 të këtij neni kryetari i komunës është i obliguar që në seancën e rradhës të Kuvendit të komunës paraqet propozimin për zgjedhjen e zëvendësit të ri të

kryetarit të Komunës gjegjësisht anëtarit të Këshillit komunal.

Kryerja e punëve vijuese pas ndërprerjes së mandatit për arsye të shkarkimit ose dorëheqjes

Neni 79.

Kryetari i komunës, zëvendës kryetari i Komunës ose anëtari i Këshillit komunal të cilët janë shkarkuar ose kanë paraqitë dorëheqje, mbeten në detyrë dhe kryen punët vijuese, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Komunës, zëvendës kryetarit e komunës, ose anëtarin e Këshillit komunal.

Ndërprerja e mandatit të organeve ekzekutive të Komunës për arsye të mandatit të Kuvendit

Neni 80.

Me ndërprerjen e mandatit të Kuvendit të komunës i ndërprehet mandati kryetarit të Komunës dhe Këshillit komunal, ashtu që ata kryejnë punët vijuese nga kompetenca e vetë deri në fillimin e detyrës së kryetarit të ri të Komunës dhe Këshillit komunal gjegjësisht kryetarit dhe anëtarëve të Organit të përkohshëm, nëse Kuvendit i është ndërpre mandati për arsye të shpartallimit të Kuvendit.

5. Administrata komunale

Administrata komunale

Neni 81.

Punë administrative në kuadër të të drejtave dhe detyrave të komunës dhe punët e caktuara profesionale dhe administrativo teknike për nevojat e Kuvendit të komunës, kryetarit të komunës dhe Këshillit komunal i kryen Administrata komunale.

Kompetenca

Neni 82.

Administrata komunale:

- 10) Përgaditë dispozitat dhe aktet tjera të cilat i nxjerr Kuvendi i komunës, kryetari i komunës dhe Këshilli komunal;
- 11) Kryen vendimet dhe aktet tjera të Kuvendit të komunës, kryetarit të komunës dhe Këshillit komunal;
- 12) Vendorsë në procedurën administrative në shkallën e parë për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera

- në lëndët administrative nga kompetenca e Komunës;
- 13) Kryen punët e mbikqyrjes adminisitrative ndaj kryerjes së dispozitave dhe akteve tjera të përgjithshme të Kuvendit të komunës ;
 - 14) Zbaton Ligjet dhe dispozitat tjera kryerja e të cilëve iu është besuar Komunës;
 - 15) Udhëheq evidencat e parapara me Ligj dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tyre;
 - 16) Kryen punët profesionale dhe administrativo teknike për nevojat e punës së Kuvendit të komunës, kryetarit të Komunës dhe Këshillit komunal;
 - 17) I ofron ndihmë Bashkësisë lokale në kryerjen e punëve adminstrativo teknike dhe punëve finansiario-materiale;
 - 18) Dërgon raportin mbi punën në kryerjen e punëve nga kompetenca e komunës dhe punëve të besuara, kryetarit të komunës, Këshillit komunal dhe Kuvendit të komunës, sipas nevojës, e më së paku një herë në vit.

Parimet e veprimit të Administratës komunale

Neni 83.

Administrata komunale vepron sipas rregullave të degës, në mënyrë të paanshme dhe politikisht neutrale dhe është i obliguar që çdo kujt ti mundëson mbrojtjen e njëjtë juridike në realizimin e të drejtave, obligimeve dhe interesave juridike.

Administrata komunale është e obliguar që qytetarëve ti mundësoj realizimin e shpejtë dhe efektive të të drejtave të tyre dhe interesave juridike.

Administrata komunale është e obliguar që qytetarëve ti ofron shënimet e duhura dhe njoftimet dhe ti ofron ndihmë juridike.

Administrata komunale është e obliguar të bashëpunon me qytetarët dhe të rrespekton personalitetin dhe dinjitetin e qytetarëve.

Kur organet e komunës vendosin mbi të drejtat, obligimet ose interesat juridike të personit fizik ose juridik gjegjësisht palës tjetër, Administrata komunale sipas detyrës zyrtare bënë mbikqyrjen, grumbullon dhe përpilon shënimet nga evidenca, gjegjësisht

regjistrat të cilat në pajtim me dispozitat e veçanta i udhëheqin orgnet shtetërore, organet e autonomisë territoriale , njësit e vetadministrimit lokal dhe poseduesit e autorizimeve publike, në pajtim me Ligjin.

Çasjen, grumbullimin dhe përpilimin e shënimeve nga evidencat, gjegjësisht regjistrat të cilat udhëhiqen në formë elektronike, në procedurën nga al.5 i këtij neni bëhet me anë të sistemit infromues që siguron sigurin dhe mbrojtjen e shënimeve për personalitetin.

Në procedurën nga al.5 i këtij neni Administrata komunale mund të ketë çasje, grumbullon dhe përpilon vetëm ato shënime të cilat me Ligj ose me dispozita të veçanta janë të përcaktuara si të domosdoshme për kryerjen e të drejtave të caktuara, obligimit ose interesit juridik të palës.

Organizimi i Administratës komunale

Neni 84.

Administrata komunale formohet si organ i vetëm.

Në Administratën komunale formohen njësit e mbrendshme organizative për kryerjen e punëve gjinore adminisitrative, profesionale dhe punëve tjera.

Udhëheqja

Neni 85.

Administratën komunale e udhëheq kryeshefi.

Për kryeshef të Administratës komunale mund të caktohet personi i cili ka të kryer arsimin superior nga lëmi i shkencës, të shkencave juridike në studimet bazë akademike në vëllim prej më së paku 240 ESPB pikë, studimet akademike master, studimet akademike specialistike, studimet profesionale specialistike, gjegjësisht në studimet bazë në kohëzgjatje prej më së paku katër vite ose studimet specialistike në fakultet, më së paku pesë vite përvojë pune në profesion dhe provimin e dhënë profesional shtetëror për punë në organet e Administratës komunale.

Emërimi i kryeshefit dhe zëvendës kryeshefit të Administratës komunale

Neni 86.

Kryeshefin e Administratës komunale e emëron Këshilli komunal, në bazë të shpalljes publike, për pesë vite.

Kryeshefi i Administratës komunale mund të ketë zëvendës, i cili e zëvendëson në

rast të mungesës dhe pengesës së tij për kryerjen e detyrës së vetë.

Zëvendës kryeshefi i Administratës komunale emërohet në mënyrë të njëjtë dhe nën kushte të njëjta si kryeshefi.

Udhëheqësit e njësive organizative në Administratë i rradhitë kryeshefi i Administratës komunale.

Përgjegjësia e kryeshefit

Neni 87.

Kryeshefi për punën e vetë dhe për punën e Administratës komunale i përgjigjet Këshillit komunal.

Rregullimi i Administratës komunale

Neni 88.

Vendimin mbi Administratën komunale e nxjerr Kuvendi i komunës në propozim të Këshillit komunal.

Rregulloren mbi rregullimin dhe sistematizimin e mbrendshëm të Administratës komunale, organeve të veçanta, shërbimeve dhe organizatave i unifikon kryeshefi i Administratës komunale dhe ia dërgon Këshillit komunal për miratim.

Autorizimet dhe kryerja e mbikëqyrjes administrative

Neni 89.

Administrata komunale në kryerjen e mbikëqyrjes administrative mund të:

- 7) Urdhëron me Aktvendim kryerjen e masave dhe lëndëve në afat të caktuar,
- 8) Të shqipton dënim në të holla,
- 9) Ti paraqet fletëparaqitje organit kompetent për shkaktimin e veprës penale ose shkelje ekonomike dhe të paraqet kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse,
- 10) Të jep urdhëres të përkohshme gjegjësisht ndalesë,
- 11) Të njohton organin tjetër nëse ekzistojnë arsyet për ndërmarrjen e masave për të cilat ai organ është kompetent,
- 12) Të ndërmerr masa tjera për të cilat është i autorizuar me Ligj me dispozitë ose me aktin e përgjithshëm.

Autorizimi dhe organizimi për kryerjen e punëve nga al.1 i këtij neni më për së afërmi rregullohen me Vendim të Kuvendit të komunës.

Zbatimi i dispozitave në procedurën administrative

Neni 90.

Ne procedurën pranë Administratës komunale, ku vendoset për të drejtat, obligimet dhe interesat e qytetarëve dhe personave juridik zbatohen dispozitat mbi procedurën administrative.

Konflikt kompetencash

Neni 91.

Këshilli komunal zgjidhë konflikt kompetencash në mes të Administratës komunale dhe ndërmarrjeve tjera, institucioneve dhe organizatave kur në bazë të Vendimit të Kuvendit të komunës vendosin mbi disa të drejta të qytetarëve, personave juridik ose palëve tjerë.

Kryeshefi i Administratës zgjidhë konflikt kompetencash në mes të njësive të mbrendshme organizative.

Kushtet për kryerjen e punëve administrative

Neni 92.

Punët e Administratës komunale të cilat mbështeten në realizimin e të drejtave, obligimeve dhe interesave të qytetarëve dhe personave juridik mund ti kryejnë personat të cilët kanë të paraparë kualifikimin shkollor, provimin e dhënë profesioanl për punë në organet e Administratës shtetërore dhe përvojë pune përkatëse, në pajtim me Ligjin dhe dispozitat tjera.

Përfundimi

Neni 93.

Për përfundimin e kryeshefit të Administratës komunale vendos Këshilli komunal.

Mbi përfundimin e pesonit zyrtar në Administratën komunale vendos kryeshefi.

6. Avokatura komunale

Neni 94.

Punët e mbrojtjes juridike të të drejtave pronësore dhe interesit të komunës i kryen Avokatura komunale.

Formimin, rregullimin dhe organizimin si dhe çështjet tjera me rëndësi për Avokaturën komunale, përcaktohen me

Vendim të Kuvendit të komunës në pajtim me bazat për rregullimin dhe organizimin e Avokaturës të parapara me Ligj.

V. PJESËMARRJA DREJT PËR DREJTË E QYTETARËVE NË REALIZIMIN E VETADMINISTRIMIT LOKAL

Format e pjesëmarrjes së drejt për drejtë të qytetarëve Neni 95.

Qytetarët e komunës drejt për drejtë marrin pjesë në realizimin e punëve të komunës me anë të iniciativës së qytetarëve, tubimit të qytetarëve dhe referendumit.

Iniciativa qytetare Neni 96.

Qytetarët me anë të iniciativës qytetare i propozojnë Kuvendit të komunës miratimin e aktit me të cilin do të rregullohet çështja e caktuar nga kompetenca e komunës, ndryshimi i Statutit ose akteve tjera dhe shpallja e referendumit në pajtim me Ligjin.

Administrata komunale është e obliguar që qytetarëve ti ofron ndihmë profesionale me rastin e formulimit të propozimit të përmbajtur në iniciativën qytetare.

Iniciativa e qytetarëve e plotëfuqishme është inicuar nëse lista e nënshkruesve të iniciativës qytetare është e përpiluar në pajtim me Ligjin dhe nëse të njëjtën e ka nënshkruar 5% nga numri i tërësishëm i qytetarëve me të drejtë vote.

Mbi propozimin nga al.1 i këtij neni, Kuvendi i komunës është i obliguar të mbajë diskutim dhe të dërgon përgjigjen e arsyetuar qytetarëve në afat prej 60 ditësh nga e marrjes së propozimit.

Tubimi i qytetarëve Neni 97.

Tubimi i qytetarëve diskuton dhe jep propozime mbi çështjet nga kompetenca e organeve të komunës.

Thirrja e tubimit Neni 98.

Tubimi i qytetarëve thirret për vendbanimin ose një pjesë të vendbanimit që mund të jetë fshati, rruga pjesa e vendbanimit të qytetit, territori i Bashkësisë lokale ose formës tjetër të vetëqeverisjes lokale.

Tubimin e qytetarëve e thirrë kryetari i Komunës, kryetari i Kuvendit të komunës, përfaqësuesi i autorizuar i Bashkësisë lokale ose formës tjetër të vetëqeverisjes lokale më së paku 50 qytetarë me vendbanim në territorin për të cilin tubimi thirret dhe më së paku një e katërta e këshilltarëve, më së paku tetë ditë para ditës së mbajtjes.

Administrata komunale është e obliguar ti ofron ndihmë konvokuesit në konvokimin dhe përgaditjen e mbajtjes së tubimit të qytetarëve.

Propozimin për konvokimin e tubimit mund ta dërgon organi i Komunës kompetent për vendosje mbi çështjet që shqyrtohen në tubim.

Mbi konvokimin e tubimit, qytetarët njohtohen me vendosjen e akteve mbi konvokimin e tubimit në internet faqet e komunës, në tabelën e shaplljeve të komunës, nëpërmes të mjeteve të informimit ose në mënyrë tjetër të zakonshme.

Konvokuesi është i obliguar ta njohton Administratën komunale mbi mbajtjen e tubimit.

Puna e tubimit dhe caktimi i qëndrimeve të tubimit Neni 99.

Me tubimin e qytetarëve kryeson konvokuesi ose personi të cilin ai e autorizon.

Tubimi i qytetarëve shqyrton propozimet dhe merr qëndrimet për ato nëse janë prezent 5% e qytetarëve me të drejtë vote për territorin për të cilin është konvokuar tubimi.

Të drejtë pjesëmarrjeje në shqyrtimin e çështjeve, fillimin e iniciativave dhe propozimin e disa zgjedhjeve kanë të gjithë qytetarët e moshës madhore të komunës.

Të drejtë vendosjeje në tubimin e qytetarëve kanë edhe qytetarët vendbanimi ose pasuria e të cilëve është në territorin për të cilin tubimi është konvokuar.

Vendimet në tubimin e qytetarëve bihen me shumicë të qytetarëve prezent me të drejtë vendosjeje.

Administrata komunale është e obliguar ti ofron ndihmë profesionale qytetarëve me rastin e formulimit të propozimit gjegjësisht kërkesës së tubimit të qytetarëve, ndërsa para drejtimit të tyre organeve kompetente të komunës.

Mënyra e punës dhe mënyra e përcaktimit të qëndrimeve të tubimit

rregullohen me Vendim të Kuvendit të komunës.

**Të vepruarit e organit kompetent të
Komunës pas mbajtjes së tubimit
Neni 100.**

Organet e komunës janë të obliguar që në afat prej 60 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit të qytetarëve, shqyrtojnë kërkesat dhe propozimet e qytetarëve, të marrin qëndrime për to, gjegjësisht të bien Vendime ose masa përkatëse dhe për ate ti njohtojnë qytetarët.

**Referendumi
Neni 101.**

Kuvendi i komunës mundet me iniciativ të vetën, me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve, të shpallë referendum mbi çështjet nga kompetenca e vetë. .

Kuvendi i komunës është i obliguar të shpallë Referendum mbi çështjet nga kompetenca e vetë në kërkesë të qytetarëve të komunës.

Kërkesa e qytetarëve nga al.2 i këtij neni është i plotëfuqishëm nëse lista e nënshkruesve të kërkesës e përpiluar në pajtim me Ligjin dhe nëse të njëjtën e ka nënshkruar më së paku 10% e qytetarëve me të drejtë vote në territorin e komunës.

Vendimi me anë të referendumit është miratuar nëse për ate janë deklaruar shumica e qytetarëve me të drejtë vote në territorin e Komunës e cila ka votuar, me kusht se kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të tërësishëm të qytetarëve me të drejtë vote në territorin e komunës.

Vendimi i miratuar në referendum është i obliguar, ndërsa Kuvendi i komunës nuk mund ta ç’fuqizon e as ta ndryshon dhe plotëson përbërjen e saj në periudhë prej një viti nga dita e miratimit të Vendimit.

**Referendumi në pjesën e territorit të
Komunës
Neni 102.**

Kuvendi i komunës është i obliguar të shpallë referendum në pjesën e territorit të komunës për çështjen që mbështetet në nevojat, gjegjësisht interesat e banorëve të asaj pjese të territorit, nëse lista e nënshkruesve të kërkesës për shpalljen e referendumit është përpiluar në pajtim me Ligjin dhe nëse të njëjtën e kanë nënshkruar më së paku 10% e zgjedhësve me vendbanim në pjesën e

territorit të komunës për të cilën kërkohet shpallja e referendumit.

**Ankesat e qytetarëve
Neni 103.**

Organet e Komunës janë të obliguara që të gjithëve ti mundësojnë paraqitjen e ankesës në punën e vetë dhe në punën e parregullt të të punësuarve në Administratën komunale dhe raporti i tyre ndaj qytetarëve.

Organet e Komunës janë të obliguara që të hulumtojnë shënimet e cekura në ankesë, të cilat paraqesin lëshimet dhe parregullsit në punën e tyre dhe në pajtim me Ligjin të fillojnë procedurë përkatëse për sanksionimin dhe mënjanimin e lëshimeve dhe parregullsive.

Organet e Komunës janë të obliguara që paraqitësit e ankesës ti përgjigjen dhe ti japin informata për ate se a është vepruar si në ankesë në afat prej 30 ditësh nëse paraqitësi i ankesës ate e kërkon.

**VI. FORMAT TJERA TË
PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË
PUNËT E KOMUNËS**

**Pleqësia për zhvillimin e Komunës
Neni 104.**

Themelohet Pleqësia për zhvillimin e komunës si trup i pavarur punues.

Pleqësia për zhvillimin e Komunës :

- 10) Inicon përcaktimin e përparsive në lëmin e zhvillimit të komunës,
- 11) Merr pjesë në hartimin e Planit strategjik dhe planit të posaçëm të zhvillimit në lëmit me rëndësi për zhvillimin e Komunës,
- 12) Nxitë zhvillimin dhe përcjell partneritetin në mes të Komunës dhe organeve kompetente dhe organizatave, Bashkësive lokale dhe shoqatave të qytetarëve me qëllim të realizimit dhe zbatimit të projekteve zhvillimore.
- 13) Inicion dhe merr pjesë në përcaktimin e politikës lokale dhe masave në mbrojtjen sociale, arsimin, mbrojtjen shëndetsore, punësimin, zhvillimin përmbajtësor si dhe në lëmit tjera me rëndësi për zhvillimin e komunës,
- 14) Propozon modele të finansimit të aktiviteteve në lëmin e politikës sociale, arsimit, mbrojtjes shëndetsore, punësimit, zhvillimit përmbajtësor si

- dhe në lëmit tjera më rëndësi për zhvillimin e komunës,
- 15) Inicon përgaditjen e projekteve ose pjesëmarjes në programet ose projektet me qëllim të avansimit të shërbimeve dhe sigurimit të të drejtave të qytetarëve që janë në kompetencë të komunës,
- 16) Përcjell dhe jep mendime në realizimin e planeve strategjike dhe planeve të posaçme të zhvillimit të komunës,
- 17) Jep mendime mbi propozimet e projekteve zhvillimore në komunë të cilat pjesërisht ose në tërësi finansohen nga buxheti i komunës, përcjell realizimin e tyre dhe jep mendimin e vetë për ate organit kompetent të komunës,
- 18) Në bazë të vendimit të organit kompetent të komunës merr pjesë në programet e partneritetit dhe projektet që zbaton komuna me organet republikane dhe krahinore dhe institucionet, njësit e vetadministrimit lokal dhe në organizatat vendore dhe ndërkombëtare dhe partnerëve.

Përbërja dhe mandati i Pleqësisë për zhvillimin e Komunës

Neni 105.

Pleqësia për zhvillimin e komunës ka 5 anëtarë

Antarët e Pleqësisë për zhvillim të komunës zgjedhen në periudhën prej 4 vitesh, ndërsa pas skadimit të mandatit mund të jenë të zgjedhur përsëri.

Antarët e Pleqësisë për zhvillimin e komunës i zgjedh Kuvendi i komunës nga rradha e qytetarëve dhe profesionistëve në lëmit me rëndësi për vetadministrimin lokal, në propozim të kryetarit të komunës, Këshillit komunal, grupeve të këshilltarëve, Bashkësive lokale, shoqatave të qytetarëve, shoqatave profesionale ose shërbimeve publike të komunës, duke llogaritur mbi barazin gjinore dhe përfaqësimin e pjestarëve të pakicave kombëtare.

Për anëtar të Pleqësisë për zhvillimin e komunës mund të jetë i zgjedhur kandidati i cili plotëson më së paku njërin nga kushtet si vijon:

- 4) Profesionalizmin e dëshmuar dhe angazhimin shumëvjeçar në avansimin

e komunës në çështjet me rëndësi për zhvillimin e komunës;

- 5) Pjesëmarrja aktive në numrin më të madhë të aktiviteteve të realizuara-projekteve me rëndësi për komunën;
- 6) Përvoja shumëvjeçare dhe dëshmimi i profesionalizmit në punë në institucione dhe organizata dhe shoqata të qytetarëve në lëmit me rëndësi për komunën, si që janë zhvillimi ekonomik lokal, turizmi, bujqësia, infrastruktura komunale dhe zhvillimi urbanistik, kultura, arsimi , mbrojtja shëndetsore dhe sociale etj.

Mënyra e punës së Pleqësisë për zhvillimin e komunës

Neni 106.

Kryetari i Pleqësisë për zhvillimin e komunës organizon punën e pleqësisë për zhvillimin e komunës, konvokon dhe kryeson mbledhjet, realizon bashkëpunimin me organet e komunës dhe kryen punë tjera të përcaktuara me rregulloren e Pleqësisë për zhvillimin e komunës. .

Kryetarin e pleqësisë për zhvillimin e komunës e zgjedhin antarët e Pleqësisë për zhvillimin e komunës në pajtim me rregulloren e Pleqësisë për zhvillimin e komunës.

Mbledhjet e Pleqësisë për zhvillimin e komunës i konvokon kryetari i Pleqësisë më së paku një herë në tre muaj ose në kërkesë të shkruar të organit të komunës ose 1/3 së antarëve Pleqësisë për zhvillimin e komunës në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Punët profesionale dhe administrative lidhur me Pleqësisë për zhvillimin e komunës i kryen administrata komunale.

Mjetet për punën e Pleqësisë sigurohen nga buxheti i komunës, por mund të sigurohen edhe nga burimet tjera në pajtim me Ligjin.

Mënyra e punës së Pleqësisë për zhvillimin e komunës më për së afërmi rregullohet me Rregulloren e Pleqësisë për zhvillimin e komunës.

Anketa publike

Neni 107.

Organet e komunës mund të konsultojnë qytetarët për çështjet nga kompetenca e vetë.

Konsultimi nga al.1 i këtij neni bëhet me anë të anketës publike.

Diskutimi publik

Neni 108.

Diskutimi publik paraqet tubimin e aktiviteteve të ndryshme, të ndërmarra në kuadër të kohës së mëparshme të paraparë me qëllim të grumbullimit të propozimeve dhe qëndrimeve të qytetarëve mbi projektin e ndonjë akti.

Diskutimi publik në mënyrë të obligueshme kyçë organizimin e më së paku njëjës mbledhje të hapur të përfaqësuese të organeve kompetente të komunës, gjegjësisht shërbimeve publike me qytetarët e interesuar, përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve dhe mjeteve të formimit publik (tryeza e rrumbullakët, tribuna, prezentimi etj) dhe grumbullimi i propozimeve, sygjërimeve dhe mendimeve të qytetarëve dhe pjesëtarëve tjerë në diskutimin publik në formë të shkruar ose elektronike.

Organi kompetent për organizimin e diskutimit publik është i obliguar që qytetarëve nga të gjitha pjesët e komunës ti mundëson pjesëmarrje në diskutimin publik.

Mënyra dhe procedura e organizimit dhe zbatimit të diskutimit publik më për së afërmi rregullohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të komunës.

Koha e zgjatjes së diskutimit publik

Neni 109.

Diskutimi publik zgjatë më së paku 20 ditë.

Publikimi i fillimit të punës në përgaditjen e dispozitave

Neni 110.

Organi kompetent i komunës është i obliguar që në faqen e internetit të komunës, gjegjësisht në mënyrë tjetër ta njohton opinionin se ka filluar puna në përgaditjen e dispozitave të cilën Kuvendi e miraton.

Diskutimi i obligueshëm publik

Neni 111.

Organet e komunës janë të obliguara të mbajnë diskutim publik:

- 7) Në procedurën e përgaditjes së Statutit;
- 8) Në procedurën e përgaditjes së buxhetit të komunës (në pjesën e planifikimit të investimeve);

9) Në procedurën e përgaditjes së planeve të zhvillimit strategjik;

10) Në procedurën e përcaktimit të shkallës së të hyrave burimore të komunës;

11) Në procedurën e përgaditjes së planeve hapsinore dhe urbanistike;

12) Në rastet tjera të parapara me Ligj dhe Statut të komunës.

Diskutimi publik nga al.1 i këtij neni zbatohet mbi projekt aktet (vendime, plane dhe akti tjetër në përgaditje), por mund të zbatohet edhe më herët në propozim të organit kompetent për përgaditjen dhe përcaktimin e projektit.

Diskutimin publik nga al.1 të këtij neni organizon Këshilli komunal në mënyrë dhe kohë të cilën e propozon organi kompetent për përcaktimin e projektit, nëse me këtë Statut ose me vendim të posaçëm nga neni 109 al.4 të këtij Statuti nuk është caktuar ndryshe.

Diskutimi publik në bazë të diskutimit, gjegjësisht kërkesës

Neni 112.

Diskutimi publik mund të zbatohet në procedurën e nxjerrjes së akteve tjera të përgjithshme nga kompetenca e Kuvendit të komunës, në bazë të kërkesës së propozuesit të aktit të përgjithshëm, 1/3 së këshilltarëve ose propozim të 100 qytetarëve.

Për arsye të zbatimit të diskutimit publik, propozimi i qytetarëve është e nevojshme që me nënshkrimet e veta ta përmbajnë më së paku 100 qytetarë me të drejtë vote në territorin e komunës.

Grumbullimi i nënshkrimeve të qytetarëve për zbatimin e diskutimit publik nga al.1 i këtij neni zbatohet në pajtim me dispozitat të cilat rregullojnë iniciativën qytetare.

Trupi kompetent punues i Kuvendit të komunës vendosë sipas propozimit të pranuar, gjegjësisht kërkesës nga al.1 të këtij neni.

Одредбе овог Пословника примењују се на све учеснике седнице, а сходно се примењују на седницама радних тела Скупштине.

XVI ОБАВЉАЊЕ СТРУЧНИХ И ДРУГИХ ПОСЛОВА

Члан 207.

Стручне и административно-техничке послове за потребе Скупштине, њених радних тела, одборника и одборничких група, врши организациона јединица Општинске управе надлежна за скупштинске послове, што се уређује Одлуком о Општинској управи.

Одржавање реда у згради Скупштине и у другим просторијама у којима Скупштина ради, обезбеђује Служба физичко-техничког обезбеђења, коју ангажује Општинска управа.

XVII ЗАВРШНЕ ОДРЕДБЕ

Члан 208.

Даном ступања на снагу овог Пословника престаје да важи Пословник о раду Скупштине општине Прешево ("Службеном гласник општине Бујановац број 03/2018).

Члан 209.

Овај Пословник ступа на снагу осмог дана од дана објављивања у "Службеном гласник општине Бујановац".

СКУПШТИНА ОПШТИНЕ ПРЕШЕВО

Л.број: 110-20

Дана: 31.05.2021

Прешево,

Председник,
Sami SALIHU с.р

Në mbështetje të nenit 32. parag 1.pika 1, neni 41 të Ligjit mbi vetadministrimin lokal ("Fl.zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 129/07, 83/14 – ligji tjetër, 101/16 – ligji tjetër dhe 47/18) dhe neni 40 .aline 1.pika 1. të Statutit të komunës Preshevë ("Gazeta .zyrtare Komunës së Bujanocit ", nr.06/2021),

Kuvendi i komunës Preshevë, në mbledhjen e mbajtur më: 28.05.2021, nxjerr këtë:

R R E G U L L O R E E KUVENDIT TË KOMUNËS PRESHEVË

I. DISPOZITAT HYRËSE

4. Lënda e rregullimit

Neni 1.

Me Rregulloren e Kuvendit të komunës Preshevë (në tekstin vijues: Rregullorja) rregullohet konstituimi, organizimi i punës së Kuvendit të komunës Preshevë (në tekstin vijues: Kuvendi), mënyra e realizimit të të drejtave dhe detyrave të këshilltarëve, puna publike si dhe çështjet tjera lidhur me punën e Kuvendit dhe trupave të tij punues.

Neni 2.

Kuvendi është organi më i lartë i Komunës i cili kryen funksionet bazë të qeverisjes lokale, të përcaktuara me Kushtetutë me Ligj dhe me Statutin e Komunës (në tekstin vijues: Statuti).

Kuvendin e përbëjnë këshilltarët, të cilët i zgjedhin qytetarët në zgjedhje drejtpërdrejtë, me votim të mshehtë, në pajtim me Ligjin dhe Statutin.

Neni 3.

Kuvendin e paraqet dhe e përfaqëson Kryetari i Kuvendit.

5. Gjuha, shkrimi dhe shprehja neutrale e gjinisë

Neni 4.

Në Kuvend në përdorim zyrtarë është gjuha serbe dhe shkrimi qirilik, në pajtim me Kushtetutën, me Ligjin dhe me Statutin.

Në territorin e komunës Preshevë dhe punën e Kuvendit në përdorimin zyrtar është edhe gjuha shqipe dhe shkrimi.

Neni 5.

Të gjitha termet në këtë Rregullore janë të përdorura në gramatikë në gjininë mashkullore, nënkuptojnë gjininë mashkullore dhe femërore natyrore.

Emrat të cilat i paraqesin pozitat zyrtare, pozitat dhe funksionet në komunën e Preshevës (në tekstin vijues: Komuna) shënohet në formën gjinisë të personit që është bartës i tyre.

6. Vula e Kuvendit

7.

Neni 6.

Vula e Kuvendit është në formë të rrumbullakët, diametri 40 mm, me stemën e Republikës së Serbisë në mes.

Teksti i vulës në gjuhën serbe, me shkrimin qirilik, është e shkruar në rrathët koncentrik rreth stemës së Republikës së Serbisë.

Në rrethin e parë të jashtëm është i shkruar mbishkrimi "Република Србија" * "Republika e Sërbisë".

Në tekstin vijues, në rrethin e mbrendshëm, është i shkruar teksti: "Општина Прешево - Скупштина општине" * "Komuna e Preshevës - Kuvendi Komunal".

Në fund të vulës është shkruar vendi – Прешево * Preshevë.

Vula e Kuvendit i besohet në ruajtje sekretarit të Kuvendit.

II KONSTITUIMI I KUVENDIT

8. Konvokimi dhe konstituimi i seancës

Neni 7.

Seancën konstitutive të përbërjes së re të Kuvendit, pas mbajtjes së zgjedhjeve për këshilltarë të Kuvendit e konvokon Kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve.

Nëse Kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme mungon, është i penguar ose nuk dëshiron ta konvokon seancën konstitutive në afatin nga paragrafi 1. i këtij neni, atë mund ta bënë këshilltari më i vjetër nga përbërja e mëparshme i cili këtë e pranon, i cili është i autorizuar ta konvokon seancën konstitutive në afat prej 15 ditësh nga skadimi i afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.

Me ftesën për seancën konstitutive njësia organizative e Administratës komunale kompetente për punët e Kuvendit çdo kandidati për këshilltarë në mënyrë të obligueshme i dërgon Statutin, Rregulloren, Raportin e Komisionit komunal zgjedhorë (në tekstin vijues: Komisioni zgjedhor) për zgjedhjet e mbajtura dhe kodeksin etik të sjelljes së funksionerëve të vetadministrimit lokal në Serbi (në tekstin vijues: kodeksi etik).

9. Udhëheqja me seancën konstitutive

Neni 8.

Me seancën konstitutive deri në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit kryeson kandidati më i vjetër për këshilltarë i cili është prezent në seancë dhe i cili pranon atë detyrë (në tekstin vijues: kryesuesi), ndërsa në punë i ndihmon sekretari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme dhe kandidati më i ri për këshilltarë i cili është prezent në seancë dhe i cili pranon këtë detyrë.

Para fillimit të seancës njësia organizative e Administratës komunale kompetente për punët e Kuvendit vërteton numrin e tërësishëm të pranishmëve dhe njofton kryesuesin se a është i pranishëm numri i

dhur i kandidatëve për këshilltarë për punë dhe vendosje.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje që mbështeten në autorizimet e kryetarit të Kuvendit, njëkohësisht implementohen edhe në autorizimet e kryesuesit të seancës konstitutive.

10. Rendi i ditës i seancës

Neni 9.

Në seancën konstitutive të Kuvendit bëhet verifikimi i mandatit të këshilltarëve, zgjedhja e kryetarit dhe emërimi i sekretarit të Kuvendit.

Përveç pikave të obligueshme të rendit të ditës nga paragrafi 1. i kësaj Rregulloreje, seanca konstitutive e Kuvendit mund të ketë edhe pikat e rendit të ditës dhe ate:

- Zgjedhja e zëvendës kryetarit të Kuvendit ;
 - Zgjedhja e organeve ekzekutive të Kuvendit;
 - Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit për çështjet administrativo-mandatore.
- Kuvendi nënkuptohet i konstituuar me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit dhe emërimin e sekretarit të Kuvendit.

11. Verifikimi i mandatit të Këshilltarëve

Neni 10.

Mandati i këshilltarit fillon nga dita e verifikimit të mandatit dhe zgjatë 4 vite, gjegjësisht deri në ndërprerjen e mandatit të këshilltarëve të përbërjes së Kuvendit.

Mbi verifikimin e mandatit të këshilltarëve vendos Kuvendi në seancën konstitutive.

Verifikimi i mandatit të këshilltarëve bëhet në bazë të certifikatës mbi zgjedhjen për këshilltarë dhe raportit të Komisionit zgjedhor për zgjedhjet e mbajtura për këshilltarë. .

Me verifikimin e mandatit të këshilltarëve të posazgjedhur i pushon funksioni i kryetarit dhe zëvendës kryetarit të Kuvendit nga përbërja e mëparshme.

12. Këshilli verifikues

Neni 11.

Në fillim të seancës konstitutive në propozim të kryesuesit me shumicë votash të kandidatëve prezent për këshilltarë emëron Këshillin verifikues prej 3 anëtarësh, që propozojnë tri lista zgjedhore që kanë marrë më së shumti numër të mandateve të këshilltarëve në Kuvend. .

Me Këshillin verifikues kryeson anëtari i tij më i vjetër.

Këshilli verifikues punon në seancë në të cilën marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit dhe vendos me shumicë votash të anëtarëve të Këshillit.

Kur Kuvendi verifikon mandatin e këshilltarëve, Këshilli verifikues ndërpre punën.

Neni 12.

Pas emërimit të Këshillit verifikues, kryesuesi cakton pauzën në punën e Kuvendit më së gjati deri 30 min., ashtu që të takohet Këshilli verifikues.

Në bazë të raportit të Komisionit zgjedhor, Këshilli verifikues vërteton se a janë shënimet nga certifikata mbi zgjedhjen e çdo kandidati për këshilltarë të njëjta me shënimet nga raporti i Komisionit zgjedhor si dhe a është lëshuar certifikata nga Komisioni zgjedhor, si organ kompetent ashtu që i paraqet me shkrim raport Kuvendit që përmbanë propozimin se a duhet të verifikohet mandati i këshilltarëve.

Raportin dhe propozimin nga paragrafi 2. i këtij neni Këshilli verifikues e miraton me shumicë votash. .

Neni 13.

Raporti i Këshillit verifikues përmbanë propozimin:

- Për verifikimin e mandatit të këshilltarëve;
- Që të mos verifikohet mandati i kandidatëve veçmas për këshilltarë, me arsyetim (në rast të vdekjes së kandidatit për këshilltarë ose ekzistimit të arsyes tjetër për mosndarjen e mandatit këshilltarit të ri);
- Që të shtyhet verifikimi i mandatit të disa kandidatëve për këshilltarëve (në

rast mospajtushmërisë, gjegjësisht josaktësisë së shënimeve nga certifikata për zgjedhje dhe raportit të Komisionit zgjedhor ose dhënjën e certifikatave për zgjedhjen nga ana e organit të pautorizuar.

Neni 14.

Përfaqësuesi i Këshillit verifikues i paraqet raport Kuvendit

Për raportin e Këshillit verifikues Kuvendi diskuton në tërësi.

Pas përfundimit të diskutimit, nëse Këshilli verifikues nuk e konteston asnjë mandat, për raportin e tij Kuvendi vendos në tërësi me vota publike.

Nëse Këshilli verifikues në raportin e vetë, gjegjësisht ndonjëri kandidat për këshilltarë në vetë seancë propozon që të verifikohet mandati ndonjërit kandidat për këshilltarë, shtyhet ose të mos i verifikohet mandati, Kuvendi për ate veçmas voton.

Neni 15.

Mbi verifikimin e mandatit të këshilltarëve në bazë të raportit të Këshillit verifikues Kuvendi vendos me vota publike.

Në votim mund të marrin pjesë kandidatët për këshilltarë të cilëve ia janë ndarë mandatet në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale dhe të cilët kanë certifikatat e Komisionit zgjedhor se janë zgjedhur.

Neni 16.

Kuvendi mund të punojë dhe vendos kur i verifikohet mandati më shumë se ½ të këshilltarëve.

Kuvendi mund të shtyjë verifikimin e mandatit ndonjërit kandidat për këshilltarë dhe të kërkon nga Komisioni zgjedhor të bënë verifikimin e vlefshmërisë së certifikatës mbi zgjedhjen për këshilltarë dhe për ate ta njofton Kuvendin më së voni në afat prej 8 ditësh.

Pas verifikimit të kryer nga paragrafi 2. i këtij neni, kandidati për këshilltarë të cilit i është shtyer verifikimi i mandatit, mandati i verifikohet ose mandati i ndahet kandidatit

tjetër për këshilltarë nga lista në pajtim me Ligjin.

Neni 17.

Me ditën e verifikimit të mandatit të këshilltarëve të posazgjedhur i pushon mandati këshilltarëve të Kuvendit nga përbërja e mëparshme.

13. Verifikimi i mandatit të këshilltarëve pas konstituimit të Kuvendit

Neni 18.

Kur Kuvendi pas konstituimit vendos për verifikimin e mandatit të kandidatëve të rinjë për këshilltarë, në votim pranë këshilltarëve mund të marrin pjesë edhe kandidatët për këshilltarë të cilëve mandati i është ndarë në pajtim me Ligjin dhe të cilët kanë certifikatat e Komisionit zgjedhor se janë të zgjedhur.

Punët e Këshillit verifikues pas konstituimit, i kryen Këshilli për çështje administrativo-mandatore. .

14. Betimi

Neni 19.

Pas nxjerrjes së Vendimit mbi verifikimin e mandatit këshilltarët e posa zgjedhur japin betimin, me zë duke shqiptuar tekstin e betimit të cilën e lexon kryesuesi që ka këtë përmbajtje: **"Betohe se në punën e Kuvendit të komunës Preshevë do ti përmbahem Kushtetutës së Republikës së Serbisë, Ligjit dhe Statutit të komunës dhe me nder dhe me përgjegjësi do ti kryej detyrat e këshilltarit në interes të qytetarëve të komunës Preshevë "**.

Pas kryerjes së betimit, këshilltarët nënshkruajnë tekstin e betimit i cili i dërgohet me materialin zgjedhor.

Njëkohësisht, këshilltari mund të nënshkruaj edhe deklaratën se është i njoftuar me përmbajtjen e kodit etik.

Këshilltarët të cilët nuk kanë marrë pjesë në seancën konstitutive ose mandatin e kanë pasur në kontest e më vonë verifikohet, betimin e japin veçmas në seancën e parë të

radhës në të cilën marrin pjesë, pas verifikimit të mandateve të tyre.

III ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE ZËVENDËS KRYETARIT TË KUVENDIT

DHE EMËRIMI I SEKRETARIT DHË ZËVENDËS SEKRETARIT TË KUVENDIT

7. Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

Neni 20.

Kryetari i Kuvendit zgjidhet në seancën konstitutive nga radha e këshilltarëve, në propozim të më së paku 1/3 së këshilltarëve në periudhën mandatare prej 4 vitesh, me vota të fshehta me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve të Kuvendit.

Neni 21.

Propozimin e kandidatit për kryetar të Kuvendit i paraqitet kryesuesit me shkrim, pas verifikimit të mandatit të këshilltarëve .

Për arsye të përgatitjes së propozimit nga paragrafi 1. i këtij neni, kryesuesi mundet, në propozim të çdo këshilltarit të cilit i është verifikuar mandati të cakton pauzë në kohëzgjatje deri 30 min.

Këshilltari mund të merr pjesë në propozimin e vetëm njërit kandidat.

Propozimi nga paragrafi 1. i këtij neni përmban: emrin dhe mbiemrin e kandidatit, shënimet mbi përkatësin partiakë të kandidatit, biografinë e shkurtër, arsyetimin, nënshkrimet e propozuesve, emri dhe mbiemri i paraqitësit në emër të propozuesit dhe pëlqimi i kandidatit me shkrim.

Kryesuesi ia dërgon këshilltarëve të gjitha propozimet e paraqitura të kandidatëve për kryetar të Kuvendit.

Përfaqësuesi i propozuesve ka të drejtë që në emër të propozuesve me gojë ta arsyeton propozimin.

Kandidati i propozuar për kryetar të Kuvendit ka të drejtë që të prezantohet dhe ti drejtohet në pika të shkurtra Kuvendit

Për propozimin e kandidatit për kryetar të Kuvendit hapet diskutimi.

Pas diskutimit, kryesuesi verifikon listën e kandidatëve për kryetar të Kuvendit sipas alfabetit të mbiemrit dhe para emrit të çdo kandidati vihet numri rendor.

8. Zbatimi i votimit

Neni 22.

Pas vërtetimit të listës së kandidatëve nga neni 21 i kësaj Rregulloreje , formohet Komisioni për zbatimin dhe vërtetimin e rezultateve të votimit të fsheht nga 3 anëtarë. Në tekstin vijues: (Komisioni).

Për anëtar të Komisionit caktohet nga një këshilltarë nga 3 listat zgjedhore që kanë fituar numrin më të madh të vendeve të këshilltarëve në Kuvend.

Anëtarët e Komisionit i zgjedh Kuvendi me vota publike, me shumicë votash të këshilltarëve prezent.

Kryetarin e Komisionit e zgjedhin në mes veti anëtarët e Komisionit.

Neni 23.

Kur vërtetohet lista e kandidatëve për kryetar të Kuvendit, fillohet votimi.

Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit bëhet me vota të fshehta në hapësirën ku mbahet seanca konstitutive.

Neni 24.

Këshilltari mund të voton vetëm një kandidat për kryetar të Kuvendit.

Neni 25.

Votimi bëhet me fletëvotime.

Të gjitha fletëvotimet janë të madhësisë, formës dhe ngjyrës së njëjtë dhe të vulosura me vulën e Kuvendit.

Teksti i fletëvotimeve shkruhet në gjuhën serbe, shkrimin cirilik krahas latin dhe në gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj.

Numri i fletëvotimeve të shtypura është i njëjtë me numrin e këshilltarëve.

Fletëvotimi përmban: shënimin se votohet për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, sa kandidatë zgjedhen, numrin rendor i cili vihet para emrit të kandidatit, mbiemri dhe emri i kandidatit sipas radhitjes së përcaktuar në listën e kandidatëve dhe përkatësia e tij partiakë, si dhe mënyra e votimit.

Votimi bëhet me rrethimin e numrit rendor para emrit të kandidatit për të cilin këshilltari voton, ndërsa votohet vetëm për një

nga kandidatët në mes të kandidatëve ku janë të shënuar emrat në fletëvotime.

Në rast se është propozuar vetëm një kandidat për kryetar të Kuvendit, në fletëvotim nën emrin e tij, shkruan fjala “për” në anën e majtë, ndërsa fjala “kundër” në anën e djathtë. Votimi bëhet me rrethimin e fjalës “për” ose “kundër”.

9. Rrjedha e votimit

Neni 26.

Kryetari i Komisionit shpallë fillimin e votimit, fton këshilltarët sipas listës së këshilltarëve të zgjedhur, ua dorëzon fletëvotimet dhe e rrethon emrin dhe mbiemrin e këshilltarit nën numrin rendor, si dëshmi se këshilltarit i është dhënë fletëvotimi, ndërsa këshilltari nënshkruan listën e këshilltarit.

Për votim sigurohet kutia e votimit si është e paraparë për zgjedhjen e këshilltarëve, si dhe paravani përkatës, ashtu që të sigurohet siguria dhe fshehtësia e votimit. Votohet prapa paravanit për votim. Kutia e votimit duhet të jetë nga materiali i tejdukshëm, e zbrazët dhe para fillimit të votimit e vulosur.

Kur këshilltari e plotëson fletëvotimin, e palos ashtu që të mos shihet për kënd ka votuar, i afrohet vendit ku gjendet kutia e votimit dhe personalisht e hedh në te fletëvotimin.

Neni 27.

Votimi përfundon atëher kur voton edhe këshilltari i fundit i cili dëshiron të votojë, e më së voni 5 minuta pasi që është dorëzuar fletëvotimi i fundit i këshilltarit të ftuar.

Kur votimi është kryer kryetari i Komisionit konstaton se të gjithë këshilltarëve prezent i është mundësuar të votojnë dhe përfundon procedurën e votimit.

Komisioni vërteton rezultatet e votimit në të njëjtën hapsirë në të cilën votimi është kryer dhe për atë përpilon procesverbalin.

10. Vërtetimi i rezultateve të votimit

Neni 28.

Vërtetimi i rezultateve të votimit zbatohet në seancë me këtë rradhitje:

1. vërtetohet numri i fletëvotimeve të pranuar;
2. vërtetohet numri i këshilltarëve të cilët janë prezent në seancë;
3. vërtetohet numri i këshilltarëve të cilët kanë votuar;

4. vërtetohet numri i fletëvotimeve të papërdorura, ndërsa fletëvotimet e pa dorëzuara, të cilat vulosen në kovertë të posaçme;

5. hapet kutia e votimit dhe nëse vërtetohet se numri i fletëvotimeve në kuti është më i madh nga numri i këshilltarëve që kanë votuar, procedura anulohet dhe zbatohet votimi i përsëritur, ndërsa fletëvotimet e përdorura vulosen në kovertë të posaçme;

6. nëse vërtetohet se në kutinë e votimit ka numër të njëjtë ose më pak të fletëvotimeve nga numri i këshilltarëve që kanë votuar, vazhdohet me procedurën ashtu që fletëvotimet e pavlefshme i ndajnë i vulosin në kovertë të posaçme;

7. nga çdo fletëvotim i vlefshëm lexohet emri i kandidatit i cili ka marrë vota, që evidentohet në formularë të posaçëm;

8. vërtetohet numri i votave që ka marrë çdo njëri nga kandidatët e propozuar.

Vërtetimi i rezultateve të votimit përfshinë edhe konstatimin cili kandidat është zgjedhur, gjegjësisht se asnjë kandidat nuk është zgjedhur me shumicën e paraparë.

Neni 29.

Fletëvotimi i pavlefshëm është fletëvotimi i paplotësuar, fletëvotimi i cili është plotësuar ashtu që nuk mund të vërtetohet se për cilin propozim këshilltari ka votuar, gjegjësisht këshilltari a ka votuar “për” apo “kundër” propozimit, fletëvotimi në të cilën është rrethuar numri më i madh i kandidatëve nga numri që zgjedhjet si dhe fletëvotimi në të cilin është rrethuar kandidati i ri i cili është shkruar.

Neni 30.

Për vërtetimin e rezultateve të votimit Komisioni përpilon procesverbalin të cilin e nënshkruajnë të gjitha anëtarët e Komisionit.

Në procesverbal në mënyrë të obligueshme shënohet data dhe koha e votimit.

Kryetari i Komisionit është i obliguar të lexon procesverbalin nga parag.1 i këtij neni dhe të shpallë cili kandidat është zgjedhur, gjegjësisht asnjë kandidat nuk është zgjedhur me shumicë të paraparë.

Neni 31.

Për kryetar të Kuvendit është zgjedhur këshilltari i cili ka marrë shumicën e votave nga numri i tërësishëm i këshilltarëve. .

Neni 32.

Nëse në rrethin e parë të votimit asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk merr shumicën e duhur, në rrethin e dytë do të votohet për dy kandidatë të cilët në rrethin e parë kanë patur numrin më të madh të votave.

Në rrethin e dytë është zgjedhur kandidati i cili merr shumicën e votave nga numri i tërësishëm i këshilltarëve.

Nëse edhe në rrethin e dytë asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk merr shumicën e duhur të votave, procedura e kandidimit dhe zgjedhja përsëriten.

Neni 33.

Kryetari i Kuvendit merr detyrën pas shpalljes së rezultateve dhe merr udhëheqjen e mëtejme të seancës.

Nëse kryetari i zgjedhur i Kuvendit nuk është prezent në seancë, kryesuesi i këshilltar vazhdon me udhëheqjen deri në zgjedhjen e zëvendës kryetarit të Kuvendit.

11. Zgjedhja e zëvendës kryetarit të Kuvendit

Neni 34.

Propozimi dhe zgjedhja e zëvendës kryetarit të Kuvendit zbatohet sipas procedurës së njejtë që është përcaktuar me këtë Rregullore për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit.

12. Emërimi i Sekretarit dhe zëvendës sekretarit të Kuvendit

Neni 35.

Kuvendi emëron sekretarin e Kuvendit në seancën konstitutive të Kuvendit, ndërsa për sekretar të Kuvendit mund të emërohet personi që ka të kryer shkollimin profesional nga lëmi shkencor juridik në studimet akademike në vëllim prej më së paku 240 ESPB pikë, master i studimeve akademike, studimet specialistike akademike, studimet specialistike profesionale, gjegjësisht në studimet bazë në kohëzgjatje prej më së paku 4 vitesh ose studimet specialistike në fakultet, me provimin e dhënë profesional për punë në organet administrative dhe përvojë pune më së paku 3 vite.

Kandidatin për sekretar të Kuvendit e propozon kryetari i Kuvendit.

Propozimi i kandidatit për sekretar të Kuvendit i paraqitet Kuvendit me gojë ose shkrim.

Propozimi nga parag.1 i këtij neni përmban: emri dhe mbiemri i kandidatit, biografia e shkurtër, arsyetimi dhe pëlqimi i kandidatit i dhënë me shkrim.

Neni 36.

Sekretari i Kuvendit emërohet me vota publike, për 4 vite dhe mund përsëri të emërohet.

Për sekretar të Kuvendit emërohet kandidati për të cilin voton shumica nga numri i këshilltarëve prezent.

Me emërimin e sekretarit të Kuvendit i pushon funksioni sekretarit të Kuvendit nga përbërja e mëparshme.

Neni 37.

Nëse kandidati i propozuar nuk merr shumicën e votave të duhura, kryetari i Kuvendit përsëri do të propozon kandidat për sekretar të Kuvendit.

Deri në emërimin e Sekretarit të Kuvendit nga kompetenca e vetë punët do të kryej sekretari nga përbërja e mëparshme e Kuvendit.

Neni 38

Zëvendës Sekretari i Kuvendit emërohet në mënyrën dhe nënkushtet e njejta si Sekretari i Kuvendit

IV ZGJEDHJA DHE SHKARKIMI I ORGANEVE EKZEKUTIVE

3. Zgjedhja e organeve ekzekutive

Neni 39.

Organet ekzekutive Kuvendi, sipas rregullave zgjedh në seancën konstitutive ose në seancën e parë të radhës, e më së voni në afat prej 1 muaji nga dita e konstituimit.

Kryetarin e Komunës dhe zëvendës kryetarin e komunës zgjedh Kuvendi, nga radha e këshilltarëve në periudhë prej 4 vitesh, me vota të fshehta, me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve të Kuvendit.

Anëtarët e Këshillit komunal i zgjedh Kuvendi në periudhë prej 4 vitesh, me vota të fshehta, me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve të Kuvendit.

Anëtarët e Këshillit komunal nuk mundë të jenë njëkohësisht edhe këshilltarë.

Neni 40.

Kryetari i Kuvendit propozon kandidatin për Kryetar të Komunës.

Propozimi i kandidatit për Kryetar të komunës i paraqitet Kuvendit me shkrim.

Propozimi nga paragrafi 2. i këtij neni përmban emrin dhe mbiemrin e kandidatit, biografin personale dhe punuese, arsyetimin dhe pëlqimin e kandidatit me shkrim.

Neni 41.

Kandidati për kryetar të komunës propozon kandidatin për zëvendës kryetar të Komunës nga radha e këshilltarëve, të cilin e zgjedh Kuvendi në mënyrë të njëjtë si kryetarin e Komunës.

Kandidati për kryetar komune propozon edhe kandidatët për anëtar të Këshillit komunal.

Propozimi nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni përmban emrin dhe mbiemrin e kandidatit, shënimin e funksionit për të cilin kandidati propozohet, biografinë personale dhe punuese, arsyetimin dhe pëlqimin e kandidatit me shkrim.

Për kandidatët për kryetar të Komunës, zëvendës kryetar të Komunës dhe anëtarë të Këshillit komunal udhëhiqet diskutim i konsoliduar.

Neni 42.

Kuvendi njëkohësisht dhe në mënyrë të konsoliduar vendosë mbi zgjedhjen e Kryetarit të komunës, zëvendës Kryetarit të komunës dhe anëtarëve të Këshillit komunal. .

Neni 43.

Kuvendi zgjedh organet ekzekutive të komunës drejtpërdrejtë me zbatimin e procedurës që është përcaktuar me Ligj, Statut dhe me këtë Rregullore për zgjedhjen e Kryetarit dhe zëvendës Kryetarit të Kuvendit.

Neni 44.

Kryetarit të komunës dhe zëvendës Kryetarit të Komunës me zgjedhjen në këtë funksion i pushon mandati i këshilltarit në Kuvend.

Kryetari i komunës dhe zëvendës Kryetari i Komunës janë me punë të përhershme në komunë. .

Këshilltarit i cili zgjedhet për anëtar të Këshillit komunal i pushon mandati i këshilltarit.

Anëtarët e Këshillit komunal munden të jenë me punë të përhershme në komunë.

4. Shkarkimi dhe dorëheqja e organeve ekzekutive

Neni 45.

Kryetari i komunës mund të shkarkohet para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhë, në propozim të arsyetuar të më së paku 1/3 të këshilltarëve, në mënyrë të njëjtë në të cilën është zgjedhë.

Mbi propozimin për shkarkimin e Kryetarit të komunës duhet të diskutohet dhe vendoset në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgesës së propozimit Kryetarit të Kuvendit me zbatimin e afatit minimal për konvokimin e seancës, në pajtim me Ligjin.

Nëse Kuvendi nuk e shkarkon Kryetarin e Komunës, këshilltarët të cilët e kanë paraqitur propozimin për shkarkimin nuk munden përsëri të propozojnë shkarkimin e Kryetarit të Komunës para skadimit të afatit prej 6 muajsh nga refuzimi i propozimit të mëparshëm.

Me shkarkimin e Kryetarit të Komunës i pushon mandati zëvendës kryetarit të Komunës dhe Këshillit komunal.

Neni 46.

Zëvendës Kryetari i komunës, gjegjësisht anëtari i Këshillit komunal mund të shkarkohet para skadimit të kohës për të cilën janë zgjedhë në propozim të Kryetarit të komunës ose më së paku 1/3 e këshilltarëve, në mënyrë të njëjtë në të cilën janë zgjedhë.

Njëkohësisht me propozimin për shkarkimin e zëvendës kryetarit të komunës ose anëtarëve të Këshillit komunal, Kryetari i Komunës është i obliguar që Kuvendit ti paraqet propozimin për zgjedhjen e zëvendës kryetarit të ri të Komunës ose anëtarit të Këshillit komunal, e cila njëkohësisht sjell Vendimin mbi shkarkimin dhe zgjedhjen, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje për zgjedhjen e tyre.

Në rast se Kuvendi i komunës shkarkon zëvendës kryetarin e komunës ose anëtarët e Këshillit komunal në propozim të 1/3 së këshilltarëve, Kryetari i Komunës është i obliguar që në seancën e parë të radhës të Kuvendit të komunës të paraqet propozimin për zgjedhjen e zëvendës kryetarit të ri të Komunës, gjegjësisht anëtarit të Këshillit komunal.

Neni 47.

Për paraqitjen e dorëheqjes së Kryetarit të komunës, zëvendës kryetarit të komunës ose anëtarëve të Këshillit komunal nuk hapet diskutim, por i pushon funksioni për arsye të paraqitjes së dorëheqjes vetëm konstatohet, pa votim, ashtu që atë e bënë kryetari i Kuvendit në emër të Kuvendit.

Kryetari i komunës, zëvendës kryetarit i komunës ose anëtari i Këshillit komunal të cilët janë të shkarkuar ose kanë paraqitur dorëheqje, mbeten në detyrë dhe kryejnë punët vijuese, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri të Komunës, zëvendës kryetarit të komunës ose anëtarit të Këshillit komunal.

Me ndërprerjen e mandatit të Kuvendit pushon mandati i organeve ekzekutive të Komunës ashtu që ata të kryejnë punët vijuese nga kompetenca e vetë deri në fillimin e detyrës së Kryetarit të ri të komunës dhe Këshillit komunal, gjegjësisht Kryetarit dhe anëtarëve të organit të përkohshëm, nëse mandati i Kuvendit është ndërpre për arsye të shpërbërjes së Kuvendit.

V. ORGANIZIMI I KUVENDIT

5. Kryetari i Kuvendit

Neni 48.

Kryetari i Kuvendit organizon punën e Kuvendit, konvokon seanca, propozon rend dite, kryeson seancat, kujdeset për përgaditjen e Rregullores dhe realizimin e punës publike të Kuvendit, nënshkruan aktet të cilat i miraton Kuvendi, paraqet Kuvendin, realizon bashkëpunimin me Kryetarin e Komunës dhe Këshillit komunal, kujdeset për punën me kohë dhe harmonizimin me trupat punues të Kuvendit dhe kryen punë tjera të përcaktuara me Ligj dhe Statut.

Neni 49.

Kryetarit të Kuvendit i pushon funksioni para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhë, nëse paraqet dorëheqje, shkarkohet ose i pushon mandati i këshilltarit, në mënyrën e përcaktuar me Ligj.

Nëse dorëheqja paraqitet në seancën e Kuvendit me gojë ose me shkrim, Kuvendi në seancën e njëjtë, pa hapjen e diskutimit dhe pa votim, konstaton se kryetarit të Kuvendit i pushon funksioni.

Nëse dorëheqja paraqitet në mes të dy seancave të Kuvendit me shkrim, për dorëheqjen e Kryetarit të Kuvendit njoftohen këshilltarët e Kuvendit në fillim të seancës së parë të rregullt të Kuvendit, pa hapjen e diskutimit dhe pa votim.

Kryetari i Kuvendit mund të jetë i shkarkuar edhe para skadimit të kohës në të cilën është zgjedhë, në mënyrë të njëjtë si është zgjedhë.

Kuvendi është i obligueshëm që për propozimin për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit të deklarohet në seancën e parë të radhës nga dita e paraqitjes së kërkesës për shkarkim.

Neni 50.

Në rast të ndërprerjes së funksionit të Kryetarit të Kuvendit para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhë, Kuvendi në seancën e njëjtë, ose më së voni në seancën e radhës, të fillon procedurën e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit në pajtim me dispozitat e Rregullores.

Në rastin nga paragrafi 1. i këtij neni, detyra e Kryetarit të Kuvendit, deri në zgjedhjen e të riut, e kryen zëvendës kryetari i Kuvendit.

Neni 51.

Në rast të ndërprerjes së mandatit të këshilltarit, Kryetarit të Kuvendit i pushon funksioni i kryetarit me ditën e mbajtjes së seancës në të cilën vërtetohet se mandati i pushon.

6. Zëvendës kryetari i Kuvendit

Neni 52.

Kryetari i Kuvendit ka zëvendësin i cili i ndihmon kryetarit në kryerjen e punëve nga kompetenca e tij dhe e zëvendëson në rast të mungesës ose pengesës të kryej detyrën e vetë.

Neni 53.

Nëse zëvendës kryetarit të Kuvendit i pushojn të drejtat nga marrëdhënia e punës për shkak të zgjedhjes në atë funksion, zëvendës kryetari i Kuvendit mund të jetë me punë të përhershmenë Komunë.

Zëvendës kryetari i Kuvendit mund të paraqet dorëheqje ose mund të shkarkohet nga funksioni sipas procedurës së paraparë me këtë Rregullore për paraqitjen e dorëheqjes, gjegjësisht shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit

7. Sekretari i Kuvendit

Neni 54.

Sekretari i Kuvendit kujdeset për kryerjen e punëve profesionale dhe të punëve tjera lidhur me konvokimin dhe mbajtjen e seancave të kuvendit dhe trupave të tij punues dhe udhëheq me punët administrative lidhur me punën e tyre.

Sekretari i Kuvendit merr pjesë në seancat e Kuvendit dhe sipas nevojës jep mendimin profesional lidhur me zbatimin e Rregullores dhe çështjet tjera lidhur me punën e Kuvendit.

Sekretari i kuvendit është përgjegjës për dërgimin me kohë të njoftimeve ,shënimeve të kërkuara ,lëndëve dhe udhëzimeve ,kur ato mbështeten në fushëveprimin dhe punën e Kuvendit.

Neni 55.

Kuvendi mund,në propozim të Kryetarit të Kuvendit të shkarkon Sekretarin e Kuvendit edhe para skadimit të kohës për të cilën është emëruar.

Sekretari mund të paraqet dorëheqje. Në rast të paraqitjes së dorëheqjes, Sekretarit të Kuvendit i pushon funksioni me ditën e mbajtjes së seancës në të cilën ka paraqitur dorëheqje, gjegjësisht në seancën e parë të radhës të Kuvendit, nëse dorëheqjen e ka paraqitur në periudhën në mes të dy seancave. Për dorëheqjen e paraqitur nuk hapet diskutim,e as nuk vendoset, por në bazë të kësaj ndërprerja e funksionit të Sekretarit vetëm konstatohet.

8. Zëvendës sekretari i Kuvendit

Neni 56.

Sekretari i Kuvendit mund të ketë zëvendës, i cili e zëvendëson në rast të mungesës ose pengesës që të kryej detyrën e vet.

Zëvendës sekretari i kuvendit emërohet dhe shkarkohet në mënyrë të njëjtë dhe në kushte të njëjta si Sekretari i Kuvendit dhe mund të paraqet dorëheqje.

VI GRUPET E KËSHILLTARËVE

3. Formimi i grupeve të këshilltarëve

Neni 57.

Këshilltarët kanë të drejtë të formojn grupet e këshilltarëve..

Grupin e këshilltarëve e përbëjnë këshilltarët e njëres parti politike, koalicioni i partive politike ose grupi i qytetarëve që ka më së paku 3 këshilltarë në Kuvend.

Grupin e këshilltarëve me më së paku 3 këshilltarë mundën me bashkim të formojnë edhe këshilltarët e partive politike, koalicionin e partive politike ose grupi i qytetarëve që kanë më së paku 3 këshilltarë. .

Mbi formimin e grupit të këshilltarëve njoftohet kryetari i Kuvendit të cilit i dërgohet lista me nënshkrimet e anëtarëve të grupit të këshilltarëve. Në listë veëmas shënohet shefi i grupit të këshilltarit dhe zëvendësi i tij.

Këshilltari mund të jetë anëtar vetëm i një grupi të këshilltarëve.

Këshilltari i cili nuk është anëtar i asnjë grupi të këshilltarëve, i dërgon njoftim kryetarit të Kuvendit se në Kuvend do të qëndroj vetëm.

Neni 58.

Grupi i këshilltarëve merr pjesë në punën e Kuvendit në mënyrë të përcaktuar me këtë Rregullore.

Grupi i këshilltarëve merr qëndrimet për çështjet të cilat i shqyrton Kuvendi, fillon iniciativën për shqyrtimin e çështjeve të posaçme, propozon nxjerrjen e akteve të përgjithshme të Kuvendit dhe ndërmerr edhe aktivitete tjera në pajtim me këtë Rregullore.

4. Shefi i grupit të këshilltarëve

Neni 59.

Grupin e këshilltarëve e paraqet shefi i grupit të këshilltarëve.

Grupi i këshilltarëve ka zëvendësin e shefit të grupit të këshilltarëve i cili e zëvendëson në rast të mungesës ose pengesës.

Gjatë seancës së Kuvendit, grupi i këshilltarëve mund ta autorizon njërin nga anëtarët e vetë që ta paraqet grupin e këshilltarëve sipas pikës së caktuar të rendit të ditës, për të cilën shefi i grupit të këshilltarëve me shkrim e njofton Kryetarin e Kuvendit, më së voni deri në hapjen e diskutimit për atë pikë të rendit të ditës.

Nëse grupin e qytetarëve e paraqet zëvendës shefi, gjegjësisht përfaqësuesi i autorizuar, ai merr autorizimin e shefit të grupit të këshilltarëve.

Neni 60.

Shefi i grupit të këshilltarëve me shkrim njohton Kryetarin e Kuvendit mbi ndryshimin e përbërjes së grupit të këshilltarëve.

Me rastin e kyçjes së antarëve të ri në grupin e këshilltarëve shefi i grupit të këshilltarëve ia dërgon kryetarit të Kuvendit deklaratat e tyre të nënshkruara për kyçje.

Në rast se këshilltari largohet nga përbërja e grupit të këshilltarëve, për ate me shkrim e njohton Kryetarin e Kuvendit.

Mbi formimin e përbërjes së re ose mbi ndryshimin në grupet ekzistuese të këshilltarëve, Kryetari i Kuvendit njofton këshilltarët në seancën e parë të rradhës.

Neni 61.

Punët profesionale dhe administrativo teknike për nevojat e grupeve të këshilltarëve i kryen njësia organizative e Administratës komunale kompetente për punët e Kuvendit.

VII TRUPAT PUNUESE TË KUVENDIT

8. Trupat e përhershëm punues

Neni 62.

Për shqyrtimin e çështjeve të posaçme nga kompetenca e Kuvendit, dhënjën e mendimit në propozimet e akteve dhe vendimeve të cilat i miraton Kuvendi dhe kryerjen e punëve tjera në pajtim me Statutin dhe me këtë Rregullore formohen trupat e përhershme punuese të Kuvendit.

Trupi i përhershëm punues përcjell gjendjen në lëmin për të cilën është formuar, raporton Kuvendin për ate dhe Kuvendit i propozon masa për përmirsimin e gjendjes në lëmin për të cilin është themeluar.

Anëtarët e trupave të përhershëm punues zgjedhen nga rradha e këshilltarëve dhe qytetarëve, në periudhën mandatore për të cilën janë zgjedhë edhe këshilltarët e Kuvendit.

Trupi i përhershëm punues i Kuvendit ka kryetarin dhe 4 anëtarë.

Neni 63.

Anëtarët e trupave të përhershëm punues të Kuvendit propozojnë grupet e këshilltarëve proporcionalisht me numrin e këshilltarëve që kanë në Kuvend, përveç për

zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për çështjet administrativo-mandatore.

Këshilltari mund të jetë anëtar më së shumti i 2 (dy) trupave të përhershëm punues të Kuvendit.

Anëtarët e Këshillit komunal nuk mund të jenë anëtarë të Trupave punues të Kuvendit.

Pranë këshilltarëve, anëtarët e përhershëm të trupave punues të Kuvendit duhet të jenë edhe qytetarët, profesionist për disa lëmi, ashtu që numri i tyre duhet të jetë më i vogël nga numri i anëtarëve që janë këshilltarë.

Anëtarët e trupave të përhershëm punues nga rradha e qytetarëve-profesionistëve për disa lëmi, grupeve të këshilltarëve mund t'ia propozojnë Bashkësitë lokale, shërbimet publike, si dhe Shoqatat e qytetarëve të themeluara në lëmin për të cilën formohet trupi punues.

Neni 64.

Për listën e propozuar për zgjedhjen e anëtarëve të trupiave të përhershme punuese, Kuvendi vendos në tërësi me votim të hapur.

Trupat e përhershme punuese janë zgjedhur nëse ka votuar shumica e këshilltarëve prezent.

Nëse trupat e përhershme punuese nuk zgjedhet, përsëritet e tërë procedura me kandidat të rinj.

Neni 65.

Kryetari i Kuvendit thirrë mbledhjen e parë të trupit të përhershëm punues.

Trupi i përhershëm punues në mbledhjen e parë zgjedh Kryetarin dhe zëvendës kryetarin me shumicë votash nga numri i tërësishëm i anëtarëve, nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

Deri në zgjedhjen e kryetarit të trupit të përhershëm punues, mbledhjen e parë e kryeson këshilltari më i vjetër, anëtari i trupit të përhershëm punues.

Neni 66.

Kryetari i trupit të përhershëm punues organizon punën, thirr dhe kryeson mbledhjen e trupit të përhershëm punues, formulon konkluzione dhe për atë e njofton Kryetarin dhe Sekretarin e Kuvendit.

Zëvendës kryetari i trupit të përhershëm punues zëvendëson kryetarin e trupit të përhershëm punues në rast të mungesës së tij ose pengesës.

Neni 67.

Kuvendi mundet edhe para skadimit të kohës për të cilën janë zgjedhë, të shkarkon disa anëtarë të trupave punues dhe zgjedh të rinj me anë të propozimit veçmas dhe zgjedhjes.

Propozimin për shkarkimin e anëtarit të trupit të përhershëm punues mund ta paraqet Kryetari i Kuvendit, kryetari i trupit të përhershëm punues ose grupi i këshilltarëve në propozim të cilit ai anëtar është zgjedhë.

Anëtari i trupit të përhershëm punues është shkarkuar kur për atë ka votuar shumica e këshilltarëve të cilët marrin pjesë në seancën e Kuvendit.

9. Mbledhjet e trupave të përhershme punues

Neni 68.

Kryetari i trupit të përhershëm punues është i obliguar ta thirr mbledhjen në kërkesë të më së paku 1/3 së anëtarëve të trupit të përhershëm punues si dhe me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit. Afati për thirrjen e mbledhjes është 2 (dy) nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Nëse atë nuk e bënë kryetari i trupit të përhershëm punues në afatin e kërkuar, mbledhjen e trupit të përhershëm punues mund ta thirrë Kryetari i Kuvendit.

Neni 69.

Trupat punues të Kuvendit punojnë në mbledhje në të cilat marrin pjesë shumica e anëtarëve, ndërsa vendosin me shumicën e votave nga numri i tërësishëm i anëtarëve.

Njoftimin për datën e mbajtjes, rendin e ditës dhe materialin për mbledhjen e trupit të përhershëm punues i dërgohet anëtarëve të trupit të përhershëm punues më së voni 24 orë para mbajtjes së mbledhjes.

Veçmas nga paragrafi 2. i këtij neni, njoftimin për datën, rendin e ditës dhe materialin për mbledhje mund të dorëzohen edhe në afat më të shkurtër, në ç'rast kryetari i trupit të përhershëm punues është i obliguar që në mbledhjen e trupit punues ta arsyeton këtë procedurë.

Veçmas nga paragrafi 2. i këtij neni mbledhja e trupit punues mund të thirret edhe

drejtpërdrejtë para fillimit ose në pauzë të seancës së Kuvendit, përveç se në rast se kur është në rend dite të mbledhjes së trupit punues propozimi i aktit të përgjithshëm.

Neni 70.

Në mbledhjen e trupit të përhershëm punues në mënyrë të obligueshme thirret përfaqësuesi i propozuesit, si hartues i aktit që shqyrtohet në mbledhje.

Në punën e trupit të përhershëm punues me ftesë mund të marrin pjesë edhe punëtorët profesional dhe shkencorë nga lëmi që shqyrtohet në mbledhjen e trupit të përhershëm punues, pa të drejtë vendosjeje.

Në mbledhjen e trupit të përhershëm punues mund të marrin pjesë dhe të jenë prezent në punë pa të drejtë vendosjeje edhe këshilltarët të cilët nuk janë anëtar të atij trupi të përhershëm punues, si mbrojtësi lokal.

Neni 71.

Në ekzekutimin e punëve nga fushëveprimi i vetë, trupi punues i Kuvendit mund të kërkon nga organi kompetent dhe shërbimi shënimet dhe informatat me rëndësi për punën e vetë.

Në propozim të Sekretarit të Kuvendit, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë dhe m'varësisht nga ngjashmëria e pikave të rendit të ditës, dy ose më shumë trupa punues mund të mbajnë mbledhjen e përbashkët të trupave punues.

Neni 72.

Pas përfundimit të mbledhjes trupi i përhershëm punues i paraqet Kuvendit raportin që përmban mendimin dhe propozimin e trupit të përhershëm punues.

Mendimet dhe propozimet e trupave punues të Kuvendit i nënshkruan kryetari dhe procesmbajtësi.

Trupi i përhershëm punues cakton paraqitësin i cili në seancën e Kuvendit, sipas nevojës arsyeton raportin e trupit të përhershëm punues.

Neni 73.

Në kërkesë të ndonjërit anëtar të trupit punues, mendimi i tij i ndarë do të paraqitet para Kuvendit në raport, gjegjësisht propozimit të atij trupi punues.

Anëtarë i trupit punues i Kuvendit i cili ka ndarë mendimin ka të drejtë që ta arsyeton para hapjes së diskutimit në seancën e Kuvendit.

Neni 74.

Në mbledhjen e trupit të përhershëm punues udhëhiqet procesverbali, në të cilin në mënyrë të obligueshme shënohen emrat e atyre që janë prezent, propozimet e paraqitura në mbledhje, qëndrimet e trupit të përhershëm punues, rezultatet e çdo votimi, çdo mendim i ndarë si dhe paraqitësit.

Procesverbali nga mbledhja e mëparshme e trupit punues miratohet para fillimit të rendit të ditës.

10. Dëgjimi publik

Neni 75.

Trupi i përhershëm punues mund të organizon dëgjim publik për propozimet e akteve të përgjithshme të cilat i miraton Kuvendi.

Dëgjimi publik nga paragrafi 1. i këtij neni organizohet për arsye të grumbullimit të informatave gjegjësisht mendimeve profesionale për propozimin e aktit të përgjithshëm që është në procedurë të Kuvendit, sqarimet e Aktvendimeve të posaçme nga aktet e propozuara ose të vlefshme të përgjithshme, sqarimet e çështjeve me rëndësi për përgaditjen e propozim aktit të përgjithshëm ose çështjes tjetër që është në kompetencë të trupit të përhershëm punues, si dhe për arsye të përcjelljes së zbatimit dhe implementimit të akteve të përgjithshme të vlefshme.

Neni 76.

Propozimin për organizimin e dëgjimit publik mund ta paraqet çdo anëtar i trupit të përhershëm punues.

Propozimi nga paragrafi 1. i këtij neni përmbanë temën e dëgjimit publik dhe listën e personave të cilët do të ftohen.

Vendimin mbi orranizimin e dëgjimit publik e bjen trupi i përhershëm punues.

Në vendimin nga paragrafi 3. i këtij neni kryetari i trupit të përhershëm punues e njofton kryetarin e Kuvendit.

Kryetari i trupit të përhershëm punues në dëgjim publik fton të gjithë anëtarët e trupit të përhershëm punues këshilltarët dhe personat tjerë, prezenca e të cilëve është me rëndësi për temën e dëgjimit publik.

Ftesa nga paragrafi 5. i këtij neni përmbanë, temën kohën dhe vendin e mbajtjes së dëgjimit publik si dhe njoftimin për pjesëmarrësit e ftuar.

Dëgjimi publik mbahet pa marrë parasysh numrin e anëtarëve prezent të trupave të përhershëm punues.

Pas dëgjimit publik, kryetari i trupit të përhershëm punues dërgon informatën mbi dëgjimin publik kryetarit të Kuvendit, anëtarëve të trupit të përhershëm punues dhe pjesëmarrësve të dëgjimit publik.

Informata përmbanë emërat e pjesëmarrësve në dëgjim publik, pasqyra e shkurtër e paraqitjes, qëndrimeve dhe propozimeve të paraqitura në dëgjimin publik.

Anëtarët e trupit të përhershëm punues dhe pjesëmarrësit e dëgjimit publik, mund të paraqesin vërejtje me shkrim në informatën mbi dëgjimin publik kryetarit të trupit të përhershëm punues, i cili ia dërgon personave nga al.8 të këtij neni.

11. Këshillat

Neni 77.

Trupat e përhershëm punues të Kuvendit formohen si këshilla. Këshillat e Kuvendit janë:

16. Këshilli për çështjet administrativo- mandatore,
17. Këshilli për zgjedhje dhe emërimë,
18. Këshilli për shkresat dhe administratën,
19. Këshilli për zhvillimin shoqëroro-ekonomik, ekonomi dhe finansa,
20. Këshilli për veprimtari shoqërore,
21. Këshilli për urbanizëm, ndërtimtari dhe veprimtari komunalo-banesore,
22. Këshilli për punë dhe zhvillim të bashkësive lokale,
23. Këshilli për bujqësi dhe zhvillim rural,
24. Këshilli për mbrojtjen dhe avansimin e mjedisit jetësor,

25. Këshilli për parashpresa dhe ankesa,
26. Këshilli për çmime dhe mirënjohje,
27. Këshilli për përcaktimin e propozimeve të emërimit të rrugëve, shesheve, fshatrave dhe pjesëve të vendbanimeve,
28. Këshilli për marrëdhëniet me bashkësitë fetare,
29. Këshilli për luftën kundër korrupsionit,
30. Këshilli për çështjet sociale.

a) Këshilli për çështjet administrativo- mandatore

Neni 78.

Këshilli për çështjet administrativo-mandatore përgadit dhe propozon dispozita me të cilat rregullohen çështjet e realizimit të të drejtave dhe detyrave të këshilltarëve, bjen akte të veçanta për çështjet statusit të këshilltarëve dhe personave të cilat i zgjedh, emëron dhe cakton Kuvendi, shqyrton propozimet për ndërprerjen e mandatit të disa këshilltarëve dhe për atë i paraqet Kuvendit raport me propozimin për përcaktimin e ndërprejes së mandatit këshilltarëve, shqyrton raportin e Komisionit zgjedhor dhe certifikatat mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe i paraqet Kuvendit raport me propozimin për verifikimin e mandatit, shqyrton edhe çështjet tjera lidhur me të drejtat mandatoro- të imunitetit të këshilltarëve.

Në procedurën e verifikimit të mandatit të këshilltarëve, Këshilli punon në mënyrën e përcaktuar me këtë Rregullore për punën e Këshillit verifikues në seancën konstitutive të Kuvendit.

b) Këshilli për zgjedhje dhe emërimie

Neni 79.

Këshilli për zgjedhje dhe emërimie, përgaditë propozime për zgjedhje, emërimie dhe shkarkime për të cilët me akt të veçantë nuk është paraparë propozuesi tjetër.

Këshilli përgaditë propozimin për zgjedhje, emërimie dhe shkarkime të anëtarëve të organeve dhe përfaqësuesve të Kuvendit në organet e caktuara me Ligj dhe Statut për të

cilët nuk është paraparë propozim nga ana e organit tjetër, Këshilli vendos për shkallën e parë mbi të drejtat në bazë të punës së personave të cilat i zgjedh, emëron ose i përzgjedh Kuvendi dhe jep propozime dhe mendime Kuvendit për plotësimin e kushteve për zbatimin e procedurës së shkarkimit të atyre personave.

v) Këshilli për dispozita dhe administratë

Neni 80.

Këshilli për dispozita dhe administratë shqyrton harmonizimin e propozim vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme të cilat i miraton Kuvendi me Kushtetut, Ligj, me Statut dhe me dispozita tjera dhe jep i jep propozime dhe mendime Kuvendit.

Këshilli përcjell gjendjen në lëmin e veprimtarisë normative të Kuvendit dhe tregon për nevojat e miratimit, gjegjësisht harmonizimit të vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme, vërteton tekstet e spastruara të Vendimeve dhe dispozitave tjera të Kuvendit, shqyrton dhe vërteton propozimet interpretimit autentik të dispozitave miratues i të cilëve është Kuvendi.

Këshilli jep mendime për propozim statutin, për ndryshimin dhe plotësimin e tij. Këshilli përcjell zbatimin e Statutit dhe jep propozim në interpretimin autentik të dispozitave të tij, poashtu shqyrton edhe çështjet lidhur me ndryshimin e Statutit të ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera themelues i të cilëve është Komuna dhe për ate Kuvendit i dërgon mendimin e vetë.

Ky Këshill vërteton propozimin e Rregullores mbi punën e Kuvendit, gjegjësisht propozimin mbi ndryshimin dhe plotësimin e këtij akti.

Këshilli, në pajtim me Ligjin, përcakton propozim mendimin ose i përgjigjet Gjykatës kushtetuese të Republikës së Serbisë, në procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë, gjegjësisht ligjshmërisë së Statutit, vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme të cilat i ka miratuar Kuvendi.

Këshilli shqyrton realizimin e sistemit të vetadministrimit lokal në Komunë, realizimin e punëve të administratës shtetërore të cilat Republika ia beson komunës, shqyrton çështjet e organizimit të punës së

Administratës dhe jep mendim për propozim vendimin mbi organizimin e Administratës komunale, shqyrton çështjet e bashkëpunimit ndërkomunal dhe i paraqet propozime organit kompetent për krijimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejme të raporteve dhe lidhjeve të komunës me komuna dhe qytete tjera në vend dhe jashtë, çështjet e realizimit të lirisë, të drejtave dhe obligimeve të qytetarëve si dhe çështjet tjera nga lëmi i vetadministrimit lokal dhe administratës.

g) Këshilli për zhvillimin shoqëroro-ekonomik, ekonomi dhe finansa

Neni 81.

Këshilli për zhvillimin shoqëroro-ekonomik, ekonomi dhe finansa shqyrton dhe jep mendimin në propozim programin e zhvillimit të komunës dhe disa veprimtarive dhe propozon masa për zbatimin e tyre, shqyrton planet strategjike dhe dokumente tjera me rëndësi për zhvillimin ekonomik të komunës, shqyrton propozim vendime nga lëmi i ekonomisë, zejtarisë, turizmit, hotelierisë dhe tregëtis.

Këshilli shqyrton propozim vendimet dhe aktet tjera të përgjithshme që mbështeten në finansimin e punës së komunës, taksat, kompenzimet dhe të hyrat tjera publike, programet e zhvillimit të veprimtarive për të cilat është kompetente Kuvendi, buxheti, vendimi mbi llogarinë përfundimtare të buxhetit, huamarrjet dhe borxhet e komunës dhe çështjet tjera ekonomiko-finansiare, i propozon Kuvendit miratimin e vendimeve përkatëse dhe jep mendime për propozimet e propozuesve tjerë të autorizuar.

d) Këshilli për veprimtaritë shoqërore

Neni 82.

Këshilli për veprimtari shoqërore shqyrton programet dhe raportet vjetore mbi punën e institucioneve themelues i të cilëve është komuna nga lëmi i arsimit fillor dhe të mesëm, kulturës, sportit, shëndetësisë, kujdesit shoqëror ndaj fëmijëve, mbrojtjes sociale, informimit, shqyrton çështjet dhe problemet në lëmin e krijimtarisë artistike, kujdesit ndaj rinisë, delikuençës së të miturve, kujdesit ndaj

personave me aftësi të kufizuara, barazisë gjinore dhe mundësive të njëjta për të gjithë, mbrojtjes së familjeve dhe të ngajshme.

Këshilli shqyrton propozim buxhetin e komunës, veçmas në pjesën që mbështetet në finansimin e programit të veprimtarisë shoqërore ndërsa mendimet, qëndrimet, konkluzionet dhe sygjërimet e veta ia dërgon Kuvendit për arsye të nxjerrjes së vendimit përkatës.

Këshilli është i obliguar të shqyrton kundërshtimet eventuale të institucioneve, programet e të cilëve i finanson komuna nga buxheti i vetë, të cilat mbështeten në realizimin e programit dhe planit financiar të miratuar të veprimtarisë së caktuar, institucionit ose organizatës dhe për ate ta njohton Kuvendin.

gj) Këshilli për urbanizëm, ndërtimtari dhe veprimtari komunalo-banesore

Neni 83.

Këshilli për urbanizëm, ndërtimtari dhe veprimtari komunalo-banesore shqyrton çështjet nga lëmi i urbanizmit, veprimtaritë banesoro-komunale dhe rregullimin e tokës ndërtimore, i propozon Kuvendit nxjerrjen e Vendimeve përkatëse dhe akteve tjera të përgjithshme që mbështeten në kryerjen dhe zhvillimin e veprimtarive komunale, rregullimin e tokës ndërtimore, ndërtimin banesorë dhe raportet banesore, planifikimin hapësinor dhe urbanizmit në territorin e komunës, transportin e qytetit publik dhe jashtë qytetit të udhëtarëve (linjor dhe jashtë linjor), ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e rrugëve lokale dhe rrugëve të pakategorizuara dhe rrugicave, si dhe çështjet tjera nga kjo lëmi, si dhe dhënia e mendimeve dhe propozimeve të propozuesve tjerë të autorizuar.

e) Këshilli për punën dhe zhvillimin e Bashkësive lokale

Neni 84.

Këshilli për punën dhe zhvillimin e Bashkësive lokale shqyrton çështjet e formimit

të BL dhe harmonizimin e raporteve në Bashkësitë lokale, nxitë zhvillimin e infrastrukturës në territorin e Bashkësive lokale, kontrollojnë dhe nxitë punën e Bashkësive lokale, shqyrton edhe çështjet tjera nga interesi për qytetarët në bashkësitë lokale, i propozon Kuvendit nxjerrjen e vendimeve përkatëse dhe jep mendime për propozimet e propozuesve tjerë të autorizuar.

zh) Këshilli për bujqësi dhe zhvillimin rural

Neni 85.

Këshilli për bujqësi dhe zhvillimin rural shqyrton çështjet nga lëmi i zhvillimit dhe planifikimit, orientimit dhe nxitjes së zhvillimit të bujqësisë dhe rregullimin e teritoreve rurale dhe zhvillimin rural, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, i propozon Kuvendit nxjerrjen e vendimeve përkatëse dhe jep mendime për propozimet e propozuesve tjerë të autorizuar.

z) Këshilli për mbrojtjen dhe avansimin e mjedisit jetësor

Neni 86.

Këshilli për mbrojtjen dhe avansimin e mjedisit jetësor përcjell dhe shqyrton çështjet lidhur me ekologjinë, mbrojtjen dhe avansimin e mjedisit jetësor, të ajrit, natyrës dhe të mirave natyrore, mbrojtjen nga zhurma dhe përcjell aktivitetet në pengimin dhe mënjanimin e pasojave të dëmshme që rrezikojnë mjedisin jetësor, i propozon Kuvendit nxjerrjen e vendimeve përkatëse dhe jep mendime për propozimet e propozuesve tjerë të autorizuar.

i) Këshilli për parashtrëse dhe ankese

Neni 87.

Këshilli për parashtrëse dhe ankese shqyrton parashtrësat dhe ankesat të cilat qytetarët ia drejtojnë Kuvendit, kryetarit të komunës dhe Këshillit komunal si dhe parashtrësat të cilat huazon nga ana e organeve republikane, hulumton mbështetshmërinë e tyre, i propozon Kuvendit nxjerrjen e vendimeve përkatëse dhe masat të cilat duhet

ndërmarrë me qëllim të mënjanimit të parregullsive të vërtetuara në punën e organeve të komunës, për të cilat i njohton paraqitësit.

Në procedurën e shqyrtimit të parashtrësve dhe ankesave, ky Këshill merr raportet nga organet dhe organizatat për të cilat këto parashtrime mbështeten, në afatin të cilin vetë e cakton.

Nëse organi ose organizata nga parag.2 i këtij neni nuk e dërgon raportin në afatin e caktuar, Këshilli për atë e njofton Kuvendin, gjegjësisht organin i cili ka paraqitur parashtrësën.

j) Këshilli për çmime dhe mirënjohje

Neni 88.

Këshilli për çmime dhe mirënjohje shqyrton propozime për çmime, lavdrata dhe mirënjohje tjera komunale, kujdeset për ndarjen e tyre, siguron publicitetin përkatës në mjetet e informimit publik ose në mënyrë tjetër përkatëse, kryen edhe punë tjera që mbështeten në çmime dhe mirënjohje të cilat i ndanë Kuvendi, i propozon Kuvendit nxjerrjen e vendimit përkatës dhe jep mendime për propozimet e propozuesve tjerë të autorizuar.

k) Këshilli për përcaktimin e propozimeve të emërimit të rrugëve, shesheve,

fshatrave dhe pjesëve të vendbanimeve

Neni 89.

Këshilli për përcaktimin e propozimit të emërimit të rrugëve, shesheve, fshatrave dhe pjesëve të vendbanimeve, përcakton propozimet e emërimeve të rrugëve, shesheve, fshatrave dhe pjesëve të vendbanimeve në territorin e komunës Preshevë, i propozon Kuvendit nxjerrjen e Vendimit përkatës dhe jep mendimin për propozimet e propozuesve tjerë të autorizuar.

**l) Këshilli për marrëdhëniet me
Bashkësitë fetare**

Neni 90.

Këshilli për marrëdhëniet me Bashkësitë fetare përcjell dhe shqyrton çështjet e raporteve dhe bashkëpunimit të Kuvendit me Bashkësitë fetare, ju ndihmon në zgjidhjen e problemeve në të cilat hasin, kujdeset për krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira ndërkonfesional, harmonizimit në mes veti dhe tolerancës fetare dhe ndërnacionale, kryen edhe punë tjera nga lëmi i marrëdhënieve me bashkësitë fetare, i propozon Kuvendit nxjerrjen e vendimeve përkatëse që mbështeten në bashkësitë fetare dhe jep mendimin për propozimet e propozuesve tjerë të autorizuar.

l) Këshilli për luftën kundër korrupsionit

Neni 91.

Këshilli për luftën kundër korrupsionit bënë analizën e formave të dukshme të korrupsionit në nivelin lokal, shqyrton dhe ia dërgon Kuvendit mendimin në propozim të Planit lokal akcional për luftën kundër korrupsionit (në tekstin vijues: PLA), pjesëmarrja aktive në edukimin për mekanizmat antikorruptive, mënyrën dhe rëndësinë e mbikëqyrjes ndaj zbatimit PLA , ndihmon në zbatimin e kampanjës për informimin e qytetarëve për mekanizmat e PLA, përcjell dhe shqyrton gjendjen dhe paraqitjen e korrupsionit në të gjitha lëmit e jetës shoqërore dhe vështtron aktivitetet në luftën kundër korrupsionit, i propozon Kuvendit masa të cilat duhet ndërmarrë, përcjell zbatimin e tyre dhe jep iniciativa për nxjerrjen e akteve dhe masave përkatëse në këtë lëmi, ashtu që organet e Komunës dhe bartësit e autorizimeve publike në nivelin lokal autorizimet e veta ti kryejnë në pajtim me parimet e sundimit të Ligjit, zerotolerancë në korrupsion, përgjegjësi, efikasitet dhe transparencë.

m) Këshilli për çështje sociale

Neni 92.

Këshilli për çështje sociale shqyrton çështjet nga lëmi i politikës sociale dhe sigurimit social të qytetarëve, për arsye të realizimit të detyrave të veta realizon bashkëpunimin e ngushtë me institucionet nga lëmi i mbrojtjes sociale, i propozon Kuvendit nxjerrjen e vendimeve dhe masave përkatëse për tejkalimin problemeve.

**12. Trupat e veçanta të përhershme
punuese**

Neni 93.

Pranë trupave të përhershme punuese të parapara me këtë Rregullore, Kuvendi themelon trupa të veçanta të përhershme punuese të Kuvendit, në pajtim me Ligjin dhe Statutin:

6. Pleqësia për të rinjët,
 7. Komisioni për barazi gjinore,
 8. Pleqësia për shëndetësi,
 9. Pleqësia për përcjelljen e zbatimit të kodit etik,
 10. Pleqësia shfrytëzuese e shërbimeve publike.
- Pranë këshilltarëve, anëtarët e trupave të veçantë të përhershëm punues të Kuvendit duhet të jenë edhe qytetarët, profesionistët për lëmi të veçanta, ashtu që numri i tyre mund të jetë edhe më i madh nga numri i anëtarëve të cilët janë këshilltarë.

a) Pleqësia për të rinjët

Neni 94.

Pleqësia për të rinjët shqyrton çështjet lidhur me avansimin e pozitës së të rinjëve, jep mendime në propozim vendimet dhe aktet tjera të përgjithshme të cilat i miraton Kuvendi në lëmit me rëndësi për të rinjët, inicon përgaditjen e projekteve dhe pjesëmarrjen e Komunës në projektet dhe programet për avansimin e pozitës së të rinjëve, stimulon bashkëpunimin e Komunës dhe organizatave dhe shoqatave rinore dhe jep përkrahjen e realizimit të aktiviteteve të tyre, jep mendimin për propozimet e projekteve me rëndësi për të rinjët të cilët pjesërisht ose në tërësi finansohen nga buxheti i Komunës dhe përcjell realizimin e tyre, inicon dhe merr pjesë në hartimin e Strategjisë dhe planeve

lokale akcionale nga lëmi i pozitës së të rinjëve, përcjell realizimin e tyre, si dhe punët tjera nga interesi për të rinjtë, me qëllim të realizimit të kushteve për jetë më kualitative të të rinjëve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në rrjedhat bashkëkohore të zhvillimit të shoqërisë.

Pleqësia ka kryetarin dhe 6 anëtarë, ashtu që më së paku $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të Pleqësisë duhet të jenë të moshës prej 15 deri 30 v.

Me aktin e formimit të Pleqësisë rregullohet përbërja, kompetenca, mënyra e punës, të drejtat dhe detyrat e Kryetarit dhe anëtarëve të Pleqësisë dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Pleqësisë në pajtim me Ligjin.

b) Komisioni për barazi gjinore **Neni 95.**

Komisioni për barazi gjinore shqyrton propozim vendimet dhe aktet tjera të përgjithshme të cilat i miraton Kuvendi nga popullata të avancimit të barazisë gjinore, vështron rezultatet e udhëheqjes së politikës dhe ekzekutimit të akteve të Kuvendit nga ana e organeve ekezekutive të komunës dhe organeve dhe funksionerëve të tjerë përgjegjës Kuvendit, në vështrim të respektimit të barazisë gjinore, e veçmas atyre të cilëve i realizohet politika e barabartë e mundësisë në nivelin e Komunës, shqyrton planet lokale akcionale nga lëmi i barazisë gjinore dhe zbatimin e standardeve në prezencën e barabartë të femrave dhe meshkujve në vendimarrje në jetën publike dhe politike të Komunës.

Komisioni ka kryetarin dhe 6 anëtarë, ashtu që më së paku 4 anëtar të Komisionit duhet të jenë të përkatësisë së prezencës më të vogël të gjinisë.

Me aktin e formimit të Komisionit rregullohet përbërja, kompetenca, mënyra e punës, të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Komisionit, në pajtim me Ligjin.

v) Pleqësia për shëndetësi **Neni 96.**

Pleqësia për shëndetësi shqyrton çështjet dhe propozimet nga lëmi i mbrojtjes primare të shëndetësisë, si dhe nga lëmi i zhvillimit dhe avancimit të shërbimeve shëndetsore në kuadër të kompetencës së

komunës dhe i propozon Kuvendit nxjerrjen e vendimeve dhe masave përkatëse për arsye të zbatimit të kujdesit shoqëror për shëndetsi, sigurimin e kushteve për kryerjen e veprimtarisë në institucionet shëndetsore, planifikimit dhe zbatimit të programeve në lëmin e shëndetësisë dhe ngritjen e vetëdijes për ate se shëndetsia është vlera kulminante.

Pleqësia për shëndetësi kryen edhe detyrat e caktuara nga lëmi i mbrojtjes së të drejtave të pacientëve, dhe atë:

- Shqyrton kundërshtimet për shkeljen e të drejtave të veçanta të pacientëve në bazë të dëshmimeve të dërguara dhe të grumbulluara dhe fakteve të vërtetuara;
- Për faktet e vërtetuara njofton paraqitësin e kundërshtimit dhe drejtorin e Entit të shëndetësisë, gjegjësisht themeluesin e praksës private të cilës kundërshtimi i drejtohet dhe jep sygjerrime përkatëse;
- Shqyrton raportet e mbrojtësit të të drejtave të pacientëve, përcjell realizimin e të drejtave të pacientëve në territorin e Komunës dhe ndërmerr masa për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pacientëve;
- I paraqet Kuvendit si dhe Ministrisë kompetente për punët e shëndetësisë, raportin vjetor për punën e vetë dhe për masat e ndërmarrura për mbrojtjen e të drejtëve të pacientëve.

Pleqësia ka kryetarin dhe 6 anëtarë.

Me aktin e formimit të Pleqësisë rregullohet përbërja, kompetenca, mënyra e punës, të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të Pleqësisë dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Pleqësisë, në pajtim me Ligjin.

g) Pleqësia për përcjelljen e zbatimit të kodit etik

Neni 97.

Pleqësia për përcjelljen e zbatimit të Kodit etik përcjell zbatimin e Kodit etik, sjelljen e funksionerëve të vetadministrimit lokal në Serbi, ofron sqarime dhe jep mendime lidhur me përmbajtjen e saj, përcjell se funksionerët e komunës a i përmbahen Kodit etik, analizon ngjarjet dhe dukuritë me rëndësi për zbatimin e suksesshëm të Kodit etik, promovon zbatimin e saj nëpërmes të mjeteve

të informimit publik dhe u jep sygjerime funksionerëve, qytetarëve dhe medijave.

Pleqësia për përcjelljen e zbatimit të Kodit etik jep këshilla dhe orientime lidhur me paraqitjen e interesit privat të këshilltarëve, udhëheq evidencën për paraqitjen e interesit privat, përcjell ekzekutimin e obligimeve të paraqitjes së interesit privat të këshilltarëve dhe për ate përpilon raportin.

Pleqësia ka kryetarin dhe 6 anëtarë.

Me aktin e formimit të Pleqësisë rregullohet përbërja, kompetenca, mënyra e punës, të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të Pleqësisë dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Pleqësisë, në pajtim me Ligjin.

d) Pleqësia shfrytëzuese e shërbimeve publike

Neni 98.

Pleqësia shfrytëzuese e shërbimeve publike shqyrton planet, programet dhe raportet e shërbimeve publike, e veçmas nivelin e vëllimit dhe kualitetit të shërbimeve publike, çmimin e shërbimeve komunale, gjegjësisht lartësin e kompenzimit për shërbimet e shërbimeve publike dhe për këtë qëndrim e raporton Kuvendin dhe opinionin.

Pleqësia shfrytëzuese ka kryetarin dhe 6 anëtarë.

Me aktin e formimit të Pleqësisë së shfrytëzimit rregullohet përbërja, kompetenca, mënyra e punës, të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të Pleqësisë së shfrytëzimit dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Pleqësisë, në pajtim me Ligjin

13. Trupat e përkohshëm punues

Neni 99.

Kuvendi sipas nevojës, në propozim të këshilltarëve, kryetarit të komunës ose Këshillit komunal, formon trupa të përkohshëm punues për arsye të shqyrtimit të çështjeve të caktuara, gjegjësisht për kryerjen e detyrave të caktuara nga kompetenca e Kuvendit, të cilat nuk i takojnë fushëveprimit të trupave të përhershëm punues, ndërsa mandati i tyre pushon me kryerjen e punëve dhe paraqitjen e raportit Kuvendit. .

Neni 100.

Kuvendi themelon trupat e përkohshëm punues me aktin me të cilin përcaktohet

emërtimi i trupit punues dhe lëmia për të cilën themelohet, detyrat e trupit punues, numri i përbërjes së anëtarëve të trupit punues, afati për kryerjen e detyrave, të drejtave dhe obligimeve të kryetarit dhe anëtarëve të trupit punues dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e trupit punues .

Me aktin e themelimit të trupit të përkohshëm punues rregullohen dhe kryhen punët profesionale dhe administrativo-teknike për atë trup punues.

Kryetari dhe anëtarët e trupit të përkohshëm punues zgjedhen nga rrada e këshilltarëve dhe qytetarëve, me shumicën e votave të këshilltarëve prezent.

Numri i anëtarëve të trupit të përkohshëm punues të cilt zgjedhen nga rrada e qytetarëve mund të jetë edhe më i madh nga numri i anëtarëve të zgjedhur nga rrada e këshilltarëve.

Në punën e trupit të përkohshëm punues njëkohësisht zbatohen edhe dispozitat e kësaj Rregulloreje mbi punën e trupave të përhershëm punues.

14. Këshilli anketues

Neni 101.

Kuvendi mund nga rrada e këshilltarëve të formon Këshillin anketues për arsye të shqyrtimit të gjendjes në lëmin e caktuar dhe përcaktimin e fakteve mbi dukuritë ose ngjarjet e veçanta.

Kuvendi në mënyrë të obligueshme formon Këshillin anketues nëse ate e kërkon më së paku 1/3 e këshilltarëve.

Me Vendimin mbi formimin e Këshillit anketues përcaktohen përbërja dhe detyrat e Këshillit.

Këshilli anketues nuk mund të kryej lëndët hulumtuese dhe lëndët tjera gjyqësore.

Këshilli ka të drejtë të kërkon nga organet shtetërore, ndërmarrjet, institucionet, organizatat dhe shërbimet, shënime, dokumente dhe njoftime, si dhe të merr deklarata nga individët të cilat i janë të nevojshme.

Përfaqësuesit e organeve shtetërore, ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave dhe shërbimeve si dhe qytetarëve, dërgojnë deklaratat e sakta , shënimet, dokumentet dhe njoftimet në punën e Këshillit anketues.

Pas kryerjes së punëve Këshilli anketues i paraqet Kuvendit raport për masat e propozuara. .

Këshilli anketues pushon me punë me ditën e vendosjes për raportin e vetë në seancën e Kuvendit.

VIII SEANCAT E KUVENDIT

15. Përgaditja dhe konvokimi i seancave

Neni 102.

Kuvendi punon dhe vendosë në seanca. Seancat e Kuvendit mund të jenë:
- të rregullta të cilat mbahen sipas nevojës, por të obligueshme janë njëherë në 3 muaj;

Neni 103.

Seancat e Kuvendit mbahen sipas rregullës ditëve të punës.

Seanca e rregullt e Kuvendit fillon në ora 10.00, ndërsa përfundon në ora 18.00.

Në propozim të Kryetarit të Kuvendit ose shefit të grupit të këshilltarëve, Kuvendi mund të zgjasë punën edhe pas orës 18.00.

Propozimi nga paragrafi.3 i këtij neni mund të paraqitet më së voni deri në orën 17.00 .

Në propozim për zgjatjen e seancës, Kuvendi deklarohet menjëherë pas paraqitjes së tij, ndërsa propozimi është i pranuar nëse për ate kanë votuar shumica nga këshilltarët prezent.

Neni 104.

Për përgaditjen e seancave të Kuvendit kujdeset kryetari i Kuvendit, me ndihmën e sekretarit të Kuvendit, i cili kujdeset për kryerjen e punëve profesionale lidhur me konvokimin dhe mbajtjen e seancave.

Para konvokimit të seancave të Kuvendit, kryetari i Kuvendit mund të thirrë mbledhje të përbashkët me shefat e grupeve të këshilltarëve për arsye të njoftimit dhe marrëveshjes për propozimin e rendit të ditës dhe punën në seancën e Kuvendit Në mbledhje mund të ftohen edhe këshilltarët të cilët nuk i takojnë asnjërit grup të këshilltarëve. .

16. Propozimi i rendit ditës

Neni 105.

Rendin e ditës së seancës e propozon kryetari i Kuvendit .

Propozimet që mund të rradhiten në rend ditë të seancës kryetarit të Kuvendit mund t'ia paraqet: Këshilli komunal, grupi i këshilltarëve, këshilltari, trupat punues të Kuvendit, si dhe propozuesit e autorizuar me Ligj, me Statut dhe vendimet e Kuvendit.

Në rend dite mund të rradhiten vetëm propozimet të cilat janë të hartuara në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe të cilat kryetarit të Kuvendit i janë dërguar më së voni 7 ditë para ditës së mbajtjes së seancës.

Nëse propozues janë grupi i këshilltarëve ose 1/3 e këshilltarëve, propozimi nuk përmbanë emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të propozuesit, do të nënkuptohet se përfaqësues i propozimit është shefi i grupit të këshilltarëve, gjegjësisht këshilltari i parë i nënshkruar.

Këshilli komunal si propozues, për arsyetimin e materialit të dërguar në seancë, mund të cakton më shumë përfaqësues të propozuesit.

Neni 106.

Materialet nga neni 105 i kësaj Rregulloreje, të cilat si propozime i dërgohen kryetarit të Kuvendit për arsye të rradhitjes në rend dite të seancës, i dërgohen me shkrim,në dy kopje me arsyetimin edhe në formë elektronike.

Propozimi i aktit të përgjithshëm dërgohet në formë në të cilën Kuvendi e miraton, me bazë ligjore nga kompetenca e Kuvendit dhe me arsyetim të përpiluar në pajtim me dispozitat e nenit 159 të kësaj Rregulloreje.

Propozimi i aktit të veçantë dorëzohet në formë në të cilën Kuvendi e miraton, me arsyetim.

Propozimet të cilat nuk kanë karakter të përgjithshëm, gjegjësisht akt të veçantë, si që janë sygjërimet, raportet, planet, programet dhe të ngjajshme, dorëzohen Kuvendit në formë në të cilën Kuvendi i shqyrton, me propozim aktet në formë në të cilën Kuvendi i pranon, i bjen, miraton ose jep pëlqim.

Neni 107.

Në propozimin e rendit të ditës të seancës së Kuvendit mund të rradhiten vetëm ato propozim akte të cilat janë të përgaditura në pajtim me Statutin dhe me këtë Rregullore.

Neni 108.

Kryetari i Kuvendit kujdeset që materiali i cili është rradhitur në propozimin e rendit të ditës së seancës si dhe materiali që është në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje të dërgohen si propozime për ndryshimin dhe plotësimin e propozimit të rendit të ditës, veçmas propozimit për plotësimin e rendit të ditës sipas procedurës urgjente të jenë të shqyrtuara në trupin kompetent punues të Kuvendit.

Neni 109.

Seancat e Kuvendit i konvokon Kryetari i Kuvendit sipas nevojës, e më së paku një herë në tre muaj.

Kryetari i Kuvendit është i obliguar që në kërkesë të 1/3 së këshilltarëve, Këshillit komunal ose kryetarit të komunës të konvokon seancën e Kuvendit dhe të cakton ditën dhe orën e mbajtjes së saj më së voni në afat prej 7 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës me shkrim, nëse me kërkesë materiali i dërguar është i përpiluar në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, ashtu që dita e mbajtjes së seancës të jetë më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Nëse Kryetari i Kuvendit nuk e konvokon seancën e Kuvendit në afat prej 48 orësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, i cili propozon rendin e ditës së seancës, ndërsa me seancë kryeson këshilltari të cilin e cakton paraqitësi i kërkesës.

Neni 110.

Kryetari i Kuvendit me shkrim cakton ditën dhe orën e mbajtjes së seancës së Kuvendit, me propozimin e rendit të ditës, më së paku 7 ditë para ditës për të cilën është konvokuar seanca.

Neni 111.

Në situatat të cilat arsyetojnë urgjencën në konvokimin e seancës së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit mund të konvokon seancën në afat i cili nuk është më i shkurtër se 24 orë nga dita e pranimit të kërkesës.

Kërkesa për konvokimin e seancës nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të përmbajë arsyet që e justifikojnë urgjencën e konvokimit, si dhe arsyetimin e pasojave të cilat mund të shkaktohen me moskonvokimin e saj.

Afati minimal për konvokimin e seancës së Kuvendit nga paragrafi 1. i këtij neni nuk mbështetet në konvokimin e seancës së Kuvendit në kushtet e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme.

17. Thirrja për seancë

Neni 112.

Seancat e Kuvendit konvokohen me shkrim ose në formë elektronike.

Thirrja për seancë përmbanë: vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës, propozimin e rendit të ditës, nënshkrimin e Kryetarit, gjegjësisht konvokuesit nga neni 109 i kësaj Rregulloreje dhe vulën e Kuvendit.

Thirrja dhe materiali për seancë në mënyrë të obligueshme i dërgohet të gjithë këshilltarëve, Kryetarit të Komunës, zëvendës kryetarit të Komunës, anëtarëve të Këshillit komunal, ndihmësve të kryetarit të komunës, mbrojtësit lokal (ombutstman) Kryeshefit të Administratës komunale, zëvendës kryeshefit të Administratës komunale, udhëheqësve të njërive të mbrendshme organizative të Administratës komunale dhe përfaqësuesve të mjeteve të informimit publik.

Neni 113.

Me thirrje për seancë këshilltarëve në mënyrë të obligueshme i dërgohet materiali që mbështetet në propozimin e rendit të ditës dhe ekstrakt nga procesverbali i seancës së mëparshme.

Materiali për seancë si dhe ekstrakti nga procesverbali nga mbledhja e mëparshme mund ti dërgohet këshilltarëve në formë elektronike, sipas marrëveshjes së mëparshme me shefat e grupeve të këshilltarëve ose me këshilltarët në veçanti.

Veçmas, në situatat që arsyetojnë urgjencën në konvokimin e seancës së Kuvendit, në pajtim me nenin 111 të kësaj Rregulloreje, materiali që mbështetet në propozimin e rendit të ditës dhe ekstrakti nga procesverbali nga seanca e mëparshme mund këshilltarëve ti dërgohet në seancën e Kuvendit, para vërtetimit të rendit të ditës së seancës, në ç'rast kryetari i Kuvendit është i obliguar të justifikon arsyet për veprim të tillë.

Materiali i cili për arsye teknike nuk mund në mënyrë ekonomike dhe të tërsishme të shumëzohet dhe dërgohet këshilltarëve me thirrjen për seancë (plani hapsinor, plani urbanistik me shënimet grafike, skicat dhe në

proporcion më të madh, studimet më voluminoze dhe raportet e të ngjajshme) veher në vështrim të Sekretari i Kuvendit më së voni 5 ditë para ditës së mbajtjes së seancës, e kur është e mundur në mënyrë teknike, ky material mundet të dërgohet këshilltarëve në formë elektronike.

18. Ndryshimet e propozimit të rendit të ditës

Neni 114.

Në propozimin e rendit të ditës së seancës së Kuvendit, propozuesit e autorizuar nga neni 105 paragrafi 2. i Rregullores, mund të propozojnë ndryshimet dhe plotësimet e rendit të ditës.

Propozimet i dërgohen Kryetarit të Kuvendit, me shkrim, drejt për së drejti në shkresoren e Administratës komunale.

Propozimet për plotësimin e rendit të ditës, propozimeve të materialit të cilat, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, i kanë plotësuar kushtet që të rradhitën në rend dite, dërgohen më së voni 72 orë para caktimit të orës së mbajtjes së seancës së Kuvendit, ndërsa propozimet që mbështeten në zgjedhjen, emërimin, shkarkimin dhe ndërprerjen e funksionit, bashkimin e diskutimit dhe ndryshimin e rradhitjes së pikave, dërgohen më së voni 24 orë para orës së caktuar të fillimit të seancës së Kuvendit.

Nëse propozues është grupi i këshilltarëve, gjegjësisht 1/3 e këshilltarëve, në propozim duhet të shënohet një përfaqësues i propozuesit. Nëse kjo nuk bëhet, nënkuptohet se përfaqësuesi i propozuesit është shefi i grupit të qytetarëve, gjegjësisht këshilltari i parë i nënshkruar.

Neni 115.

Propozimin për tërheqjen e ndonjëres pikës të rendit të ditës mund ta paraqet vetëm propozuesi i tij.

Propozimi për tërheqjen nga paragrafi 1. i këtij neni mund ti paraqitet me shkrim Kryetarit të Kuvendit ose me gojë në seancën e Kuvendit, deri në përfundimin e diskutimit për atë pikë të rendit të ditës.

Për propozimin për tërheqjen e ndonjëres pikë të rendit të ditës, Kuvendi deklarohet, ku kryetari i Kuvendit vetëm i njofton këshilltarët dhe konstaton tërheqjen.

Neni 116.

Mbi propozimet për ndryshimet dhe plotësimet e propozimit të rendit të ditës nuk hapet diskutim, por vetëm propozuesi mund ti arsyeton, për 3 minuta.

19. Hapja e seancës dhe pjesëmarrja në seancë

Neni 117.

Me seancën e Kuvendit kryeson Kryetari i Kuvendit, të cilin në rast të mungesës ose pengesës e zëvendëson zëvendës kryetari i Kuvendit.

Neni 118.

Nëse në seancën e konvokuar të Kuvendit nuk marrin pjesë Kryetari dhe zëvendës kryetari i Kuvendit ose kryetari dhe zëvendës kryetari i Kuvendit refuzojnë të kryesojnë seancën e konvokuar, me seancë do ta kryeson këshilltari më i vjetër i cili këtë detyrë e pranon.

Neni 119.

Në seancën e Kuvendit marrin pjesë personat e ftuar.

Përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve themelues i të cilëve është Komuna, ftohen në seancë kur shqyrtohen çështjet nga fushëveprimi i tyre.

Në seancë të Kuvendit mund të ftohen deputetët, Kryeshefi i rrethit administrativ, përfaqësuesit e organeve tjera shtetërore, përfaqësuesit e bashkësive fetare dhe personat tjerë për të cilat Kryetari i Kuvendit vlerëson se është e duhur prezenca e tyre ose pjesëmarrja në punën e seancës për pjesëmarrjen e të cilëve do të deklarohet Kuvendi.

Neni 120.

Në fillim të punës Kryetari i Kuvendit njofton Kuvendin për këshilltarët të cilët janë të penguar të marrin pjesë në seancën e Kuvendit, si dhe për atë kush është i ftuar në seancë.

Njëkohësisht Kryetari i Kuvendit jep njoftime të duhura lidhur me punën në seancë dhe çështjet tjera, nëse vlerëson se për atë ka nevojë.

20. Kuorumi

Neni 121.

Pas hapjesë së seancës, para mirtimit të rendit të ditës, Kryetari i Kuvendit, në bazë të raportit të Sekretarit të Kuvendit, vërteton se në seancë a është prezent numri i mjaftueshëm i këshilltarëve, gjegjësisht shumica nga gjysma e numrit të tërësishëm të këshilltarëve (në tekstin vijues: Kuorumi).

Kuorumi përcaktohet me numrin e këshilltarëve.

Nëse vërtetohet se në seancë nuk është prezent shumica e duhur e këshilltarëve për punën e Kuvendit, gjegjësisht nuk ka kuorum, kryetari i Kuvendit e shtyen fillimin e seancës deri sa kuorumi nuk sigurohet, e më shumti dy orë,

Nëse vërtetohet se edhe pas shtyerjes së seancës nuk është prezente shumica e duhur e këshilltarëve, kryetari e shtyen seancën për një ditë dhe orë përkatëse.

Neni 122.

Seanca mbahet, diskuton dhe vendosë në rast se në seancë janë prezent shumica nga numri i tërësishëm i këshilltarëve.

Nëse Kryetari i Kuvendit gjatë seancës para votimit dyshon se në seancë nuk janë prezent shumica e këshilltarëve, urdhëron thirrjen ose numërimin. Thirrja ose numërimi para votimit do të bëhet edhe kur kërkon ndonjëri nga këshilltarët. Thirrjen në seancë e bënë sekretari i Kuvendit.

21. Rrjedha e seancës

Neni 123.

Para miratimit të rendit të ditës miratohet procesverbali nga seanca e mëparshme e Kuvendit.

Mbi vërejtjet në procesverbal Kuvendi vendos pa diskutim.

Neni 124.

Kuvendi vendos veçmas për çdo propozim për ndryshimin dhe plotësimin e propozimit të rendit të ditës, me rradhitjen si vijon të propozimit:

- për procedurë urgjente;
- për ndryshimin e rendit të ditës;
- për plotësimin e rendit të ditës;
- për ndryshimin e rradhitjes së disa pikave;
- për bashkimin e diskutimit.

Neni 125.

Pikat e reja të cilat janë futur në rendin e ditës në bazë të propozimit për plotësimin e rendit të ditës, propozimit për bashkimin e diskutimit ose propozimit, për procedurë urgjente, inkorporohen në rendin e ditës sipas rradhitjes së propozimit, përveç se nëse propozuesi ose kryetari i Kuvendit ka propozuar rradhitjen tjetër të shqyrtimit, për të cilën Kuvendi deklarohej pa diskutim.

Neni 126.

Mbi rendin e ditës në tërësi Kuvendi vendos pa diskutim, me shumicën e votave të këshilltarëve prezent.

Kuvendi gjatë seancës në propozim të Kryetarit të Kuvendit, pa diskutim mund të vendosë mbi ndryshimin e rradhitjes së pikave të rendit të ditës.

22. Diskutimi

Neni 127.

Pas vendosjes mbi rendin e ditës në tërësi Kryetari i Kuvendit hap diskutimin sipas pikave të rendit të ditës së miratuar, përveç atyre për të cilat me këtë Rregullore, gjegjësisht me Vendim të posaçëm të Kuvendit, është rregulluar që për ato Kuvendi të vendos pa diskutim.

Neni 128.

Këshilltarët janë të obliguar të respektojnë dinjitetin e Kuvendit dhe dispozitat e kodit etik.

Këshilltarët janë të obliguar që njëri tjetrit ti drejtohen me entuziazëm.

Nuk është i lejuar shfrytëzimi i shprehjeve fyese, si dhe paraqitjen e fakteve dhe vlerësimeve që mbështeten në jetën private të personave tjerë.

Neni 129.

Askush nuk guxon ti afrohet foltores deri sa Kryetari i Kuvendit nuk e lejon.

Askush nuk mund të flasë në seancën e Kuvendit para se të kërkon dhe merr fjalën nga Kryetari i Kuvendit.

Neni 130.

Paraqitja për fjalë i bëhet Kryetarit posa të fillon diskutimi dhe mund ti paraqitet deri në përfundimin e diskutimit sipas pikës së rendit të ditës për të cilën folësi paraqitet, me gojë me shkrim.

Kryetari i Kuvendit ia jep fjalën folësit sipas radhitjes së paraqitjes, përveç Kryetarit të Komunës dhe zëvendës kryetarit të Komunës, të cilëve ia jep fjalën menjëherë posa e kërkojnë.

Neni 131.

Në seancën e Kuvendit ka të drejtë të flasë çdo këshilltarë, Kryetari i Komunës, zëvendës kryetari i Komunës dhe anëtari i Këshillit komunal si dhe udhëheqësi i organit të komunës, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Propozuesi, gjegjësisht përfaqësuesi i propozuesit ka të drejtë të flasë 5 minuta dhe ate 3 minuta menjëherë pas hapjes së diskutimit sipas pikës së rendit të ditës propozues i të cilit është, gjegjësisht përfaqësuesi i propozuesit, gjegjësisht paraqitësi, si dhe të jetë folësi i fundit para përfundimit të diskutimit për atë pikë, në kohëzgjatje prej 3 minutash.

Nëse propozuesi, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, cakton më shumë se një person për përfaqësues të propozuesit, koha për paraqitjen e tërësishme të tyre nuk mund të jetë më e gjatë nga koha e përcaktuar me paragrafi 2. të këtij neni.

Shefi i çdo grupi të këshilltarve, Kryetari i komunës, zëvend. Kryetari i komunës dhe anëtari i Këshillit komunal, ka të drejtë të flasë gjithësejt 10 minuta për çdo pikë të rendit të ditës.

Fjalimi i këshilltarit në diskutim sipas pikës së rendit të ditës mund të zgjasë deri në 5 min., ashtu që këshilltari për çështjen e njejtë mund të merr fjalën vetëm njëherë.

Kuvendi mund të vendosë që sipas çështjeve të caktuara të flasë përfaqësuesi i disa ndërmarrjeve, institucioneve dhe formave tjera të organizimit, si dhe ndonjë qytetarë më së shumti deri 5 min.

Veçmas, në propozim të Kryetarit të Kuvendit, Kuvendi mund të vendosë që kohëzgjatja e fjalimit të disa përfaqësuesve nga paragrafi 6. i këtij neni zgjatë edhe më shumë nga koha e caktuar.

Kryetari i Kuvendit në rast të tejkalimit të kohës së paraqitjes të përcaktuar me dispozitat e këtij neni do t'ia tërheq vërejtjen

folësit se koha ka kaluar, nëse ky gjatë minutave të ardhshme nuk e përfundon fjalimin, do ti merret fjala.

Neni 132.

Çdo çështje diskutohet deri sa për atë ka folës të paraqitur.

Diskusimin sipas pikës së caktuar të rendit të ditës e përfundon kryetari i Kuvendit, kur kryhet lista e folësve të paraqitur me paraqitjen e propozuesit, nëse propozuesi dëshiron atë te drejtë ta shfrytëzon.

Kur përfundohet diskutimi për çështjen e caktuar, nuk mund të hapet përsëri.

Neni 133.

Askush nuk mund ta ndërprej folësin e as t'ia tërheq vërejtjen, përveç Kryetarit të Kuvendit, në rastet e parapara me këtë Rregullore.

Kryetari i Kuvendit është i obliguar që të kujdeset që folësi të mos i jetë i penguar në diskutimin e vetë.

Në kohë të fjalimit këshilltari ose pjesëmarrësi tjetër në diskutim nuk është e lejuar që të ndërhyjë, gjegjësisht ti pengon folësit.

Folësi mund të flasë vetëm për çështjen që është në rend dite.

Nëse folësi largohet nga pika e rendit të ditës për të cilën zgjatë diskutimi ose prej definimit të shkeljes së Rregullores, kryetari do ta pengon.

Nëse këshilltari edhe pranë tërheqjes së vërejtjes vazhdon të flasë duke bërë shkelje nga al.5 i këtij neni, kryetari do t'ia merr fjalën.

Neni 134.

Kryetari i Kuvendit kur kryeson seancën e Kuvendit, nëse dëshiron të merr pjesë në diskutim, ja lejon udhëheqjen zëvendës Kryetarit të Kuvendit.

23. Replika

Neni 135.

Nëse folësi gjatë diskutimit në seancën e Kuvendit diskuton në mënyrë fyese për këshilltarin, gjegjësisht personin tjetër të ftuar në seancë, në bazë të racës, fejes nacionale ose gjinore ose në mënyrë tjetër fyen identitetin dhe dinjitetin e tij duke e përmendur emrin dhe mbiemrin ose funksionin, ose të flasë për gjërat që mbështeten në jetën e tij private ose

jetën private të anëtarëve të tij të familjes, këshilltari gjegjësisht personi tjetër i thirrur në të cilin diskutimi mbështetet ka të drejtë në replikë.

Nëse shprehjet fyese mbështeten në grupin e këshilltarëve, gjegjësisht partinë politike këshilltarët e të cilit e përbëjnë njëërën nga grupet e këshilltarëve, në emër të grupit të këshilltarëve të drejtë në replikë ka shefi i grupit të këshilltarëve.

Ekzistimin e bazës për replikë e vlerëson kryetari i Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit mund të shkruan të drejtën në replikë, nëse vlerëson se nuk plotësohen kushtet nga paragrafi 1. dhe 2 i këtij neni.

Nëse kryetari i Kuvendit vlerëson ekzistimin e bazës së replikës, personave nga paragrafi 1.dhe 2 të këtij neni ia jep fjalën posa ta kërkojnë fjalën.

Replika nuk mund të zgjasë më shumë se 3 min.

Nuk është e lejuar replika në replikë.

Neni 136.

Nëse këshilltari, shefi i grupit të këshilltarëve, gjegjësisht personi tjetër i thirrur gjatë shfrytëzimit të të drejtës në replikë, fyen këshilltarin, personin tjetër të thirrur ose grupin e këshilltarëve në mënyrë të përcaktuar me nenin 135 të kësaj Rregulloreje, Kryetari i Kuvendit do t’ia tërheq vërejtjen nëse pas tërheqjes së vërejtjes vazhdon me fyerje nga neni 135 të kësaj Rregulloreje, Kryetari i Kuvendit do t’ia merr fjalën.

24. Shkelja e Rregullores

Neni 137.

Këshilltarit i cili ka kërkuar të flasë për shkeljet e kësaj Rregulloreje, Kryetari ia jep fjalën kur e kërkon.

Këshilltari mund të paraqet në shkeljen e Rregullores në çdo moment edhe para hapjes së diskutimit.

Arsyetimi i shkeljes së kësaj Rregulloreje nuk mund të zgjatë më shumë se 3 min.

Këshilltari i cili kërkon të flasë për shkeljen e Rregullores është i obliguar që para arsyetimit të shkeljes, të paraqet nenin e kësaj Rregulloreje i cili sipas mendimit të tij është shkelur.

Nëse këshilltari para fillimit arsyetimit nuk e çekë nenin e kësaj Rregulloreje i cili sipas mendimit të tij është shkelur, Kryetari është i obliguar që t’ia tërheq vërejtjen.

Nëse edhe pas tërheqjes së vërejtjes këshilltari vazhdon të flasë duke bërë shkelje nga paragrafin 4. i këtij neni ose në mënyrë tjetër të dukshme të keqpërdorimit të drejtës në paraqitjen e shkeljes së Rregullores, Kryetari i Kuvendit do t’ia merr fjalën.

Kryetari i Kuvendit mund të jep sqarime me rastin e vërejtjes së paraqitur në shkeljen e Rregullores.

Nëse këshilltari nuk është i kënaqur me arsyetimin e dhënë, Kryetari i Kuvendit menjëherë fton këshilltarët të vendosin mbi shkeljen e paraqitur të nenit të çekur të kësaj Rregulloreje.

25. Shtyerja, ndërprerja dhe pauzat gjatë seancës.

Neni 138.

Kryetari i Kuvendit mund ta shtyjë seancën e Kuvendit kur e vërteton mungesën e shumicës së duhur të këshilltarëve për fillimin e seancës së Kuvendit, deri sa kuorumi nuk sigurohet, e më së shumti për 2 orë.

Nëse vërtetohet se edhe pas shtyerjes në rastin nga paragrafi 1. i këtij neni, në seancë nuk është prezente shumica e duhur e këshilltarëve, Kryetari i Kuvendit e shtyen seancën për ditën dhe orën përkatëse.

Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni Kryetari i Kuvendit do ti njofton këshilltarët dhe personat tjerë të cilët sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje janë të ftuar për fillimin e seancës e cila është shtyer, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 139.

Seanca e Kuvendit mund të shtyhet edhe sipas vëllimit të rendit të ditës ose për shkaqe tjera, nuk mund të kryhet diskutimi ose vendosja për të gjitha pikat e rendit të ditës, për ditën e konvokuar, në rastet që pamundësojnë punën e Kuvendit si dhe për shkaqe tjera të arsyeshme.

Në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni, Kryetari i Kuvendit ose shefi i grupit të këshilltarëve mund të propozojnë që seanca e Kuvendit të shtyhet.

Për shtyerjen e seancës së Kuvendit për rastin nga paragrafi 1. i këtij neni, Kuvendi vendos me shumicë votash të këshilltarëve

prezent, menjëherë pas paraqitjes së propozimit.

Neni 140.

Kryetari i Kuvendit cakton ndërprerjen e seancës së Kuvendit në rastet e shkaktimeve të ndonjë incidenti për ç’arsye Kuvendi nuk mund të vazhdon punën.

Për ditën dhe orën e vazhdimit të seancës së ndërprerë nga paragrafi 1. i këtij neni Kryetari i Kuvendit njofton këshilltarët menjëherë pas ndërprerjes së seancës ose rishtaz me shkrim.

Vazhdimi i seancës vazhdon me pikën e rendit të ditës të e cila është ndërprerë.

Neni 141.

Kryetari i Kuvendit mund të cakton pauzë në punën e Kuvendit dhe përcakton zgjatjen e pauzës.

Gjatë seancës së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit mund të cakton pauzën e seancës, jo më gjatë se 20 minuta, ashtu që të mund të mbajë mbledhjen e përbashkët me shëfat e grupeve të këshilltarëve për arsye të harmonizimit të qëndrimeve për pikat e caktuara të rendit të ditës si dhe për arsye të sigurimit të punës normale dhe vendosjes në Kuvend. Për rezultatet e harmonizimit Kryetari i Kuvendit në mënyrë të obligueshme i njofton këshilltarët në vazhdimin e seancës së Kuvendit.

Kuvendi mundet në propozim të Kryetarit të Kuvendit ose në propozim të shëfit të grupit të këshilltarëve, të vendos për pauzë, për të cilën vendos menjëherë pasi ta paraqet propozimin.

26. Mbajtja e rendit në seancë

Neni 142.

Për rendin në seancën e Kuvendit kujdeset Kryetari i Kuvendit. .

Kryetari i Kuvendit, për arsye të shkeljes së rendit në seancë, shqipton masën:

- me vërejtje dhe
- marrja e fjalës.

Kuvendi, në propozim të Kryetarit të Kuvendit, shqipton edhe masën e largimit nga seanca, me shumicë votash të këshilltarëve prezent.

Evidencën për shqiptimin e masave e udhëheq Sekretari i Kuvendit.

Neni 143.

Vërejtja i shqiptohet këshilltarit:

- i cili flet para se që ta kërkon dhe merr fjalën;
- i cili edhe pas paralajmërimit të Kryetarit të Kuvendit, flet për çështjen që nuk është në rend dite;
- nëse në çfarëdo mënyre pengon paraqitjen e këshilltarit ;
- nëse paraqet faktet dhe vlerësimet që mbështeten në jetën private të personave tjerë;
- nëse përdorë sharje dhe shprehje fyerse tjera ;
- nëse me veprimet tjera prishë rendin në seancë ose vepron në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 144.

Masa e marrjes së fjalës i shqiptohet këshilltarit të cilit më parë i është shqiptuar vërejtja, i cili edhe pas saj bënë shkeljen nga neni 143 i kësaj Rregulloreje .

Këshilltarit të cilit i është shqiptuar masa e marrjes së fjalës është i obliguar që, pa vonesë të largohet nga foltorja. Në të kundërtën Kryetari i Kuvendit urdhëron çkyqjen e zërimit, e sipas nevojës cakton ndërprerjen e seancës së Kuvendit.

Masa e marrjes së fjalës nuk mbështetet në të drejtën e këshilltarit në replikë në rrjedhën e mëtejme të seancës.

Neni 145.

Masa e largimit nga seanca i shqiptohet këshilltarit i cili edhe pas shqiptimit të masës të marrjes së fjalës ndërhyr ose pengon punën e seancës, nuk rrespekton vendimin e kryetarit të Kuvendit për shqiptimin e masës së marrjes së fjalës, ose vazhdon të bënë kundërvajtje tjera sipas nenit 143 të kësaj Rregulloreje, si dhe në raste tjera të caktuara me këtë Rregullore.

Masa e largimit nga seanca i shqiptohet këshilltarit edhe pa shqiptimin e mëparshëm të masës së vërejtjes dhe marrjes së fjalës, në rast të sulmit fizik, gjegjësisht veprimit tjetër të ngjashëm me të cilin rrezikohet integriteti fizik ose moral i pjesëmarrësve të seancës në sallën e Kuvendit.

Këshilltarit të cilit i është shqiptuar masa e largimit nga seanca është i obliguar që menjëherë të largohet nga salla në të cilën mbahet seanca e Kuvendit.

Nëse këshilltari refuzon të largohet nga salla në të cilën seanca e Kuvendit mbahet, kryetari i Kuvendit i urdhëron shërbimit të sigurimit fiziko-teknik të autorizuar për

mbajtjen e rendit në ndërtesë të cilën e shfrytëzojnë organet e komunës, që atë këshilltarë ta largon nga seanca dhe do të cakton ndërprerjen deri në ekzekutimin e masës së largimit.

Këshilltari të cilit i është shqiptuar masa e largimit nga seanca nuk ka të drejtë në kompenzimin e harxhimeve gjatë kryerjes së detyrës së këshilltarit nga neni 197 i kësaj Rregulloreje, për seancën në të cilën masa i është shqiptuar.

Neni 146.

Nëse Kryetari i Kuvendit me masa të rregullta nuk mund të mbanë rend në seancë, do të cakton ndërprerjen e seancës në kohë zgjatjen e duhur, që të vendoset rend.

Neni 147.

Masat e vërejtjes, marrja e fjalës dhe largimi nga seanca zbatohen për seancën e Kuvendit në të cilën janë shqiptuar.

Neni 148.

Në hapësirën në të cilën mbahet seanca e Kuvendit është e ndaluar të posedohet arma, shfrytëzimi i telefonave mobil dhe mjeteve tjera dhe lëndëve të cilat mund të pengojnë punën e Kuvendit.

Në seancë nuk i është e lejuar ardhja personave të cilët janë nën ndikimin e narkotikëve ose janë në gjendje të alkoolit.

27. Vendosja

Neni 149.

Pas përfundimit të diskutimit për pikën e caktuar të rendit të ditës, Kuvendi kalon në vendosje.

Neni 150.

Kuvendi vendimet i bjen me shumicë votash të këshilltarëve prezent, nëse me Ligj ose me Statut nuk është e rregulluar ndryshe.

Veçmas nga paragrafi 1. i këtij neni Kuvendi, me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve:

- 1) bjen Statutin;
- 2) bjen buxhetin dhe miraton llogarinë përfundimtare të buxhetit;
- 3) bjen Planin e zhvillimit të komunës dhe strategjinë me të cilën përcaktohen drejtimet e veprimit të komunës në lëmin e caktuar;
- 4) bjen Planin hapsinorë;
- 5) bjen Planin urbanistikë;
- 6) vendos për huamarrjen publike të komunës ;

7) vendos për bashkëpunimin dhe bashkimin me njësit tjera të vetadmindistritimit lokal dhe për bashkëpunimin me njësit e vetadmindistritimit lokal në shtetet tjera ;

8) vendos për arsimin, fushat për të cilën arsimohen, ndryshimin e territorit dhe ndërprerjen e Bashkësive lokale dhe formave tjera të vetadmindistritimit loka;

9) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, sheshet e qytetit, fshatrat dhe pjesët tjera të vendbanimeve;

10) cakton festat e Komunës;

11) vendos për ndarjen e titullit “Qytetar nderi” të Komunës;

12) miraton Kodin etik dhe

13) vendos edhe për raste tjera të përcaktuara me Ligj dhe me Statut

Neni 151.

Kuvendi vendos me votimin e këshilltarëve, në mënyrë, sipas procedurës dhe shumicës së përcaktuar me Ligj, me Statut, me vendimet e Kuvendit dhe me këtë Rregullore.

Votimi në seancën e Kuvendit është publik, përveç se kur me Ligj, me Statut ose me këtë Rregullore është rregulluar ndryshe. .

Këshilltarët votojnë me deklarinim “për” propozimit ose “kundër” propozimit ose janë të përmbajtur nga votimi.

Votimi bëhet me ngritjen e dorës.

Kryetari i Kuvendit së pari fton që të deklarohen këshilltarët të cilët votojnë “për”, pastaj ata që votojnë “kundër” e pastaj ata që janë të përmbajtur nga votimi.

Neni 152.

Në kërkesë të këshilltarëve ose grupit të këshilltarëve Kuvendi mund, pa diskutim të vendosë të votohet me thirrjen, në mënyrë të caktuara me këtë Rregullore.

Nëse Kuvendi vendos që të votohet me thirrje, Sekretari i Kuvendit thirr këshilltarët sipas listës së këshilltarëve, çdo këshilltarë i thirrur e thotë fjalën “për”, “kundër” ose “i përmbajtur”. Kryetari i Kuvendit përsërit emrin dhe mbiemrin e këshilltarit i cili ka votuar edhe deklaratën e tij, gjegjësisht vërteton se mungon ose nuk dëshiron të voton.

Sekretari i Kuvendit e shënon deklaratën e këshilltarit ose mungesën e tij, me emrin dhe mbiemrin e tij në listë.

Nëse Kuvendi vendos që të votohet me thirrje në procedurën e emërimit, gjegjësisht emërimi ku janë propozuar dy ose më shumë

kandidatë, këshilltarët të cilët kyçen në votim e shqiptojnë emrin dhe mbiemrin e plotë të kandidatit për të cilin votojnë.

Neni 153.

Pas votimit të kryer Kryetari i Kuvendit përfundon votimin dhe publikom rezultatet e votimit.

Vendimi nënkuptohet si i miratuar nëse për ate kanë votuar më shumë se gjysma e këshilltarëve prezent, gjegjësisht me Ligj, me Statut ose me Vendim të Kuvendit e përcaktuar shumica për miratimin e saj.

Neni 154.

Seancën e Kuvendit e përfundon Kryetari i Kuvendit pas zbatimit të vendosjes sipas rendit të ditës.

28. Proçesverbali

Neni 155.

Për punën në seancë të Kuvendit udhëhiqet proçesverbali.

Rrjedha e seancës së Kuvendit shënohet me proces të zërimit ose digjitalizimit dhe ruhet gjatë.

Për seanca përpilohet ekstrakt nga proçesverbali i cili i dërgohet këshilltarëve me ftesën për seancën e radhës.

Ekstrakti nga proçesverbali përmbanë gjithsesi: kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, emrin e Kryesuesit dhe Sekretarit, emrat e këshilltarëve që mungojnë me arsye dhe paarsye, rrjedha e shkurtër e seancës me shenjë e çështjeve për të cilat është diskutuar dhe vendosur dhe emrat e folësve, rezultatet e votimit veçmas për çështjet, emri dhe mbiemri i këshilltarëve që kanë ndarë mendimin (nëse këshilltari ka kërkuar që ti ndahet mendimi, duhet të shënohet në proçesverbal) dhe emërtimi i të gjitha akteve të miratuara në seancë.

Ekstraktin nga proçesverbali e nënshkruan Kryetari dhe Sekretari i Kuvendit.

IX PROCEDURA E MIRATIMIT TË VENDIMEVE DHE AKTEVE TJERA NË KUVEND

6. Aktet e Kuvendit dhe procedura e propozimit të akteve

Neni 156.

Kuvendi sjell Statutin si aktin me të lart juridik.

Kuvendi në kryerjen e punëve nga kompetenca e vetë miraton: vendimin, rregulloren, aktvendimin, konkluzionin, deklaratën, rezolutën, rekomandimin, planin, programin dhe aktet tjera në pajtim me Ligjin, Statutin dhe me këtë Rregullore.

Neni 157.

Me Vendim në mënyrë të përgjithshme rregullohen çështjet nga kompetenca e Kuvendit.

Me Rregullore rregullohen çështjet me rëndësi për organizimin dhe punën e Kuvendit.

Me Aktvendim vendoset për të drejtat e veçanta, obligimet dhe interesat juridike të personave në pajtim me Ligjin, Statutin dhe Vendimet e Kuvendit.

Me Konkluzion vendoset për çështjet procedurale, për pranimin e propozimeve të caktuara, përcaktohen qëndrimet për atë, çka, si dhe në ç'mënyrë duhet në të ardhmen të veprohet në çështjet e veçanta, gjegjësisht lëndët inicion nxjerrjen e vendimeve, gjegjësisht aktit tjetër të përgjithshëm ose të veçantë.

Neni 158.

Propozimin për nxjerrjen ose ndryshimin e Statutit të komunës mund ta paraqet më së paku 5% e qytetarëve me të drejtë vote në territorin e komunës, 1/3 e këshilltarëve, Kryetari i Komunës dhe trupi kompetent punues i Kuvendit.

Të drejtë për propozim të vendimeve dhe akteve tjera kanë Këshilli komunal, këshilltari, gjegjësisht grupi i këshilltarëve, trupat punues të Kuvendit si dhe propozuesit e autorizuar me Ligj dhe me Statut.

Neni 159.

Propozuesi i autorizuar i akteve nga neni 158 i kësaj Rregullore paraqet propozimin e akteve në formë në të cilën aktet bihen, me arsyetim.

Arsyetimi duhet të përmbajë analizën e bërë të efekteve të dispozitave, në çdo rast ajo duhet të përmbajë:

- bazën juridike;
- arsyet për nxjerrjen e akteve ;
- sqarimi i qëllimit i cili me nxjerrjen e aktit dëshiron të arrihet;

- sqarimi i institucioneve bazë juridike dhe arsyetimi i zgjidhjeve konkrete;
- vlerësimi i shumës së mjeteve financiare të duhura për zbatimin e aktit;
- pasqyra e dispozitave të vendimit të cilat ndryshojnë, gjegjësisht plotësohen, nëse propozohet vendimi mbi ndryshimin, gjegjësisht plotësimin.

Propozimi i aktit i cili është përcaktuar pas diskutimit të mbajtur publik në mënyrë të obligueshme përmban edhe raportin i cili përmban paraqitjen e të gjitha propozimeve dhe sygjërimeve të dhëna në diskutimin publik, me arsyetimin e shkakut për arsye të cilave propozimet e veçanta ose sygjërimet nuk janë pranuar.

Propozim akti nga paragrafi 3. i këtij neni shpallet në prezntimin zyrtar të internetit të komunës më së voni 8 ditë para shqyrtimit në seancën e Kuvendit.

Neni 160.

Propozimi i aktit i cili i është drejtuar Kuvendit, kryetari i Kuvendit menjëherë pas pranimit në mënyrë të obligueshme ia dërgon këshillave kompetente dhe Këshillit komunal, nëse Këshilli komunal nuk është propozues.

Nëse propozim akti nuk është përgaditur në pajtim me këtë Rregullore, kryetari i Kuvendit do të kërkon nga propozuesi që propozim aktin ta harmonizon me dispozitat e kësaj Rregulloreje me ç'rast në mënyrë precize do të shënon ku qëndron ai mos harmonizim.

Propozuesi i aktit mund në afat prej 15 ditësh të paraqet propozim aktin e harmonizuar me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Nëse propozuesi nuk harmonizon propozim aktin në pajtim me parag.1 dhe 2 të këtij neni, propozim akti nënkuptohet i tërhequr.

Neni 161.

Kryetari i Kuvendit në bazë të raportit të sekretarit të Kuvendit për materialet e arritura, vendos në cilën seancë materialet, gjegjësisht aktet do ti drejtohen dhe dërgohen kryetarit të Kuvendit në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, radhitë në propozim të rendit të ditës së seancës, përveç se kur bëhet fjalë për propozimet për të cilat me këtë Rregullore është përcaktuar se duhet të radhitet në propozimin e rendit të ditës së seancës së parë vijuese.

Neni 162.

Propozim aktin, para shqyrtimit në Kuvend, në mënyrë të domosdoshme e shqyrtojnë këshillat kompetente dhe Këshilli komunal, nëse Këshilli komunal nuk është propozues i akteve.

Këshillat kompetente dhe Këshilli komunal nëse nuk është propozues i aktit, në raportet e veta, mund ti propozojnë Kuvendit të pranon ose mospranon propozimin e aktit.

Nëse këshilli kompetent dhe Këshilli komunal propozojnë pranimin e aktit, janë të obliguar të cekin se aktin a e pranojnë në tërësi ose me ndryshime të cilat i propozojnë në formë të amendmanit.

7. Amendamenti

Neni 163.

Amendamenti- propozimi për ndryshimin e nenit të propozimit të aktit të përgjithshëm, mund ta paraqes Këshilli komunal, grupi i këshilltarëve, këshilltari dhe trupat punues të Kuvendit.

Amendamenti përmbanë emërtimin e propozim aktit në të cilin amendamenti mbështetet, tekstin e plotë të ndryshimit, arsyetimin me arsyet për paraqitjen e amendamentit dhe emërtimin e paraqitësit të amendamentit.

Propozimi për ndryshimin e anëtarit të propozimit të aktit të përgjithshëm me të cilën përmirësohen gabimet e dukshme gjegjësisht të shtypura në të cilat gjatë seancës së Kuvendit i paraqet këshilltari ose trupi kompetent punues i Kuvendit , nuk paraqitet në formë të amendamentit dhe propozuesi i aktit mundet menjëherë ta pranoj në ç'rast bëhet pjesë përbërse e aktit të përgjithshëm.

Neni 164.

Amendamenti i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim, me arsyetimin, duke filluar nga dita e dërgesës së propozim aktit, e më së voni 48 orë para caktimit të mbajtjes së seancës për të cilën është propozuar shqyrtimi i këtij akti të propozuar.

Paraqitësi i amendamentit nuk mundet që vetë ose së bashku me këshilltarët tjerë të paraqet më shumë amendamente në nenin e njëjtë të propozim aktit.

Neni 165.

Amendamentet e paraqitura Kryetari i Kuvendit ia dërgon propozuesit të aktit,

këshillave kompetente dhe Këshillit komunal nëse ai nuk është propozues i aktit.

Amandamentet të cilat Këshilli për dispozita dhe Administratë i refuzon si jo me kohë, jo të plota, në kundërshtim me Ligjin, fyese ose të drejtuara në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Për amandmanet nga paragrafi 2. i këtij neni Këshilli përpilon raportin e veçantë dhe ia dërgon Kuvendit.

Neni 166.

Propozuesi i akteve, këshilli kompetent dhe Këshilli komunal, janë të obliguar që para seancës së Kuvendit, të shqyrtojnë amandamentet të cilat janë dërguar në propozim aktet dhe se Kuvendin ta njoftojnë për cilat amandane i propozojnë që Kuvendi ti miraton, e për të cilat ti refuzon.

Neni 167.

Amandamentet me të cilat pajtohet propozuesi i akteve bëhet pjesë përbërse e propozim aktit dhe për këtë Kuvendi nuk deklarohet veçmas.

Nëse propozuesi i aktit paraqet amandamentin në aktin propozues i të cilit është, amandamenti bëhet pjesë përbërse e propozim aktit dhe për këtë Kuvendi nuk deklarohet veçmas.

Neni 168.

Për amandamentin e paraqitur hapet diskutimi.

Paraqitja për amandamentin e paraqitur nuk mund të zgjatë më shumë se 3 min.

Neni 169.

Kuvendi vendosë për amandamentet e paraqitura sipas rradhitjes së anëtarëve të propozimit të aktit të përgjithshëm.

Nëse janë paraqitur më shumë amandamente në nenin e njejtë të propozim aktit, së pari vendoset për amandamentin me të cilin propozohet shlyerja e dispozitave të atij neni, e pastaj për amandamentin me të cilin propozohet ndryshimi i nenit në tërësi.

Për amandamentet këshilltarët votojnë “për”, “kundër” ose janë të përmbajtur nga votimi.

Për amandamentet në aktin vendoset me shumicën e njejtë të votave që është e duhur për nxjerrjen e akteve.

8. Nxjerrja e akteve sipas procedurës urgjente

Neni 170.

Akti veçmas mund të miratohet edhe sipas procedurës urgjente.

Nëse për miratimin e ndonjërit akt ekziston nevoja e pashtyer ose nëse mos miratimi i aktit të tillë në afatin e caktuar do të ketë ose do të kishte pasoja të dëmshme në interes të qytetarëve ose personave juridik, gjegjësisht për kryerjen e punëve nga kompetenca e komunës, propozim akti mund ti paraqitet Kuvendit në shqyrtim dhe vendosje pa shqyrtimin e mëparshëm në trupat punues të Kuvendit.

Propozuesi i aktit është i obliguar që me shkrim arsyeton propozim aktin të shënon arsyet ose pasojat të cilat do të shkaktohen për arsye të mos miratimit të këtij akti sipas procedurës urgjente.

Neni 171.

Propozim akti për miratimin e të cilës propozohet procedura urgjente mund të vëhet në rend ditë të seancës së Kuvendit nëse është paraqitë më së voni deri në përcaktimin e rendit të ditës të asaj seance.

Neni 172.

Propozimin që akti të bihet sipas procedurës urgjente Kuvendit mund t’ia paraqet Këshilli komunal ose 1/3 e këshilltarëve.

Propozimi i paraqitet kryetarit të Kuvendit me shkrim, me arsyetim. Kuvendi menjëherë deklarohet për ate a e pranon propozimin.

Nëse Kuvendi pranon propozimin që akti të bihet sipas procedurës urgjente, ai propozim bëhet pika e parë e rendit të ditës.

Propozimi i aktit që është lëndë e shqyrtimit, diskutimit dhe vendosjes në seancën e Kuvendit të konvokuar sipas procedurës urgjente, nuk e shqyrtojnë këshillat kompetente.

Neni 173.

Për propozim aktin veçmas deklarohet Këshilli komunal, me shkrim ose me gojë, nëse ai nuk është propozues i aktit.

Amandamenti në propozim aktin i cili bihet sipas procedurës urgjente mund të jetë dhënë me shkrim ose me gojë deri në

përfundimin e diskutimit sipas asaj pike të rendit të ditës.

Për amandamentin nga paragrafi 3. i këtij neni Kuvendi vendos pa deklarinimin e këshillit kompetent.

9. Procedura për nxjerrjen e akteve të veçanta sipas procedurës së shkurtër

Neni 174.

Në procedurë të shkurtër Kuvendi vendos pa diskutimin e mëparshëm.

Neni 175.

Në procedurën e shkurtër Kuvendi mund të vendos për aktet e veçanta.

Vendosja sipas procedurës së shkurtër mund të zbatohet vetëm nëse propozimet nga al.1 i këtij neni janë në propozimin e rendit të ditës se seancës së Kuvendit veçmas të grumbulluara dhe të shënuara si “propozimet për të cilat vendoset sipas procedurës së shkurtër”.

Neni 176.

Në materialin i cili i është dërguar këshilltarëve me ftesën për seancë, duhet në formën e paraparë ti dërgohet propozim akti për të cilën vendoset sipas procedurës së shkurtër dhe arsyetimi i propozimit.

10. Hartimi, nënshkrimi dhe shpallja e akteve

Neni 177.

Aktet e Kuvendit hartohen në bazë të procesverbalit origjinal të séances së kuvendit në të cilën janë nxjerrë.

Aktet e Kuvendit i nënshkruan Kryetari i Kuvendit.

Origjinalin e aktit të dërguar për nënshkrim Kryetarit të Kuvendit me nënshkrim të vetin më parë e vërteton Sekretari i Kuvendit. Në bazë të origjinalit të aktit përpilohen aktet e dërguara të cilat njëkohësisht kanë përmbajtje si akti origjinal.

Për hartimin e aktit origjinal dhe dërgesën e tyre, për ruajtjen e akteve origjinale dhe evidencën e tyre, shpalljen e akteve të Kuvendit dhe dërgesën e tyre organeve dhe organizatave të interesuara kujdeset njësia organizative e Administratës komunale kompetente për punët e Kuvendit.

Aktet e Kuvendit shpallen në “Gazetën zyrtare të komunës së Bujanocit” dhe në “Gazetën zyrtare të komunës së Preshevës”, e në pajtim me Vendimin e veçantë të Kuvendit.

X SEANCA SOLEMNE

Neni 178.

Seancën solemne të Kuvendit e konvokon Kryetari i Kuvendit me rastin e shpalljes së “Qytetar nderi”, në ditën e festës së komunës.

Seanca e Kuvendit e konvokuar me rastin e shpalljes së “Qytetar nderi”, është me karakter solemn dhe protokolar.

Seanca solemne e Kuvendit mbahet në sallën e Kuvendit ose në vend tjetër të përshtatshëm e cila i përgjigjet solemnitetit me rastin e mbajtjes së saj.

Neni 179.

Seancën solemne të Kuvendit e konvokon Kryetari i Kuvendit me ftesë solemne.

Ftesa solemne përmbanë programin e solemnitetit me rastin e shënimit të festës të komunës dhe në të është e obligueshme të ceket dita dhe ora e mbajtjes së seancës, gjegjësisht salla në të cilën salla do të mbahet.

Në seancën solemne të Kuvendit ndahen mirënjohjet dhe shpërblimet e Komunës. .

Neni 180.

Për mbajtjen e seancës solemne të Kuvendit nuk është e duhur prezenca e shumicës nga numri i tërsishëm i këshilltarëve.

Në seancën solemne Kuvendi nuk hap diskutim.

Në seancën solemne të Kuvendit në mënyrë të obligueshme ftohen fituesit e mirënjohjeve të qytetarit të nderit dhe meritot.

Në seancën solemne të Kuvendit, pranë Kryetarit të Kuvendit, gjegjësisht Kryetarit të Komunës i cili ndan mirënjohjet dhe shpërblimet, mund të flasin laureatët, gjegjësisht fituesit e mirënjohjeve dhe shpërblimeve për vitin në të cilin mirënjohjet dhe shpërblimet i ndahen, si dhe mysafirët e mirënjohur të cilët dëshirojnë ti drejtohen këshilltarëve dhe mysafirëve të ftuar.

XI PUNA E KUVENDIT NË RAST TË RREZIKUT TË DREJTPËRDREJTË TË LUFTËS, GJENDJES SË LUFTËS OSE GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 181.

Në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme Kuvendi punon sipas kësaj Rregulloreje, nëse rastet dhe rrethanat konkrete e lejojnë.

Nëse në kushtet e cekura nuk është e mundur puna sipas kësaj Rregulloreje, Kuvendi në seancën e parë bjen Rregulloren e posaçme për punën e vetë dhe realizimin e funksionit në rrethanat e shkaktuara.

Neni 182.

Kryetari i Kuvendit në rast rrezikut të drejtpërdrejtë të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme:

- cakton kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës së Kuvendit;
- vendos për mënyrën e thirrjes së këshilltarëve në seancë dhe për mënyrën dhe afatet e dërgesës së materialit për seancë;
- sipas nevojës mund të cakton mënyrën e veçantë të udhëheqjes dhe ruajtjes së procesverbalit, shënimeve dhe dokumenteve tjera të Kuvendit dhe organeve të tij, të urdhëron që materiali i caktuar mos ti vëhet në disponim mjeteve të informimit publik dhe të ndërmerr masa tjera me qëllim të sigurisë dhe mbrojtjes;
- krijon kontakte dhe bashkëpunim me organet përkatëse shtetërore dhe ushtarake të Republikës së Serbisë dhe ndërmerr masa për realizimin e Ligjeve, vendimeve, konkluzioneve, urdhëresave të nxjerrura dhe akteve tjera të këtyre organeve;
- vendos për mënyrën e punës së Administratës komunale me qëllim të realizimit sa më të suksesshme në rrethanat e krijuara .

Neni 183.

Këshilltarët janë të obliguar që në rastet e rrezikut të drejtpërdrejtë të luftës, gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme njoftojnë Sekretarin e Kuvendit për çdo ndryshim të adresës, vendbanimit ose vendqëndrimit.

Neni 184.

Në rast të gjendjes së luftës Këshilli komunal bjen aktin nga kompetenca e Kuvendit, ashtu që është i obliguar që ti paraqet në vërtetim Kuvendit, kur ajo ka mundësi që të takohet.

XII PUNA PUBLIKE E KUVENDIT DHE TRUPAVE PUNUES TË KUVENDIT

Neni 185.

Seancat e Kuvendit janë publike.

Për punën publike të Kuvendit është përgjegjës Kryetari i Kuvendit.

Seancat e Kuvendit janë të hapura për opinion dhe në mënyrë direkte transmetohen me anë të TV transmetimeve.

Në rast të pengesave teknike nga transmetimi direkt në TV Kryetari i Kuvendit do të cakton pauzën e shkurtër në kohëzgjatje prej 15 minutash.

Nëse edhe pas skadimit të afatit nga paragrafi 3. i këtij neni nuk mënjanohe pengesat teknike, seanca do të vazhdon me transmetimin direkt të radios.

Neni 186.

Seanca e Kuvendit mund të jetë në tërësi ose pjesërisht e mbyllur për opinion, për arsye të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit dhe rastet tjera të parapara me Ligj.

Propozimi i arsyetuar për mbylljen e opinionit mund ta jep kryetari i Kuvendit, Këshilli komunal ose më së paku 1/3 e këshilltarëve dhe për ate votohet pa diskutim.

Vendimi për ç'kyqjen e opinionit është nxjerrë nëse për ate është deklaruar shumica nga numri i tërësishëm i këshilltarëve.

Në seancën e Kuvendit e cila është e mbyllur për opinionin mund të marrin pjesë vetëm këshilltarët, Kryetari i Komunës dhe personat profesional të cilët ndihmojnë në punën e seancës së Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit është i obliguar që personat nga paragrafi 4. i këtij neni ti paralajmëron në obligimin ta ruajnë si mfsheftësi për ate që janë njoftuar gjatë seancës e cila është e mbyllur për opinion.

Kuvendi mund të vendos të paraqet raport të shkurtër për punën për seancën e cila nuk është publike.

Neni 187.

Në seancë mund të marrin pjesë edhe qytetarët e interesuar, gjegjësisht përfaqësuesit e ndërmarrjeve, institucioneve dhe shërbimeve tjera publike themelues i të cilëve është Komuna, Bashkësi lokale, Shoqatave e të ngjajshme, të cilët prezencën e tyre e paralajmërojnë në njësinë organizative të Administratës komunale kompetente për punët e Kuvendit, më së voni 48 orë para mbajtjes së seancës, përveçse kur seanca mbahet pa prezencën e opinionit.

Në rastin se nuk ekzistojnë mundësit teknike ose për ate duhet hapsirë që të gjithë të interesuarit marrin pjesë në seancën e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit mund, me qëllim të sigurimit të rrjedhës së papengueshme të seancës të kufizon numrin e tërësishëm të qytetarëve dhe të vendosë kujt do ti mundëson të merr pjesë në seancë, duke u nisur nga rradhitja e paraqitjes dhe interesit të të paraqiturve për pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht do ti fton qytetarët tjerë të paraqitur dhe përfaqësuesit e shoqatave që propozimet dhe komentet e tyre ti dërgojnë me shkrim, të cilat Kryetari i Kuvendit do t'ia dërgon këshilltarëve më së voni deri në fillimin e seancës.

Qytetarit të cilit i mundësohet të merr pjesë në seancën e Kuvendit, obligohet që në hyrje të sallës për seanca personit të autorizuar t'ia tregon lejen e njoftimit për arsye të identifikimit dhe shënimit në evidencë të pranishmit në seancë.

Neni 188.

Përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik kanë të drejtë të marrin pjesë në seancat e Kuvendit dhe trupave të tij punues për arsye të njoftimit të opinionit për punën e tyre.

Përfaqësuesve të mjeteve të informimit publik i jepen në disponim propozim vendimet, dispozitat dhe aktet tjera të përgjithshme, si dhe materialet informative dhe dokumentacioni për çështjet nga puna e Kuvendit dhe trupave të tij punues.

Përfaqësuesve të mjeteve të informimit i sigurohen kushtet e duhura teknike për përcjelljen e punës në seancat e Kuvendit dhe trupave të tij punues.

Neni 189.

Kuvendi mund të paraqet njoftim zyrtar për mjetet e informimit publik.

Konferencë për shtyp, lidhur me çështjet të cilat i shqyrton Kuvendi, mund ta mbajë Kryetari i Kuvendit, zëvendës kryetari i Kuvendit, grupi i këshilltarëve ose këshilltari të cilin e autorizon Kuvendi, ndërsa kryetari i trupit punues të Kuvendit për çështjet nga kompetenca e atij trupi punues.

Neni 190.

Me qëllim të njohtimit të opinionit për punën e Kuvendit dhe trupave të tij punues, në prezantimin zyrtar të internetit të komunës shpallen :

- informatori për punën e Kuvendit;
- njohtimi për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës së Kuvendit, me propozimin e rendit të ditës;
- vendimet dhe aktet tjera të nxjerrura në seancën e Kuvendit ;
- projekt vendimet dhe aktet tjera për të cilat mbahet diskutimi publik, me njohtimin për kohën dhe vendin e mbajtjes së diskutimit publik;
- "Gazeta zyrtare e Komunës së Bujanocit" në formë elektronike;
- propozim aktet si dhe aktet e nxjerrura nga ana e Kuvendit , për të cilat opinionit është veçmas i interesuar.

Për shpalljen e akteve nga al.1 i këtij neni do të kujdeset sekretari i Kuvendit.

XIII TË DREJTAT DHE DETYRAT E KËSHILLTARËVE TË KUVENDIT

6. Të drejtat dhe detyrat e këshilltarëve

Neni 191.

E drejt dhe detyrë e këshilltarit është që të zgjedh dhe të jetë i zgjedhur në funksionet në Kuvend, organet e komunës dhe trupat punues të Kuvendit, të merr pjesë në punën e Kuvendit dhe trupat punues ku është anëtar, paraqet amandamente në propozim të aktit të përgjithshëm, kërkon informata dhe shënime që i nevoiten për realizimin e funksionit të këshilltarit dhe të merr pjesë në aktivitetet tjera të Kuvendit.

Këshilltari është i obliguar të merr pjesë në seancat e Kuvendit dhe mbledhjet e trupave punues të Kuvendit ku është i zgjedhur.

Në rast të pengesës së arsyeshme të merr pjesë në seancë, këshilltari është i

obliguar që me kohë të paraqet mungesën e tij sekretarit të Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit gjegjësisht kryetari i trupit punues të Kuvendit mund ti lejon këshilltarit mungesën në seancë, për çka i njohton të pranishmit në seancë.

Në rast të veprimit në të kundërtën e paragrafi 2. të këtij neni këshilltari nuk ka të drejtë në kompenzim nga neni 197 i kësaj Rregulloreje.

Neni 192.

Këshilltari është i obliguar që menjëherë pas njoftimit, e më së voni ditën e parë të rradhës të ditës punuese, Pleqësisë për përcjelljen e zbatimit të kodit etik me shkrim ta paraqet ekzistimin e interesit privat, në bazë të Ligjit me të cilin rregullohet pengesa e konflikt interesit gjatë kryerjes së funksionit publik, në bazë të lëndës së propozim vendimit ose aktit tjetër të përgjithshëm për të cilën do të diskutohet dhe për ate ta njohton opinionin.

Nënkupetohet interes privat i këshilltarit se nuk ekziston nëse është fjala për propozim vendimin ose aktin tjetër të përgjithshëm që mbështetet për të gjithë qytetarët në territorin e komunës.

Neni 193.

Këshilltari nuk mund të jetë i ftuar në përgjegjësi penale, i ndaluar ose i denuar për arsye të mendimit të paraqitur ose dhënjes së votës në seancën e Kuvendit ose trupin punues.

Neni 194.

Këshilltari ka të drejtë ti propozon Kuvendit diskutimin për çështjet e caktuara.

Këshilltari ka të drejtë të jetë i njohtuar për të gjitha çështjet njohtimi i të cilave i është i duhur për arsye të kryerjes së funksionit të këshilltarit.

Këshilltari ka të drejtë që me rregull ti dërgohen publikimet zyrtare, materialet informative dhe materialet e dokumentacionit për çështjet që janë në rend dite të Kuvendit si dhe për çështjet tjera nga fushëveprimi i Kuvendit.

Këshilltari ka të drejtë që prej kryetarit të Kuvendit, kryetarit të trupave punues të përhershëm të Kuvendit, funksionerëve tjerë të Kuvendit dhe kryeshefit të Administratës komunale kërkon shënime, njoftime dhe sqarime për çështjet të cilat mbështeten në punët nga korniza e të drejtave dhe detyrave të

tyre, e të cilat i nevoiten për kryerjen e funksionit të këshilltarit.

Për dërgesën me kohë të njoftimeve, shënimeve të kërkuara, lëndëve dhe udhëzimeve përgjegjës është sekretari i Kuvendit të komunës, ndërsa kryeshefi i Administratës komunale kur njoftimet, shënimet e kërkuara, lëndët dhe udhëzimet mbështeten në fushëveprimin dhe punën e Administratës komunale.

7. Pyetjet e këshilltarëve

Neni 195.

Këshilltari ka të drejtë të paraqet pyetjen e këshilltarit në fund të seancës, pas përfundimit të gjitha pikave të rendit të ditës, ashtu që është i obliguar që pyetjen t’ia dërgoj drejtpërdrejtë Kryetarit të Kuvendit me shkrim.

Pyetjet e këshilltarëve duhet të jenë të formuluar në mënyrë të qartë. .

Personave të cilëve i janë drejtuar pyetjet e këshilltarëve duhet këshilltarit ti përgjigjen.

Sqarimet, njoftimet dhe përgjigjet në pyetjet e parashtruara të këshilltarëve jepen, nëse është e mundur në seancën e njejtë, nëse nuk është e mundur në seancën e parë të rradhës.

Kur përgjigja në pyetjen e këshilltarit nuk jepet në seancën e njejtë në të cilën është parashtruar pyetja, përgjigja, sipas rregullës i jepet me shkrim këshilltarit i cili ka parashtruar pyetjen e këshilltarëve, më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së seancës në të cilën pyetja është parashtruar.

Veçmas, nëse në përgaditjen e përgjigjes nga paragrafi 3. i këtij neni është e duhur që të vërtetohen faktet e caktuara, vërtetimi i të cilës kërkon kohë më të gjatë ose analizë më të thukët, afati për dhënjën e përgjigjes në pyetjen e këshilltarëve mund të zgjatet, por jo më shumë se 30 ditë.

Në kërkesë të këshilltarit i cili ka parashtruar pyetjen, përgjigja i dërgohet të gjithë këshilltarëve.

Përgjigja në pyetjen e këshilltarit duhet të jetë e shkurtër, e qartë dhe direkte dhe sipas rregullës duhet të përmbajë propozimet për zgjidhjen e problemeve në të cilën pyetja mbështetet.

Nëse këshilltari nuk është i kënaqur me përgjigjen, mund ti propozon Kuvendit që personit të cilit i është parashtruar pyetja ftohet

në sencën e radhës së Kuvendit, e mund të kërkojë që për përgjigje të hapet diskutimi në njërën nga seancat e radhës së Kuvendit, për propozimin e këshilltarit Kuvendi deklarohet pa diskutim.

Neni 196.

Administrata komunale siguron në kuadër të detyrave të veta kushtet për kryerjen e funksionit të këshilltarit dhe në kërkesat e tyre, sipas urdhëresës së Kryeshefit:

- ju ofron ndihmë profesionale dhe administrativo-teknike në përpilimin e propozimit të cilën ata ia paraqesin Kuvendit dhe trupave punues të Kuvendit;
- i siguron shfrytëzimin e “Gazetës zyrtare të Komunës së Bujanocit” dhe gazetat tjera ku janë shpallur aktet e Kuvendit të komunës Preshevë, si dhe dokumentacionin shtesë për çështjet e posaçme të cilat janë në rend dite të Kuvendit ose trupave të tij punues;
- Kujdeset për sigurimin e kushteve për punën e grupit të këshilltarëve, në pajtim me mundësit hapsinore.

8. Kompenzimi i shpenzimeve këshilltarëve

Neni 197.

Këshilltari ka të drejtë në kompenzim të shpenzimeve të bëra me kryerjen e detyrës së këshilltarit në rastet edhe në lartësin e përcaktuar me Vendim të posaçëm të Kuvendit.

9. Legjitimiteti i këshilltarëve

Neni 198.

Këshilltarit, pas kryerjes së verifikimit të mandatit, i jepet legjitimacioni i këshilltarit, në afat prej 15 ditësh nga dita e kompletimit të dokumentacionit. Legjitimacionin e këshilltarit e nënshkruan Kryetari i Kuvendit.

Këshilli për çështjet administrativo-mandatore parasheh përmbajtjen, formën dhe mënyrën e dhënjes së legjitimacionit dhe udhëheqjen e evidencës së legjitimacioneve të dhëna.

10. Ndërprerja e mandatit të këshilltarit

Члан 199.

Këshilltarit i ndërprehet mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhë:

9. paraqitja e dorëheqjes;
10. nxjerrja e Vendimit mbi shpartallimin e Kuvendit;
11. nëse me Vendim të plotëfuqishëm gjyqësor është i denuar në dënim pa kusht me burg në kohëzgjatje prej më së paku gjashtë muaj;
12. nëse me Vendim të plotëfuqishëm është i privuar nga aftësia e biznesit;
13. me marrjen e funksionit, gjegjësisht funksionit që janë në pajtim me Ligjin, të papërputhshme me funksionin e këshilltarit ;
14. nëse i ndërprehet vendbanimi në territorin e komunës;
15. me humbjen e shtetësisë dhe
16. nëse ndodhë vdekja e këshilltarit.

Neni 200.

Këshilltari mund të paraqet dorëheqje në funksionin e këshilltarit.

Këshilltari mund të paraqet dorëheqje me gojë në sencën e Kuvendit, ndërsa në mes të dy seancave e paraqet me shkrim dhe të vërtetuar deklaratën.

Pas paraqitjes së dorëheqjes me gojë të këshilltarit, Kuvendi pa shtyerje në sencën e njejtë verifikon se këshilltarit i pushon mandati.

Për dorëheqjen të cilën këshilltari e ka paraqitur në mes të dy seancave, Kuvendi është i obliguar të vendosë në sencën e parë të rradhës.

Këshilltari mund të revokoj dorëheqjen e paraqitur deri sa Kuvendi nuk e verifikon ndërprerjen e mandatit të tij.

Nëse këshilltarit i pushon mandati me paraqitjen e rastit nga neni 199 pikat 2 deri 8, Kuvendi në sencën e parë të rradhës, pas njoftimit për paraqitjen e rastit të tillë, verifikon se këshilltarit i pushon mandati.

Kur këshilltarit i pushon mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhë, mandati i këshilltarit të ri i verifikohet në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

MIRATIMI, NDRYSHIMI DHE ZBATIMI I RREGULLORES

Neni 201.

Këshilltari personalisht e paraqet dorëheqjen të vërtetuar nga organi kompetent për vërtetimin e nënshkrimeve, Kryetari të Kuvendit në afat prej 3 ditësh nga dita e vërtetimit.

Kryetari i Kuvendit është i obliguar që dorëheqjen e paraqitur ta ven në rend dite të Kuvendit në seancën e parë të rradhës, me propozimin që ajo të jetë pika e parë e rendit të ditës.

XIV BASHKËPUNIMI I KUVENDIT ME KUVENDET E KOMUNAVE DHE QYTETEVE TJERA

Neni 202.

Kuvendi bashkëpunon me kuvendet, gjegjësisht trupat përfaqësues të komunave tjera në vend dhe në shtetet e jashtme.

Kuvendi bashkëpunon edhe me organizatat joqeveritare, humanitare dhe organizatat tjera.

Neni 203.

Bashkëpunimi realizohet në pajtim me programin të cilin Kuvendi e bjen çdo vit në propozim të Kryetarit të Kuvendit dhe shefave të grupit të këshilltarëve.

Bashkëpunimi realizohet me vizitat reciproke të delegacioneve të Kuvendit ose funksionerëve të saj Kuvendeve të komunave dhe qyteteve tjera, me dhënjen e mendimit për çështjet e veçanta dhe të rëndësishme nga kompetenca e Kuvendit, si dhe shkëmbimin e informatave dhe materialeve dhe publikimeve tjera.

Përbërja e delegacioneve, si dhe qëllimet dhe detyrat e çdo vizite e përcakton kryetari i Kuvendit dhe shefat e grupeve të këshilltarëve. Delegacioni duhet të mbajë përbërjen e Kuvendit.

Delegacioni, gjegjësisht funksioneri ose këshilltari është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga përfundimi i vizitës Kuvendit ti paraqet raport për vizitën e kryer.

XV INTERPRETIMI AUTENTIK I AKTEVE TË KUVENDIT, INTERPRETIMI,

Neni 204.

Propozimi për nxjerrjen e interpretimit autentik të akteve të Kuvendit mund ta paraqet çdo person juridik ose fizik. Propozimi duhet të jetë i paraqitur me shkrim dhe i arsyetuar. Kuvendi në propozim të Këshillit për dispozita dhe administratë të Kuvendit, bjen interpretimin autentik të akteve miratues i të cilëve është.

Kur në seancën e Kuvendit shtrohet pyetja e zbatimit të rregullt të dispozitës së Rregullores, interpretimin profesional e bënë Sekretari i Kuvendit.

Neni 205.

Propozimin për nxjerrjen dhe ndryshimin e Rregullores mund ta paraqet 1/3 e këshilltarëve, grupi i këshilltarëve, Këshilli për dispozita dhe administratë si dhe kryetari i Kuvendit.

Për propozimin nga paragrafi 1. i këtij neni hapet diskutimi.

Për propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni vendoset me votim publik, me shumicën e numrit të këshilltarëve prezent.

Me Vendim që të fillohet miratimi, gjegjësisht ndryshimi i Rregullores, Kuvendi cakton trupin kompetent punues për hartimin e Projekt Rregullores.

Kuvendi bjen, gjegjësisht bënë ndryshimin e Rregullores me shumicë votash nga numri i këshilltarëve prezent.

Nëse në nxjerrjen ose ndryshimin e Rregullores fillohet para konstituimit të trupave punues në kompetencë të së cilës është shqyrtimi i të njejtës, Kuvendi mund të miraton Rregulloren, gjegjësisht ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, pa shqyrtimin e Rregullores në trupin kompetent punues.

Neni 206.

Për gjithçka që nuk është rregulluar me dispozitat e kësaj Rregullore, zbatohen vendimet e posaçme të Kuvendit dhe dispozitat e vlefshme me të cilat është rregulluar lëmia e vetadministrimit lokal.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen në të gjithë pjesëmarrësit në seancë, e veçmas zbatohen në mbledhjet e trupave punues të Kuvendit.

XVI KRYERJA E PUNËVE PROFESIONALE DHE PUNËVE TJERA

Neni 207.

Punët profesionale dhe punët administrativo teknike për nevojat e Kuvendit, trupave të tij punues, këshilltarëve dhe grupeve të këshilltarëve i kryen njësia organizative e Administratës komunale, kompetente për punët e Kuvendit, që rregullohet me Vendimin mbi Administratën komunale.

Mirëmbajtjen e rendit në ndërtesën e Kuvendit dhe në hapsirat tjera në të cilat Kuvendi punon, siguron shërbimi i sigurimit fiziko-teknik, të cilën e angazhon Administrata komunale.

XVII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 208.

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja mbi punën e Kuvendit të komunës Preshevë (“Gazeta zyrtare e Komunës së Bujanocit” nr. 03/2018).

Neni 209.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Komunës së Bujanocit”.

KUVENDI KOMUNAL PRESHEVË

I.nr.:110-20

Datë :31.05.2021
Preshevë,

Kryetari,
Sami SALIHU d.v

71

На основу чл. 32. и 36. Закона о локалној самоуправи („Сл.гласник Републике Србије“,бр.129/2007, 83/2014 - др. закон, 101/2016 - др. закон и 47/2018), Скупштина општине Прешево на одржаној дана 28.05.2021.год., доноси:

Нë mbështetje të nenit 32. dhe 36. të Ligjit mbi vetëadministrimin lokal (“Fl.zyrtare

e Republikës së Serbisë”, nr.129/2007, 83/2014 – ligji tjetër, 101/2016 - ligji tjetër dhe 47/2018) Kuvendi komunal Preshevë në seancën e mbajtur më 28.05.2021. miratoi këtë:

РЕШЕЊЕ

О ИМЕНОВАЊУ ЧЛАНОВА СТАЛНИХ РАДНИХ ТЕЛА-САВЕТА

И КОМИСИЈА СКУПШТИНЕ ОПШТИНЕ ПРЕШЕВО

AKTVENDIM

МБИ ЕМËРИМИН Е АНËТАРËВЕ ТË TRUPAVE ТË ПËРHERSHME PUNUESE PLEQËSI DHE KOMISIONE ТË KUVENDIT

ТË KOMUNËS PRESHEVË

Члан /Neni 1

Овим Решењем именују се чланови сталних радних тела-савета и комисија Скупштине општине Прешево.

Me këtë aktvendim emërohen anëtarët e përherëshëm të trupave punuese, pleqësitë dhe komisionet e Kuvendit të komunës Preshevë.

Члан/ Neni 2

Именују се чланови одбори Скупштине општине Прешево:

Emërohen anëtarët e këshillave të Kuvendit komunal Preshevë:

I. Одбор за административно-мандатна питања/

Këshilli për çështje administrative- mandatare,

1. Munir Rexhepi - председник/kryetar,

2. Arbresha Salihu-члан/anëtar,

3. Shpetime Hasani -члан/анëtare,
4. Afërdita Ismaili -члан/анëtar,
5. Kreshnik Fazliu -члан/анëtar,

II. Одбор за избор и именовања,/ Këshilli për të zgjedhurit dhe emërimë,

1. Albiona Ibrahim –Rexhepi -
председник/kryetar,
2. Shpëtim Haliti-члан/анëtar,
3. Muselem Mehmeti -члан/анëtar,
4. Naser Aziri -члан/анëtar,
5. Islam Isufi -члан/анëtar.

III. Одбор за прописе и управу,/ Këshilli për akte normative dhe administratë,

1. Mendurim Presheva -председник/
kryetar,
2. Drita Ramizi -члан/анëtar,
3. Shkëmbim Veliu -члан/анëtar,
4. Daut Salihu -члан/анëtar,
5. _____-члан/анëtar.

IV. Одбор за друштвено-економски развој, привреду и финансије/ Këshilli për

zhvillim shoqëror-ekonomik, ekonomi dhe finansa,

1. Daut Salihu -председник/kryetar,
2. Naim Jashari-члан/анëtar,
3. Armend Asllani -члан/анëtare,
4. Sefedin Sadiku -члан/анëtar

5. _____-члан/анëtare.

V. Одбор за друштвене делатности/ Këshilli për veprimtari shoqërore,

1. Hyrmete Ramadani -
председник/kryetar,
2. Hamdi Fejzullahu-члан/анëtar,
3. Zylfi Rexhepi -члан/анëtar,
4. Tefik Bajrami -члан/анëtare,
5. _____ -члан/анëtar.

VI. Одбор за урбанизам, грађевинарство и стамбено-комуналне делатности,/

Këshilli për urbanizëm, ndërtimatri dhe veprimtari komunallo-banesore,

1. Muselem Mehmeti -
председник/kryetar,
2. Agim Sabedini -члан/анëtar,
3. Argjend Sherifi-члан/анëtar,
4. Fitim Mehmeti -члан/анëtar,
5. Sylejman Saqipi -члан/анëtar.

VII. Одбор за рад и развој месних заједница/ Këshilli për punën dhe zhvillimin e

bashkësive lokale,

1. Naim Jasahri -председница/kryetare,
2. Munir Rexhepi -члан/анëtar,
3. Almin Shaqiri -члан/анëtar,
4. Armend Beqiri-члан/анëtare,
5. Rinor Kurtishi -члан/анëtar.

VIII. Одбор за пољупривреду и развој села/ Këshilli për bujqësi dhe zhvillim të

fshatit,

1. Hamdi Fejzullahu -
председник/kryetar,

2. Shpëtim Haliti -члан/анëтар,

3. Kastriot Sulejmani -члан/анëтар,

4. Sylejman Ibishi -члан/анëтар,

5. Bajram Jashari -члан/анëтар.

IX. Одбор за заштиту и унапређење животне средине/ Këshilli për mbrojtjen dhe

avansimin e mjedisit jetësor,

1. Arzana Bajrami –
председница/kryetare,

2. Xhejlane Ferati -члан/анëtare,

3. _____ -члан/анëtare,

4. Naser Ejupi -члан/анëтар,

5. Afrim Abdullahu -члан/анëтар.

X. Одбор за представке и притужбе/ Këshilli për parashtresa dhe ankesa,

1. Altin Boriçi- председник/kryetar,

2. Shkëmbim Velu -члан/анëтар,

3. Vjollca Ymeri -члан/анëтар,

4. Gani Veseli -члан/анëтар,

5. Labinot Velu -члан/анëтар.

XI. Одбор за награде и признања,/ Këshilli për çmime dhe mirënjohje,

1. Shpëtime Hasani -
председник/kryetar,

2. Melihate Ajvazi -члан/анëтар,

3. Almina Iljazi -члан/анëтар,

4. Ilir Zylfiu -члан/анëтар,

5. _____ -члан/анëтар.

XII. Одбор за утврђивање предлога назива иулица, тргова, засеалака и делова насељених места,/ Këshilli për përcaktimin e propozimeve për emërtimin e rrugëve, shesheve, fshatrave dhe pjesëve të vendbanimeve,

1. Mustafë Shaqiri - председник/kryetar,

2. _____ -члан/анëтар,

3. Shpëtim Haliti -члан/анëтар,

4. Veli Mustafa -члан/анëтар,

5. Sylejman Etemi - члан/анëтар.

XIII. Одбор за односе са верским заједницама,/ Këshilli për marrëdhënjet me bashkësitë fetare.

1. Beqir Nuhiu - председник/kryetar,

2. Drita Ramizi -члан/анëтар,

3. Zana Osmani -члан/анëтар,

4. Dugagjin Hasani -члан/анëтар,

5. Agron Zejnullahu -члан/анëтар.

XIV. Одбор за борбу против корупције,/ Këshilli për luftën kundër korrupsionit,

1. Shkëmbim Velu -
председник/kryetar,

2. Arbëresha Salihu -члан/anëtar,

3. Arbenita Ademi -члан/anëtar,

4. _____ -члан/anëtar,

5. Florije Xhemaili -члан/anëtar.

XV. Одбор за социална питања,/ Këshilli për çështje sociale.

1. Xhejlane Ferati -
председник/kryetar,

2. Melihate Ajvazi -члан/anëtar,

3. Hyrmete Ramadani -члан/anëtar,

4. Jeton Abdullahu -члан/anëtar,

5. _____ -члан/anëtar.

Члан /Neni 3

Посебна стална радна тела Скупштине општине Прешево:

Trupat e veçanta të përhershme punuese
të Kuvendit Komunal Preshevë:

КОМИСИЈА / КОМИСИОНЕТ

I. Савет за младе/ Pleqësia për të rinjë,

1. Mustaf Shaqiri -
Председник/Kryetar,

2. Shkëmbim Velu - члан/anëtar,

3. _____ -члан/anëtare,

4. Granit Bilalli - члан/anëtar,

5. Artan Rexhepi -члан/anëtar.

6. Qibrije Velu члан/anëtar,

7. Ymer Limani -члан/anëtar.

II. Комисија за родну равноправност/ Komisioni për barazi gjinore,

1. Albiona Ibrahim -Rexhepi -
Председник/Kryetar,

2. Hyrmete Ramadani -
члан/anëtar,

3. _____ -члан/anëtare,

4. Arjanita Dalipi - члан/anëtar,

5. Vlora Latifi -члан/anëtar.

6. Aida Beqiri члан/anëtar,

7. Zana Hasani -члан/anëtar.

III. Савет за здравље/ Pleqësia për shëndetësi,

1. Naser Aziri -
Председник/Kryetar,

2. Agim Sabedini - члан/anëtar,

3. Flaka Zeqiri -члан/anëtare,

4. Beqir Nuhiu - члан/anëtar,

5. Faton Nevzadi -члан/anëtar.

6. Fatlum Aliu члан/anëtar,

7. _____ -члан/anëtar.

IV. Савет за праћење примене Етничког кодекса,/ Pleqësia për përcjelljen e zbatimit të kodit Etik ,

1. Munir Rexhepi -
Председник/Kryetar,

2. Qefajete Mustafa - члан/anëtar,

3. Yll Mehmeti -члан/анëtare,
4. Reshat Neziri - члан/анëtar,
5. Myrvete Aliu -члан/анëtar.
6. Naser Arifi члан/анëtar,
7. _____ -члан/анëtar.

I.nr **119-36** datës 26.03.2018, i publikuar në Fl.Zyrt. Komunës së Bujanocit.

Члан / Neni 6

Ово Решење ступа на снагу даном доношења а објавити у Сл.гласнику Општине Бујановац.

Aktvendimi hynë në fuqi ditën e miratimit, ndërsa shpallet në Gazetën zyrtare të Komunës së Bujanocit.

V. Кориснички савет јавних служби, / Pleqësia shfrytëyuese e shërbimeve publike.

1. Amir Latifi -
Председник/Кryetar,
2. _____ -
члан/анëtar,
3. _____ -
члан/анëtare,
4. Zejush Abazi -
члан/анëtar,
5. Amir Latifi -
члан/анëtar.
6. Sheribane Rustemi -
члан/анëtar,
7. Kelmend Ramadani -
члан/анëtar.

СКУПШТИНА ОПШТИНЕ ПРЕШЕВО KUVENDI I KOMUNËS PRESHEVË

I.бр/nr.

Dana/ datë: 28.05.2021.

**Председник/ Kryetari,
Sami Salihu cp./dv.**

Члан / Neni 4

Чланови сталних радних тела именују се на мандат, колико траје мандат Скупштине.

Анëтарët е trupave të përhershme punuese emërohen për mandat sa zgjat mandati i Kuvendit.

Члан / Neni 5

Ступањем на снагу овог Решења, престаје да важи Решење I.бр. **119-36** од дана 26.03.2018.г., објављен у Сл.гласнику Општине Бујановац.

Ме hyrjen në fuqi të këtij Aktvendimi pushon të vlejë Aktvendimi me